



**RAPORT I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË  
EKONOMIKO-FINANCIARE  
NË  
“REZIDENCËN STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1,  
TIRANË”**

**DHJETOR 2019**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

<b>Përmbajtja</b>	<b>faqe</b>
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II. HYRJA .....	7
a. Titulli.....	7
b. Marrësi .....	7
c. Objektivat dhe qëllimi.....	7
d. Identifikimi i çështjes:.....	7
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim .....	7
f. Përgjegjësitë e audituesve.....	8
g. Kriteret e vlerësimit .....	8
h. Standardet e auditimit .....	8
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....	9
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....	10
1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm. ....	10
2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli/ Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	10
3. Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij.....	16
4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna. ....	17
5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.). ....	19
6. Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.....	21
7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	25
8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	53
9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale si dhe nga lidhja e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.....	56
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....	88



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.A. PËRSHKRIM I PROJEKTIT TË AUDITIMIT.

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, Tiranë” SHA, funksionon si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror. Aksionari i vetëm i kësaj shoqërie është Bashkia Tiranë. Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. RSU nr. 1 Tiranë SHA drejtohet me dy nivele që është Këshilli Mbikëqyrës (KM) dhe Drejtoria. KM i përbërë nga znj. A.R, Kryetar, z. P.N dhe z. D.B. anëtarë, funksionon sipas përcaktimeve në ligjin e mësipërm dhe statutin e shoqërisë. Administrator i Shoqërisë është znj. A.SH.. Shoqëria ka si qëllim trajtimin në fjetore dhe mensa të studenteve të Universitetit të Tiranës, prodhimin dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë etj.

### I.B NJË PËRSHKRIM I GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMI.

GJET JA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
1.	Shkelje e procedurave ligjore për emërimin e Administratorëve.	Faqe 10 – 17	E lartë	AP të marrë masa për caktimin e numrit të Administratorëve, dhe emërimin e tyre në përputhje aktet ligjore në fuqi. Shoqëria të marrë masa për të depozituar në QKB, çdo akt të organeve drejtuese në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga dispozitat rregullatorë në fuqi. Shoqëria të marrë masa për të mbajtur, administruar dhe publikuar në faqen zyrtare në internet protokollet e mbledhjeve të AP, vendimet e AP, si dhe çdo vendim që rrit transparencën ndaj publikut, pa dëmtuar sekretin tregtar të shoqërisë.
2.	Vendime të KM të RSU nr. 1 Tiranë SHA, në kundërshtim me ligjin në lidhje me kompetencat dhe detyrimet. Mbajtja e dokumentacionit të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të mbledhjeve të KM.	Faqe 10 – 17	E lartë	AP e aksionarëve të marrë masa ndaj KM për të lidhur kontratën e punës, në cilën të përcaktohen edhe penalitetet për rastet e mangësive për mos përmbushjen e detyrimeve ndaj shoqërisë. AP (Këshilli Bashkiak) të marrë masa për analizimin e vendimeve të KM të shoqërisë dhe kthimin e parcelave Kadastrale nr. 6/471, 6/678, 6/679 dhe 6/473 nën administrimin e SHA RSU Nr. 1, Tiranë.
3.	Vendime e Drejtorisë së shoqërisë jo në përputhje me ligjin. Dokumentimi shkresor jo në përputhje me rregullat arkivor.	Faqe 10 – 17	E lartë	Administratorët të përmbushin përcaktimet statusorë të funksionimit të Drejtorisë. Shoqëria të marrë masa për punësim në sektorin arkivues, punonjës me eksperiencë si dhe të trajnuar.
4.	Strukturë organike jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit.	Faqe 18 – 20	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për plotësimin e procedurave të aprovimit të niveleve të pagave të punonjësve nga Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
5.	Shpenzime me efekte negative prej largimeve të padrejta nga puna.	Faqe 18 – 20	E lartë	Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në marrëdhëniet me punonjësit të zbatohen të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet që përcaktohen në Kodin e Punës.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

GJET JA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
6.	Mos paraqitje e saktë e zërit të aktiveve troje të Shoqërisë.	Faqe 22 – 26	E mesme	Nga drejtimi i shoqërisë dhe departamenti i financës dhe departamentet përkatëse duhet të kryhet analiza e situatës së asetëve të shoqërisë, të vlerësohet shuma që do të korrigohet dhe pas miratimit nga ortaku të reflektohet në pasqyrat financiare të periudhës përkatëse në zërin e shpenzimeve.
7.	Humbja e titullit të pronësisë për 74,509 m2 sipërfaqe tokë truall.	Faqe 22 – 26	E lartë	Shoqëria duhet të marrë masa për vlerësimin e situatës, apelimet në institucionet përkatëse për mbrojtjen e pronësisë së aktiveve të shoqërisë, dhe saktësimet në pasqyrat financiare.
8.	Kritere në kundërshtim me LPP dhe RrPP.	Faqe 26 – 54	E mesme	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik.
9.	Kritere të pa argumentuara dhe/apo jo në përputhje me nevojat e objektit të prokurimit.	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masat e duhura për të vendosur si kushte të veçanta apo të përgjithshme për kualifikim vetëm kritere të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë me Investimin / mallin / shërbimin. Gjithashtu, nga ana e Shoqërisë të merren masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik.
10	Kualifikim i OE me mangësi në dokumentacion	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin sa më korrekt të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.
11	Qëndrim me dy standarde në lidhje me vlerësimin e ofertave	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin sa më korrekt të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë
12	Kryerje e punimeve pa kontratë punimesh dhe pa kontratë shërbimi për mbikëqyrjen e punimeve.	Faqe 26 – 54	E lartë	1. RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përlllogaritjen dhe zbritjen e volumeve të punimeve të cilat janë kryer me punëtorët dhe specialistët e sektorëve nga kontrata e punimeve për zbatimin e kontratës. 2. RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për personat e përfshirë për nisjen dhe vazhdimin e proceseve të punës në një kohë që këto procese dhe volume punimesh ishin objekt i një procedure prokurimi, vlerësimi



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

GJET JA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
				i të cilës rezultoi të ishte kryer në momentin e nisjes së punimeve të zbatimit.
13	Kryerje e punimeve pa cilësi dhe pa respektuar afatet e nevojshme të proceseve të punës.	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përlllogaritjen dhe zbritjen e volumeve të punimeve të cilat janë kryer pa cilësinë dhe proceset e nevojshme të punës në lidhje me tavanet e gipsit, suvatimet dhe çdo zë tjetër të përfshirë në preventiv.
14	Përshkrim jo i qartë i objektit të prokurimit.	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për dokumentimin e të gjitha nevojave për prokurim punimesh/mallrash/shërbimesh me qëllim krijimin e gjurmës standarde të auditimit dhe vendosjen e transparencës përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.
15	Mangësi në dokumentacionin e prokurimeve.	Faqe 26 – 54	E lartë	RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për dokumentimin e të gjitha praktikave për zbatimin e kontratave për punime/mallra/shërbime me qëllim krijimin e gjurmës standarde të auditimit dhe vendosjen e transparencës përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.
16	RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka bërë emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Njësisë.	Faqe 54 – 57	E mesme	AP të marrë për caktimin e Nëpunësit Autorizues. Nëpunësi Autorizues i caktuar të zgjedh Nëpunësin Zbatues.
17	Shoqëria ka probleme në Aktivitetet e Kontrollit, Informacionin dhe Komunikimin, si edhe Monitorimin.	Faqe 54 – 57	E lartë	Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e gjurmës së Auditimit, dhe Nëpunësi Autorizues të marrë masa për arkivimin e gjurmës audituese. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për pakësimin e nivelit të riskut mbi aktivet, ruajtjen dhe mirë administrimin e tyre, si edhe kronologjinë e mbajtjes së përgjegjësisë dokumentare, në lidhje me aktivet e shoqërisë.
18	Në objektet e dhëna me qira janë konstatuar probleme ligjore dhe dëme financiare të shkaktuara ndaj shoqërisë.	Faqe 57 – 87	E lartë	Asambleja e Përgjithshme (Këshilli Bashkiak Tiranë) e SHA RSU Nr. 1 Tiranë, në cilësinë e organit përgjegjës për politikën e shoqërisë të analizojë shkaqet e shkeljeve ligjore dhe të rivendosi në përputhshmëri ligjore situatën. Administratori të marrë masa për ndjekjen ligjore të situatës sipas përcaktimeve të Kodit Civil mbi Uzukrutin, Begatim pa Shkak dhe Qiratë. Drejtoria juridike e SHA RSU Nr. 1 Tiranë të adresojë këto mospërputhje në organet kompetente, për ngarkim me përgjegjësi të personave. Administratori të marrë masa administrative dhe ligjore, për të arkëtuar detyrimin prej 11,474,208 Lekë nga shoqëria “T...G” dhe detyrimet rrjedhëse për dëmtimin e aseteve të shoqërisë.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

<b>GJET JA NR.</b>	<b>PËRMBLEDHJE E GJETJES</b>	<b>REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR</b>	<b>RËNDËSI A</b>	<b>REKOMANDIMI</b>
19	Janë identifikuar objekte që përdoren nga të tretët, pa kontratë dhe nuk paguajnë qira.	Faqe 57 – 87	E lartë	Të përcaktojë saktë sipërfaqen e truallit të çdo subjekti dhe lidhjen e kontratës së qiradhënies me përdoruesit. Të marrë masa administrative dhe ligjore për mbledhjen e detyrimit nga të gjithë subjektet e evidentuar në auditim. në vlerën 1,975,680 Lekë para lidhjes së kontratës me çdo subjekt, si edhe çdo detyrim vijues deri në lirim të sipërfaqeve të zëna.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 598/1, datë 09.09.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me shkresën me nr. 598/2 prot., datë 02.10.2019, nga data 10.09.2019 deri me datë 08.11.2019, në subjektin “*Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, Tiranë*” (RSU nr. 1) SHA, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.08.2019, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë” me përbërje:

1. **J.H., Përgjegjës Grupi**
2. **A.A., Auditues**
3. **I.H., Auditues**
4. **M.B., Audituese**
5. **B.SH., Auditues** (shtuar me shkresën me nr. 598/2 prot., datë 02.10.2019)

### a. Titulli

Raport mbi auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit së “*Rezidencës Studentore Universitare nr. 1, Tiranë*”.

### b. Marrësi

“*Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, Tiranë*”, me Drejtor të Përgjithshëm znj. A.SH..

### c. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që RSU nr. 1 Tiranë SHA ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë shoqërisë. Auditimi ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhe nëse u është shërbyer studentëve sipas standardeve që kërkohen. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim ***promovimin e përgjegjshmërisë*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

### d. Identifikimi i çështjes:

Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit, duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

### e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Shoqëria ka si objekt të aktivitetit trajtimin në fjetore dhe mensa të studenteve të Universitetit të Tiranës, prodhimin dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë, furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të përdorura të Qytetit Studenti (QS), pastrimin, gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme të QS, krijimin e kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambiente çlodhëse, shërbim bibliotekar dhe social për studentet, veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qira të ambienteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.



#### **f. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

#### **g. Kriteret e vlerësimit**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë; etj.

#### **h. Standardet e auditimit**

- ISSAI 100 – *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*
- ISSAI 400 – *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).*





### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, Tiranë” SHA, funksionon si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror. Aksionari i vetëm i kësaj shoqërie është Bashkia Tiranë. Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. RSU nr. 1 Tiranë SHA drejtohet me dy nivele që është Këshilli Mbikëqyrës (KM) dhe Drejtoria. KM i përbërë nga znj. A.R., Kryetar, z. P.N. dhe z. D.B. anëtarë, funksionon sipas përcaktimeve në ligjin e mësipërm dhe statutin e shoqërisë. Administrator i Shoqërisë është znj. A.SH.. Shoqëria ka si qëllim trajtimin në fjetore dhe mensa të studenteve të Universitetit të Tiranës, prodhimin dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë etj.

#### Objektivi

Objektivi kryesor i auditimit është **dhënia e opinionit bazuar në vlerësimin** dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike dhe/apo grandeve, ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve. Auditimi u fokusua në mangësitë e konstatuara në aspekte që kanë të bëjnë me menaxhimin e procesit të realizimit të kontratave përkatëse.

*Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

**Qëllimi i auditimit** është hartimi i Raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.08.2019, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga e dieta, vendimet e marra nga KM, të ardhurat e realizuara si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar procedurat e prokurimit në masën mbi 100 % si në sasi, ashtu dhe në vlerë, si dhe zbatimi i kontratave përkatëse dhe procedurat me blerje të vogël. Është audituar hartimi i pasqyrave financiare, programi i zhvillimit, dhënia me qira e ambienteve në dispozicion të shoqërisë etj.



#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### 1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

**Titulli i Gjetjes:** Nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm.

**Situata:** Sipas shkresës me nr. 759 prot., datë 01.11.2017 është dërguar Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe Rekomandimet drejtuar Znj. A.SH. Administrator i RSU nr. 1 Tiranë SHA. Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar:

a. Për përmirësimin e *dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime.*

b. Janë rekomanduar **13 masa organizative**, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2 masa, nuk janë zbatuar 3 masa dhe janë në proces realizimi 8 masa.

c. Janë rekomanduar **2 masa për shpërblim dëmi** në shumën **511,927 lekë**, të cilat janë në proces zbatimi.

d. Janë rekomanduar **3 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit**, të cilat nuk janë zbatuar.

e. Janë rekomanduar **3 masa disiplinore**, të cilat nuk janë zbatuar.

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit” neni 15.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ka sjellë mos moszbatim të masave për zbatimin e ligjshmërisë, mos arkëtim të dëmeve ekonomike në si dhe mos përmirësimin e punës të RSU nr. 1, SHA.

**Shkaku:** Sa më sipër ka ndodhur si rezultat i mos marrjes së masave për zbatimin e gjithë rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Të merren masa nga KM dhe Administratori i RSU nr. 1, SHA, për realizimin e masave organizative dhe shpërblim dëmi të pazbatuara ose në proces, të lëna nga auditimi i mëparshëm si dhe rekomandimet e pazbatuara në lidhje me “Masa Disiplinore”.

**Afati:** Menjëherë

Lidhur me konstatimin e mësipërm ngarkohen me përgjegjësi personat e përmendur në Aktkonstatimin nr. 17 , datë 08.11.2019.

##### 2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli/ Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA është një shoqëri Aksionare me kapital 100 % të Bashkisë Tiranë e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT K51814005N, me një kapital prej 7,976,136,000 lekë, me një sistem drejtimi me dy nivele: Këshilli Mbikëqyrës (në vijim KM) dhe Drejtoria. KM i përbërë nga tre anëtarë është emëruar nga Asambleja e Përgjithshme (në vijim AP) e Aksionarëve. Drejtoria e shoqërisë është e përbërë nga 4 anëtarë, prej të cilëve një anëtar kryen Detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm (Administratorit). Funksionimi i strukturave drejtuese kryhet në përputhje me Statutin e shoqërisë të miratuar nga AP me protokoll nr. 731, datë 13.09.2016, dhe Rregullores së Funksionimit të Brendshëm. Të dy këto dokumente u gjetën të hartuara në kundërshtim të pjesshëm me legjislacionin në fuqi, që ndikojnë në funksionimin e strukturave drejtuese të Shoqërisë. Nga auditimi janë konstatuar vendime jo në përputhje me legjislacionin në fuqi të Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, të cilat janë trajtuar si më poshtë vijon:

a. **Titulli i Gjetjes:** Shkelje e procedurave ligjore për emërimin e Administratorëve.

**Situata:** KM i shoqërisë, me vendimin e datës 17.11.2016, protokoll nr. 992, ka bërë emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm Znj. A.SH., me të cilën ka lidhur një kontratë individuale pune. KM ka



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

lidhur kontrata pune në datën 30.01.2017 përkatësisht: Prot. Nr. 24 me Znj. A.SH. në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm; Prot. Nr. 25 me Z. E.XH. në pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm; Prot. Nr. 26 me Z. I.M. në pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm; Prot. Nr. 27 me Z. I.Q. në pozicionin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm. Këto funksione/pozicione duhet të ishin në cilësinë e Administratorit dhe jo Drejtorit të Përgjithshëm si dhe ky emërim duhet të ishte bërë nga Asambleja e Përgjithshme dhe jo nga Këshilli Mbikëqyrës. Gjithashtu, sipas Ekstraktit Historik në QKB të shoqërisë, evidentohet se kjo e fundit ka një drejtim me dy nivele, dhe në nivelin e dytë ka vetëm një Administrator (Znj. A.SH.) emëruar si “Drejtor të Përgjithshëm” ndërkohë që tre anëtarët e Drejtorisë së Shoqërisë nuk janë regjistruar në QKB. Emërtesa e depozituar në QKB për Administratorët e ndryshme nga ajo në aktin e emërimit. Nuk ka vendime të AP të shpallura në faqen “On-line” të Shoqërisë. Nuk janë të shpallura vendimet e AP dhe procesverbalet e mbledhjeve të AP. Regjistri i aksioneve nuk është publikuar në faqen e internetit të shoqërisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 167, pika (2) dhe neni 119, pika (3), Ligji 139/2015, neni 64 Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë pika (f), Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni (21), Efektet e regjistrimit dhe të publikimit, pika (5) dhe neni (26) Të dhënat shtesë për shoqëri aksionare, germa (h).

**Ndikimi/Efekti:** Shkelja është administrative. Emërimet e Administratorëve nga një organ i papërcaktuar nga ligji, sjell pasoja në mirëfunksionim e Shoqërisë. Mos publikimi i të dhënave të Shoqërisë në internet

**Shkaku:** KM nuk ka interpretuar drejt, ligjshmërinë e vendimmarrjes së vet. Kompetencat e KM kufizohen, kur AP drejtohet nga një ligj organik specifik.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AP të marrë masa për caktimin e numrit të Administratorëve, dhe emërimin e tyre në përputhje aktet ligjore në fuqi. Shoqëria të marrë masa për të depozituar në QKB, çdo akt të organeve drejtuese në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga dispozitat rregullatorë në fuqi. Shoqëria të marrë masa për të mbajtur, administruar dhe publikuar në faqen zyrtare në internet protokollat e mbledhjeve të AP, vendimet e AP, si dhe çdo vendim që rrit transparencën ndaj publikut, pa dëmtuar sekretin tregtar të shoqërisë.

**Afati:** Menjëherë dhe në vijimësi.

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me projekt raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*

**b. Titulli i Gjetjes:** Statuti i RSU nr. 1 Tiranë SHA krijon mangësi ligjore.

**Situata:** Statuti i shoqërisë është miratuar me vendimin nr. 27004, datë 08.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe protokoll nr. 731, datë 13.09.2016. Nga auditimi rezulton se në brendësi të Statutit Shoqërisë i janë atribuar kompetenca të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Konkretisht Shoqërisë i janë dhënë këto kompetenca:

*Neni 2: “Objekti i shoqërisë”. Pika 2.2 “Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.”;*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

*Neni 9: Kompetencat e këshillit mbikëqyrës. Pika 9.2. Këshilli mbikëqyrës emëron drejtorinë. Këshilli Mbikëqyrës cakton njërin prej anëtarëve të drejtorisë me cilësinë e Drejtorit.*

*Neni 9: Kompetencat e këshillit mbikëqyrës. Pika 9.7. Këshilli mbikëqyrës i propozon Kryetarit të Bashkisë Tiranë lidhur me këtë çështje:*

*a) përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate të shoqërisë;*

*b) kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;*

*c) hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë;*

*d) shitjen e pasurive që përbejnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë;*

*e) krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera;*

*f) marrjen e huave afatmesme, afatgjate;*

*g) si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të Ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" është kompetence e AP.*

*Neni 11; Drejtoria. Pika 11.1 Shoqëria administrohet nga drejtoria, e cila mund të përbëhet nga një ose disa anëtarë. Numri i anëtarëve të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikëqyrës me një vendim të tij.*

*Neni 12; Drejtoria. Pika 12.2 Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorisë të nënshkruara nga anëtari me cilësinë e drejtorit, edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit, kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.*

*Neni 18; Anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë: A.R., P.N., D.B..*

*Neni 20; Asambleja e Përgjithshme. Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", që nuk janë shprehur në këtë Statut, ushtrohen nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me cilësinë e aksionarit të vetëm.*

Në fakt, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, kompetencat e përmendura në nenet 2, 9, 11, 12, 18 dhe nenin 20 janë kompetenca të cilat i ushtron Bashkia Tiranë nëpërmjet Këshillit të Bashkiak apo Kryetarit të saj.

**Kriteri:** Ligji nr. 139/2015, në nenin (7), pika (2), Ligji nr. 139/2015 sipërcituar, detyron specifikisht Kryetarin e Bashkisë Tiranë në ushtrimin e kësaj të drejte, në nenin (64), germa (f). Kufizimet për të mos e ushtruar këtë të drejtë nga aksionari, përcaktohen në Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", neni (22), pika (2) dhe (3). Njëherazi kjo e drejtë i jepet edhe me Ligjin nr. 9901, sipërcituar, nenin (135), pika (1), germa (c) i cili përcakton të drejtën e AP të aksionarëve emërimin e administratorëve. Neni (12), pika (2) i Statutit i jep të drejtën e ushtrimit të pushtetit diskrecional shoqërisë. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 sipërcituar, neni (11). Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", neni (22), pika (2) dhe (3). Neni 18 është nominativ. Ai nuk mund të shërbejë si normë e përgjithshme juridike për tu përfshirë në Statutin e shoqërisë. Neni 20, detyron shoqërinë të njoh si përfaqësues të AP të shoqërisë Kryetarin e Bashkisë, ndërkohë që legjislacioni organik, Ligji nr. 139/2015, ka përcaktuar detyra të ndara mes Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Ndikimi/Efekti:** Në hartimin dhe miratimin e Statutit, AP ka krijuar një hapësirë ekstraligjore për funksionimin e shoqërisë.

**Shkaku:** AP nuk ka respektuar në drejt legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare, me pronar të vetëm organin e vetëqeverisjes lokale.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** AP të marrë masa për ndryshimet e neneve të mësipërm në Statutin e Shoqërisë RSU nr. 1 Tiranë SHA në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

**Afati:** Brenda datës 31.03.2020.

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me Projekt Raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*

**c. Titulli i Gjetjes:** Rregullorja e funksionimit të RSU nr. 1 Tiranë SHA ka mangësi në ndarjet e funksioneve dhe mënyrë e miratimit të saj.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA ka një rregullore të funksionimit të brendshëm të saj të miratuar me Vendim nr. 20 të KM të Shoqërisë, datë 09.10.2014. Kjo nuk është e përshtatur me pozicionet e detyrave drejtuese sipas kërkesave të Ligjit nr. 9901 pasi i jep kompetencë Këshillit Mbikëqyrës të emërojë dhe shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm të shoqërisë. Gjithashtu, njësia e Auditit të Brendshëm të Shoqërisë është nën vartësinë e Drejtorisë. Për sa i takon pozicioneve në kabinetin e drejtorisë ato nuk kanë të përcaktuar në rregullore detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve.

**Kriteri:** Ligji nr. 139/2015 sipërcituar, detyron specifikisht Kryetarin e Bashkisë Tiranë në emërimin e Administratorit të Shoqërisë, në nenin (64), germa (f). Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 134, Organet dhe publikimi, pika (1), neni 135, Të drejtat dhe detyrimet, pika (1) dhe pika (2), Ligji nr. 114/2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni (4), Përkufizime pika (18) dhe neni (10) Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika (2).

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e rregullores së funksionimit të përditësuar, pa një referencë të saktë statusore, pa përfshirë në atë të plotë strukturën e shoqërisë, pa respektuar kriteret ligjore për vartësitë e strukturave audituese, krijon një keq funksionim të shoqërisë.

**Shkaku:** KM i shoqërisë, nuk ka të qartë, kompetencën lëndore që ushtrojnë, sipas legjislacionit të përgjithshëm dhe atij organik.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Shoqëria të marrë masa për të hartuar dhe aprovuar në AP rregulloren e funksionimit të shoqërisë, përfshirë formimin arsimor të çdo hallke të shoqërisë nga KM deri tek punonjësi më i thjeshtë. NJAB të vendoset nën vartësinë e AP.

**Afati:** Brenda datës 31.03.2020.

**d. Titulli i Gjetjes:** Vendime të KM të RSU nr. 1 Tiranë SHA, në kundërshtim me ligjin në lidhje me kompetencat dhe detyrimet. Mbajtja e dokumentacionit të Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të mbledhjeve të këtij Këshilli.

**Situata:** Këshilli Mbikëqyrës i RSU Nr. 1 Tiranë SHA ka marrë vendime lidhur me: *kompetenca të asistencës sociale; dhënie me qira të objekteve mbi kompetenca të organit mbikëqyrës (dhënie e ambienteve me qira me sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>); mosrespektim të fushës së veprimit të organit mbikëqyrës dhe marrje të kompetencave të Këshillit Bashkiak; kalim i aseteve ndaj aksionarit*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

*duke shkelur ligjin për shoqëritë tregtare; miratim i pasqyrave financiare tej afateve ligjore.* Pas miratimit në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të daljes nga inventari i pronave të RSU nr. 1 Tiranë SHA, me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 57, datë 24.06.2018, këto prona, sipërfaqja e të cilave është 4966 m<sup>2</sup>. janë transferuar në pronësi të Bashkisë Tiranë, Në fakt, nga informacioni i dhënë nga RSU nr. 1 si dhe dokumentacioni kontabël i vënë në dispozicion rezulton se këto asete nuk janë zbritur nga inventari i aseteve Shoqërisë. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës i RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka konceptuar drejtë mbajtjen e procesverbaleve për çdo mbledhje, konkretisht, pikat e diskutuara në mbledhje, personat prezent, mënyrën e votimit, e gjithë procedura e evidentuar, printuar dhe firmosur. Nuk është evidentuar asnjë diskutim, nuk ka një libër të mbajtjes së protokollit të mbledhjeve të KM, që të demonstroj se ato që janë diskutuar në mbledhje janë autentike me ato që janë pasqyruar në Procesverbalet e mbledhjes, nuk shpjegohet nëse ka apo jo persona të tjerë të pranishëm në mbledhje. nuk rezulton të jetë bërë asnjë raportim 3 mujor në Këshillin Mbikëqyrës nga ana e Drejtorisë së RSU nr. 1 Tiranë SHA. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë bërë deklaratimet për pjesëmarrjen apo jo në një këshill të dytë mbikëqyrës, nuk ka bërë raportimin në Ministrinë e linjës, në çdo 3 muaj, nuk kanë marrë raportime nga Administratori/ët për ecurinë ekonomike të shoqërisë në çdo tre muaj, nuk kanë të depozituar në institucion të dhënat e formimit profesional, nuk kanë plotësuar deklaratën e Konfliktit të Interesit, nuk kanë paraqitur Dëshmi Penaliteti, nuk kanë një kontratë në terma të plotë me Asamblenë e Aksionarëve, nuk ka një rregullore funksionimi të këtij Këshilli.

**Kriteri:** Ligji nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin (30), germa (c); Ligji nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 126, neni 167 pika 6, neni 135 pika 4 germa d, neni 163; Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, pika n, neni 64, germa j; Ligji nr. 114/2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni (4) pika (18); Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” i ndryshuar, neni 46, neni 74, pika 3; Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 2 pika 2 dhe neni 16, pika 1; Vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme e Arkivave “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” nenin (13).

**Ndikimi/Efekt:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë ka ushtruar kompetenca të pa autorizuar nga ligji në së paku 9 raste në lidhje me strukturat e shoqërisë, qiradhënien, marrje të kompetencave të organeve ligjore. Përtej shkeljeve administrative, efekti i tyre është edhe financiar. Mungesa e dokumentacioneve të sakta e të besueshme për njoftimet e mbledhjeve, stafit në mbledhje, diskutimeve deri në vendimmarrje, përmbushje të detyrimeve ligjore për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve në KM, si dhe mangësi të tjera, nuk krijojnë opinion të besueshëm për mirë funksionimin e këtij organi.

**Shkaku:** Kryetarja e KM në cilësinë personit përgjegjës, ka drejtuar mbledhje tej kompetencave juridiksionale të KM. Anëtarët e KM kanë marrë pjesë, pa shprehur qëndrim kundër në kushtet e paligjshmërisë, dhe pa asnjë diskutim mbi paligjshmërinë e konstatuar. Anëtarët e KM nuk kanë respektuar detyrimet ligjore. Sekretarët e KM (A.S. dhe SH.XH.) nuk kanë mbajtur dokumentacionin e saktë të KM dhe mbledhjeve të organit mbikëqyrës.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Shoqëria në të ardhmen të marrë masa për studimin të tarifave të qirave dhe të miratojë në Këshill, pasi të ketë administruar relacion të plotë shpjegues për reduktimin e tarifave. Shoqëria të marrë masa për rivlerësimin e sipërfaqes së dhënë me qira subjektit “E...A”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

dhe në rast se sipërfaqja është mbi 200 m<sup>2</sup> të merren masa për arkëtimin e vlerës së përcaktuar. Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve të marrë masa për të lidhur kontratën e punës me Këshillin Mbikëqyrës si dhe për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit nga e konstatuar me mungesë nga auditimi. Gjithashtu, Asambleja të analizojë vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë në lidhje me parcelat kadastrale nr. 6/471, 6/678, 6/679 dhe 6/473 nën administrimin e RSU nr. 1 Tiranë SHA.

**Afati:** Menjëherë

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me Projekt Raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*

**e. Titulli i Gjetjes:** Vendime të Drejtorisë së shoqërisë jo në përputhje me kuadrin rregullator përkatës.

**Situata:** Drejtoria e RSU nr. 1 Tiranë SHA është e përbërë nga 4 anëtarë, një Drejtor të Përgjithshëm dhe tre Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm. Janë marrë 511 vendime nga Drejtori i Përgjithshëm në periudhën audituese 01.01.2017 deri në 31.08.2019, nga të cilat asnjë prej tyre nuk është marrë në mënyrë kolegjiale. Struktura e Shoqërisë nuk ka parashikuar sekretar të administratorëve (Drejtorisë), përgjegjëse për mbajtjen e protokollit të mbledhjeve të drejtorisë, i cili të merrej me protokollimin e mbledhjeve të Drejtorisë (Administratorëve). RSU nr. 1 Tiranë SHA ka mangësi në mbajtjen e materialit arkivor.

Nga auditimi me përzgjedhje të akteve të shoqërisë, kontratave të qirave, vendime drejtorie, korrespondenca me jashtë, u konstatua se ka dokumente që kanë datë dhe numër protokollit, por që nuk janë të evidentuara në librat e korrespondencave përkatëse. Ka kontrata të paregjistruara në libër protokollit e shoqërisë, të pa firmosur në çdo faqe, dhe pa vulë në çdo faqe. Në rastet materialeve bashkëlidhur ato nuk janë pjesë e bashkëlidhjes së pretenduar, dhe për to nuk ka asnjë procesverbal. Nuk ka asnjë procesverbal për dokumentet e nisura nga institucione të tjera, por ka dokumente që janë nisur nga persona që nuk kanë tagrin ligjor të firmës. Korrespondencat e Bashkisë Tiranë, janë nisur nga drejtorë të bashkisë sipas modelit të brendshëm të komunikimit bashkiak, por kanë dalë nga institucioni për RSU nr. 1 Tiranë SHA, pa shënimin “në mungesë dhe me urdhër/porosi” dhe nuk është njoftuar subjekti “Bashkia Tiranë” që i ka nisur, për parregullsitë protokollare. Dokumente të marrëdhënieve pronësore, janë pranuar fotokopje për tu arkivuar. Ndërprerja e punës së punonjësve të protokoll arshivës, është kryer pa bërë dorëzimet sipas rregullave dhe për këtë nuk ka asnjë procesverbal.

**Kriteri:** Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 15, Statuti i Shoqërisë, neni 11 dhe neni 12, Vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 7, neni 14, neni 17 si dhe Rregullorja e Brendshme e funksionimit të shoqërisë, kapitulli Detyrat e sektorit të arshivave.

**Ndikimi/Efekti:** Administratori ka shkëlur parimin e përfaqësimit kolegjial të drejtorisë. Tre Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm nuk kanë ushtruar detyrën e veprimit kolegjial ndaj shoqërisë. Administrimi i materialit arkivor, në mënyrë jo kronologjike, jo në libër protokollin e përcaktuar, të nisur nga persona të pa autorizuar nga ligji, nuk japin siguri të arsyeshme për respektimin e ligjit, dhe akteve nënligjore.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

**Shkaku:** Administratori ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara në ligj dhe Statut, ndërsa tre Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm kanë neglizhuar me detyrën. Punonjësit dhe Përgjegjësit e Arshivës, ishin të painformuar, të pa trajnuar, dhe të përzgjedhur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pa eksperiencë në fushën e arkivave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim 1:** Asambleja e Përgjithshme, në lidhje me Drejtimin e Shoqërisë, të kryejë rishikimin e Statutit ku të përcaktojë saktë numrin, funksionin dhe përgjegjësitë konkrete të Administratorit/Administratoreve të cilët aktualisht janë si Drejtorë/Zv. Drejtorë të Përgjithshëm dhe jo si Administratorë.

**Rekomandim 2:** Shoqëria të marrë masa për trajnimin e punonjësve të përfshirë në sektorin arkivues apo punësimin e stafit me eksperiencë.

**Afati:** Menjëherë

### **3. Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij.**

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 598/1 prot, datë 09.09.2019, i ndryshuar me shkresën nr. 598/2, datë 02.10.2019 “Hartimi, shqyrtimi ,miratimi dhe zbatimi i programeve ekonomiko-financiare”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Programi ekonomiko-financiar për vitin 2017.
- Programi ekonomiko-financiar për vitin 2018.
- Programi ekonomiko-financiar për vitin 2019.

**a. Titulli i Gjetjes:** Pasqyrim i gabuar në programin ekonomiko-financiar.

**Situata:** Planifikimi i të ardhurave nga objektet me qira është bërë mbi bazën e kontratave të lidhura me subjektet në zbatim të VKM. Nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Nga tabela shohim se realizimi i të ardhurave nga qiradhënia e objekteve është në masën 68 %. Ky vjen si rezultat i moskryerjes së pagesës së detyrimeve nga ana e qiramarrësve. Kjo diferencë lekësh e pa arkëtuar është paraqitur si vlerë debitoare në fund të vitit, e cila do arkëtohet në vitin pasardhës.

*Arkëtimi i të ardhurave nga objektet me qira .( nga dokumentacioni i shoqërisë)*

*Tabela (në mijë lekë)*

Parashikimi në 000/lek	Arkëtimi faktik në 000/lek
4,022	3,122

Tabela e objekteve me qira, të ardhura dhe detyrimi për vitin 2017 lekë

Nr.	Subjekti	Data e lidhjes së kontratës	Afati i kontratës	Detyrimi mujor në lekë	Të ardhurat vjetore 000/lek
1	E...A	23.08.2010	20 vjet	124,000	1,488
2	V...I	20.08.2016	1 vit	23,400	281
3	E...A	19.11.2015	1 vit	120,000	1,440
4	A...A	08.02.2016	1 vit	60,000	720
5	U...N	08.02.2016	1 vit	7,800	93
	<b>Shuma</b>				4,022

Nga grupi i auditimit është konstatuar parregullsi në parashikimin vjetor të të ardhurave vjetore të pritshme nga ambientet me qira pasi për “U...N” i cili ka kontratë me vlerë prej 7,800 lekësh në muaj ose 279 lekë në ditë, kontratë kjo e cila përfundon në datën 08.02.2017, në kontratën e re





**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

të lidhur me 16.03.2017 tarifa mujore e re ka ndryshuar në 4,800 lekë ,ndaj parashikimi i saktë i të ardhurës vjetore për vitin 2017 nga ky subjekt duhej të ishte **68,064 lekë** ( 2 muaj x 7,800 lekë + 16 ditë x 279 lekë + 10 muaj x 4,800 lekë) dhe jo 93,000 lekë si është parashikuar. Gjithashtu është konstatuar se në projekt programin e dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme nuk është paraqitur tek zëri i të ardhurave nga qiratë as parashikimi dhe as realizimi kontrata e qirasë me subjektin Albtelekom sha. Kjo kontratë është lidhur me datë 12.12.2016 me afat 1 vjeçar dhe me detyrim mujor prej 50,000 lekësh ose vlera totale vjetore prej 600 mijë lekë, çka ka sjellë një pasqyrim jo të saktë të situacionit financiar të parashikuar dhe të realizuar të shoqërisë.( Kjo vlerë është pasqyruar në evidencën kontabël nga ana e zyrës së financës).

*Arkëtimi i të ardhurave nga objektet me qira .( nga përlogaritja e grupit të KLSH-së)*

*Tabela (në mijë lekë)*

Parashikimi në 000/lek	Arkëtimi faktik në 000/lek
4,577	3,122

Nr	Subjekti	Data e lidhjes së kontratës	Afati i kontratës	Detyrimi mujor në lekë	Të ardhurat vjetore 000/lek
1	E...A	23.08.2010	20 vjet	124,000	1,488
2	V...B	20.08.2016	1 vit	23,400	281
3	E...A	19.11.2015	1 vit	120,000	1,440
4	A...P	08.02.2016	1 vit	60,000	720
5	U...R	16.03.2017	1 vit	4,800	68
6	A...M	12.12.2016	1 vit	50,000	600
	<b>Shuma</b>				<b>4,577</b>

*Tabela e ndryshuar nga grupi i KLSH.*

**Kriteri:** Programi ekonomik i vitit 2017

**Ndikimi:** Pasqyrim jo i saktë në Asamblenë e Përgjithshme i ambienteve me qira në zotërimin e shoqërisë, të planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga këto ambiente.

**Shkaku:** Pakujdesi në hartim dhe pasqyrim.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga shoqëria të merren masa që në të ardhmen, programet ekonomik-financiar të cilët dërgohen për shqyrtim dhe për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshme të jenë sa më të saktë dhe të pasqyrojnë vlera reale të parashikimit dhe të arkëtimit të të ardhurave për secilin zë.

**Afati:** Në vijim.

**4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.**

**a. Titulli i Gjetjes:** Shoqëria nuk ka të miratuar nivelet e pagave të punonjësve nga Ministria përkatëse.

**Situata:** Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 17.04.2019 është vendosur struktura e shoqërisë dhe numri total i punonjësve prej 404. Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se niveli i pagave nuk ka marrë miratimin e Ministrisë përkatëse.

**Kriteri:** Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” neni 6, pika 1, germa (a).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Ndikimi/Efekti:** Mos respektim i kompetencave të organeve më të larta kontrolluese.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 të marrë masa për plotësimin e procedurave të aprovimit të niveleve të pagave të punonjësve nga Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**b. Titulli i Gjetjes:** Strukturë organike jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit.

**Situata:** Struktura organike e shoqërisë dhe numri i punonjësve/numër studentësh nuk janë parashikuar në raportin (1/15). Konkretisht, u konstatuan diferenca më shumë për vitin 2017, 116 punonjës, për vitin 2018, 107 punonjës dhe për vitin 2019, 124 punonjës.

**Kriteri:** Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 "Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mensave të Studentëve", sipas të cilit raporti punonjës/student duhet të jetë jo më pak se 1/15.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt financiar negativ në vlerën 133,319,414 lekë, për llogari të shoqërisë RSU nr. 1 Tiranë SHA dhe Buxhetit të Shtetit e cila argumentohet sipas tabelës së mëposH...Te:

Nr.	Viti	Nr. mesatar i Studentëve	Numri i punonjësve sipas Udhëzimit të MAS	Numri i miratuar i punonjësve në Strukturë	Diferenca (b-c)	Paga mesatare në lekë	Efekti Negativ (e*d*12 muaj) në lekë
		a	b	c	d	e	f
1	Viti 2017	4315	288	404	116	35,891	49,960,272
2	Viti 2018	4456	297	404	107	35,891	46,040,975
3	Viti 2019	4204	280	404	124	37,706	37,318,167
	<b>Shuma</b>						<b>133,319,414</b>

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrë masa për organizimin e strukturës së shoqërisë në përputhje me raportin punonjës/student, i cili të jetë jo më pak se 1/15 për të rritur efikasitetin e menaxhimit të fondeve të RSU nr. 1 Tiranë SHA.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**c. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime me efekte negative prej largimeve të padrejta nga puna.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të llogarive të shpenzimeve të vitit 2017, për vendimet e proceseve gjyqësore, rezultoi se nga vendimi nr. 3, datë 14.11.2013, i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës, i përbërë nga z. A.H., z. P.N., dhe z. A.LL., për ndryshimet në strukturën dhe organigramën, duke u pasuar me largimet e punonjësve referuar ndryshimeve, proceset gjyqësore të punonjësve të larguar kanë rezultuar në favor të këtyre të fundit, për arsye të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pa shkak dhe për mos njoftime dhe mos respektimin e afateve të ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit sipas Kodit të Punës.

**Kriteri:** Kodi i Punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Ndikimi/Efekti:** Efekt negativ në shumën **7,406,528 lekë** për buxhetin e shoqërisë.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në marrëdhëniet me punonjësit të zbatohen të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet që përcaktohen në Kodin e Punës.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**d. Titulli i Gjetjes:** Mos respektim i të drejtave që burojnë nga kodi i Punës.

**Situata:** Nga verifikimi i listë prezencave u konstatua se 75 punonjës sanitarë, 27 punonjës higjienë, dhe 24 punonjës gjelbërimi gjatë periudhës objekt auditimi, kanë punuar në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare pa urdhër specifik të Titullarit dhe pa përfituar kompensim page ose pushimin respektiv që përcakton kodi.

**Kriteri:** Kodi i Punës, neni 87.

**Ndikimi/Efekti:** Kjo ka sjellë mos respektimin e të drejtave të punonjësve për punën e kryer.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të shoqërisë të marrë masa për kompensimin e punës së kryer nga punonjësit në ditët jashtë orarit zyrtar dhe gjatë festave.

**Afati:** Brenda 6 muajve.

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me projekt raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*

**5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).**

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit me nr. 598/1prot, datë 09.09.2019, i ndryshuar me shkresën nr. 598/2, datë 02.10.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2017
- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2018
- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të prokurimeve për vitin 2019.
- Procedurat me zgjedhje të blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi.
- Shpenzimet e karburantit dhe dokumentacionin e automjeteve,
- Ekstrakti i shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës për vitin 2017,
- Ekstrakti i shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës për vitin 2018
- Ekstrakti i shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës për vitin 2019, si dhe bankat me zgjedhje sipas kërkesës së grupit të auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga auditimi në mënyrë të njëpasnjëshme dhe me zgjedhje, konstatohet se:

**a. Titulli i Gjetjes:** Gjobë ndaj RSU nr. 1 Tiranë SHA për deklarimin me vonesë në Drejtorinë e Tatimeve dhe në QKR.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA ka paguar gjatë vitit 2018 dy gjoba me vlerë 10,000 lekë për shkak të deklarimit me vonesë në tatime mbi fitimin vjetor të shoqërisë dhe 15,000 lekë për deklarimin me vonesë të pasqyrave financiare dhe vendimit të ortakut në QKR.



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

**Kriteri:** Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë në vlerën **25,000 lekë**.

**Shkaku:** Miratimi me vonesë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Programit ekonomik – financiar për vitin 2017.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa që programet ekonomik-financiare ti paraqiten në kohë Asamblesë së Përgjithshme dhe të dërgohen për miratim brenda 4-mujorit të parë të vitit me qëllim shmangien e gjobave dhe rëndimin e buxhetit të Shoqërisë.

**Afati:** Në vijim.

**b. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime të pajustificuara për prokurime me vlera të vogla.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për prokurime me vlera të vogla u konstatua se në 7 raste për mallrat e prokuruar janë bërë hyrje në magazinë pa u kontrolluar nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të mallit për të vërtetuar origjinalitetin e mallit të prokuruar me atë të ardhur në magazinë.

**Kriteri:** Pikat nr. 42, nr. 49, nr. 50 dhe nr. 54 të udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Grupi i auditimit shprehet me rezervë në lidhje me mallrat e prokuruar në shumën **1,670,268 lekë** nga ana e RSU nr. 1 Tiranë SHA.

**Shkaku:** Mos njohja dhe respektimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandime:** Nga shoqëria të merren masa që në të ardhmen, për mallrat që do të prokurohen të kontrollohen nga një grup i marrjes në dorëzim para se ato të bëhen hyrje në magazinën e shoqërisë.

**Afati:** Në vijim.

**c. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime të pa justifikuara për prokurime me vlerë të vogël.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për prokurimet me vlerë të vogël është konstatuar se është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 1 për “Blerje IP Kamera” me fond limit 80,400 lekë. Ky prokurim është kryer pas kërkesës së përgjegjës të marketingut dhe IT z. E.R. dhe Drejtorit të Shërbimeve Studentore znj. O.D. ku sipas tyre 6 kamerat në rezidencat nr. 6, nr. 16, nr. 26-27, nr. 28-29, nr. 20-21 dhe nr. 17 kanë dalë jashtë funksionit. Në dokumentacionin e kësaj procedure nuk ekziston asnjë akt-konstatim i mbajtur nga punonjësit e departamentit të IT në momentin e konstatimit të dëmtimit të kamerave si edhe nga auditimi në magazinë rezultoi se kamerat e zëvendësuara as nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe as janë depozituar në magazinën e shoqërisë por ato mbahen në zyrën e z. E.R.. Nga grupi i auditimit nuk është bërë i mundur vërtetimi mbi gjendjen funksionale të kamerave si edhe nuk justifikohet plotësisht shpenzimi i kryer për blerjen e kamerave të reja.

**Kriteri:** Udhëzimi i Ministrit të Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Efekt negativ për buxhetin e shoqërisë në shumën **76,520 lekë**.

**Shkaku:** Mos njohja dhe respektimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga shoqëria të merren masa që të gjithë punonjësit të cilët kanë në zotërim ose në përdorim aktive të trajnohen në lidhje me detyrat përgjegjësitë dhe kompetencat në drejtim të qarkullimit dhe/apo përdorimit të bazës materiale.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Afati:** Menjëherë.

**d. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime për prokurime me vlera të vogla.

**Situata:** Në datë 02.10.2017 është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 19 për “Blerje pluhur larës dhe detergjent” me fond limit 470,200 lekë. Në këtë procedurë është shpallur fitues operatori ekonomik “D...X” me ofertën 382,200 lekë me TVSh. Tek Specifikimet Teknike është kërkuar që pluhuri larës duhet të ketë përmbajtje të perboratit të natriumit 6-8 %, karbonatit të natriumit 25-30 %, era e parfumit duhet të jetë 10-15 % si edhe pluhuri duhet të jetë me ngjyrë të bardhë dhe me grimca me ngjyra. Nga ana e njësisë së prokurimit nuk është argumentuar vendosja e këtyre specifikimeve.

**Kriteri:** Neni 23 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Mungesë e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.

**Shkaku:** Mos respektimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga njësia e prokurimit të merren masa për argumentimin e vendosjes së specifikime teknike të veçanta, të cilët ndikojnë në uljen e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.

**Afati:** Në vijim.

**e. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime për prokurime me vlera të vogla.

**Situata:** Në datë 07.12.2018 është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 19 për “Blerje kompjuterë, printer, kamera dhe pjesë IT”, ku fitues është shpallur operatori ekonomik “J...P” ShPK me ofertën 420,000 lekë. Nga ana e njësisë së prokurimit nuk është argumentuar vendosja e këtyre specifikimeve.

**Kriteri:** Neni 23 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Mungesë e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.

**Shkaku:** Mos respektimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga njësia e prokurimit të merren masa për argumentimin e vendosjes së specifikime teknike të veçanta, të cilët ndikojnë në uljen e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.

**Afati:** Në vijim.

**f. Titulli i Gjetjes:** Shpenzime për prokurime me vlera të vogla.

**Situata:** Në datë 01.10.2018 është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 11 për “Dezinfektim dhe dezinfektim të godinave”. Në këtë procedurë është shpallur fitues operatori ekonomik “A...O” me ofertën 442,430 lekë me TVSh. Në këtë procedurë është konstatuar se në specifikimet teknike është kërkuar që të paraqiten mostrat e ilaçeve pranë RSU nr. 1 Tiranë SHA një orë para mbylljes së tenderit.

**Kriteri:** Neni 48, pika 4, neni 51, pika 1 i ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

**Shkaku:** Mos respektimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Nga njësia e prokurimit të merren masa që në të ardhmen të respektohet dhe të veprohet konform ligjeve për prokurimin publik.

**Afati:** Në vijim.

**6. Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.**

**a. Titulli i Gjetjes:** Mos përdorimi i programeve kompjuterikë për mbajtjen e kontabilitetit.

**Situata:** Shërbimi kontabël në Shoqëri realizon regjistrimet e veprimeve kontabël në Excel, dhe jo me *“Bartës informatik”*, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

**Kriteri:** Ligji nr. 25/2018, *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, Neni 11. Qëllimi i pasqyrave financiare.

**Ndikimi:** Prezencë e riskut për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar kështu në vendimmarrjen e drejtimit të shoqërisë.

**Shkaku:** Mungesa e fondeve dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për pajisjen e Departamentit të Planifikimit Financiar dhe Buxhetit, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

**Afati:** Menjëherë.

**b. Titulli i Gjetjes:** Mos paraqitje e saktë e zërit të aktiveve troje të Shoqërisë.

**Situata:** Në lidhje me zërin e trojeve u konstatua se procesin e marrjes së certifikatave të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa Shoqëria e ka nisur në vitin 2009 pas daljes së VKM nr. 403 datë 22.04.2009 *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr. 1 Tiranë”*. Në vitin 2015 ka përfunduar procesi i marrjes së certifikatave të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa për Shoqërinë. Pas përfundimit të këtij procesi rezultoi se rreth 16 pjesë të pronës së Shoqërisë kanë rezultuar me pronarë të tjerë në ZRPP, Tiranë, me një sipërfaqe totale prej 59,431 m<sup>2</sup> dhe për këto sipërfaqe nuk janë marrë certifikata pronësie. Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë marrë masat për korrigjimin e zërit të bilancit troje për sipërfaqet që nuk rezultojnë në pronësi të RSU nr. 1 Tiranë SHA. Lista e inventarit të shoqërisë është miratuar me VKM nr. 403 datë 22.04.2009 dhe ka një sipërfaqe totale të truallit prej 248,436 m<sup>2</sup>.

**Kriteri:** Ligji Nr. 9228, datë 29.4.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare”*, Neni 9, Respektimi i standardeve kontabël, pika,1, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit, nr. 1, *“Kudri i Përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, i Përmirësuar”* paragrafi , nr. 70 në lidhje me *rëndësinë dhe materialitetin*, SKK nr. 5 *“Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”*- i përmirësuar, pika 8, njohja e AAM.

**Ndikimi:** Paraqitje e jo e saktë dhe e besueshme e pasqyrave financiare të shoqërisë, duke sjellë dhe rritjen e riskut për mos ruajtjen e aktiveve.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Nga drejtimi i shoqërisë dhe departamenti i financës dhe departamentet përkatëse duhet të kryhet analiza e situatës së asetëve të shoqërisë, të vlerësohet shuma që do të korrigjohet dhe pas miratimit nga ortaku të reflektohet në pasqyrat financiare të periudhës përkatëse në zërin e shpenzimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Afati:** Në vijim.

**c. Titulli i Gjetjes:** Humbja e titullit të pronësisë për 74,509 m<sup>2</sup> sipërfaqe tokë truall.

**Situata:** Në lidhje me pajisjen me certifikata të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa, Shoqëria ka filluar procesin që në vitin 2009 pas daljes së VKM nr. 403 datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve nr. 1 Tiranë” dhe ka përfunduar regjistrimin e gjithë ndërtesave dhe truallit pranë ZVRPP-së më datë 06.01.2015. Kjo sipërfaqe është e ndarë në dy zona Kadastrale, përkatësisht 8160 dhe 8190. Trualli që i përket zonës Kadastrale 8160 është regjistruar më datë 23.06.2014, ndërsa trualli që i përket zonës Kadastrale 8190 ka përfunduar regjistrimin më 06.01.2015. Nga territori i përgjithshëm i zonës Kadastrale nr. 8160 në pronësi të RSU nr. 1 Tiranë SHA është regjistruar pranë ZVRPP-se territori me sipërfaqe prej 105,669 m<sup>2</sup>, ndërsa në zonën Kadastrale me nr. 8190 është regjistruar territori me sipërfaqe prej 40,634 m<sup>2</sup> dhe 27,604 m<sup>2</sup> truall poshtë ndërtesave të godinave.

Në total territori i regjistruar është 173,907 m<sup>2</sup> nga të cilat 146,303 m<sup>2</sup> janë truall dhe 27,604 m<sup>2</sup> trualli i ndërtimeve të godinave, duke lënë jashtë territorit 74,509 m<sup>2</sup> nga të cilat rreth 67,081 m<sup>2</sup> janë deklaruar në VKM nr. 403 datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve nr. 1 Tiranë”, si të bllokuara nga ndërtime informale dhe 7,448 m<sup>2</sup> të shtuara nga periudha 2009-2013. Në vitin 2017 Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë ka bllokuar pasurinë truall të RSU nr. 1 Tiranë SHA, me numër pasurie 5/611, zona Kadastrale nr. 8160, me sipërfaqe 105,669 m<sup>2</sup>, e lëshuar me datë 16.06.2014, duke pretenduar mbivendosjen me dy zona të tjera 5/627 dhe 5/628, zona Kadastrale nr. 8160, të lëshuara më datë 07.07.2017. Regjistrimi i këtyre pasurive ka ardhur si pasoje e vendimit nr. 365, datë 19.12.2008 të ZRKKP Qarku Tiranë, vendimit nr. 5743, datë 12.05.2014, të Gjykatës të Rrethit Tiranë, për kthimin e dy sipërfaqeve me shumë totale 9650 m<sup>2</sup> si dhe lënies në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë me vendimin e marrë datë 05.05.2015.

**Kriteri:** Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 5; VKM nr. 403, datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrative shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr. 1””; Statuti i Shoqërisë të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, neni 16, Inventari-llogaritë vjetore.

**Ndikimi/Efekti:** Efekt financiar negativ me vlerë në shumën **3,178,030,542 lekë**, nga të cilat:

1. Efekt financiar negativ për shoqërinë me vlerë të paktën **2,264,319,155 lekë** nga humbja e sipërfaqes prej 67,081 m<sup>2</sup>, e zënë me ndërtime informale, të ndodhura në një periudhë kohore të paqartë, por që përbëjnë asete të cilat i janë zbritur totalit të aktiveve të shoqërisë, kjo deri në vitin 2009.

(Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” për zonat Kadastrale, Tiranë, 8160 dhe 8190, ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën më të vogël prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>).

2. Efekt financiar negativ prej **247,377,872 lekë** si pasojë e mos marrjes së certifikatave të pronësisë për 7,448 m<sup>2</sup> nga viti 2009 e në vijim.

(Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” për zonat Kadastrale, Tiranë, 8160 dhe 8190, ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën më të vogël prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

3. Efekt financiar negativ prej **643,616,400 lekë** si pasojë e tre vendimeve në lidhje me kthimin dhe kompensimin e të drejtës së pronësisë në kundërshtim me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004, i ndryshuar, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, neni 7, “*Pronat që nuk kthehen (ndryshuar me ligjin nr. 9583, datë 17.07.2006), 1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik.*”.

(Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” për zonën Kadastrale, Tiranë, 8160 ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën prej 66,969 lekë për m<sup>2</sup>).

4. Efekt financiar negativ prej **22,717,115 lekë** si pasojë e vendimeve të ZRKKP dhe Gjykatave për kthimin e sipërfaqes prej 673 m<sup>2</sup> që i përkasin zonës Kadastrale nr. 8190.

(Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” për zonën Kadastrale, Tiranë, 8190 ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>).

**Shkaku:** Humbje e asetëve nga mosveprimet e ish – Drejtuesit e Administratës së RSU nr. 1 Tiranë SHA si pasojë mos kryerjes së veprimeve ligjore për marrjen e certifikatave të pronësisë të pronës truall para dhe pas vitit 2009 si dhe prej vendimeve të Gjykatave dhe ZRKKP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për vlerësimin e situatës, apelimet në institucionet përkatëse për mbrojtjen e pronësisë së aktiveve të shoqërisë dhe saktësimet në pasqyrat financiare.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**d. Titulli i Gjetjes:** Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve.

**Situata:** Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika 30.

**Ndikimi:** Risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**e. Titulli i gjetjes:** Përdorim i normave të amortizimit të pa miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

**Situata:** Në përgatitjen e pasqyrave financiare normat për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale janë të pa vlerësuara dhe aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

**Kriteri:** Ligji Nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”; Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare - i përmirësuar, pika 103; Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, pika 39.

**Ndikimi/Efekt:** Efekte ekonomike në rezultatin përfundimtar të Shoqërisë.

**Shkaku:** Mos vlerësimi i drejtë i situatës së aktiveve të shoqërisë, duke sjellë shtrembërime në rezultatin financiar të shoqërisë.





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Nga Drejtimi i shoqërisë të merren masa për aprovimin e normave menaxheriale, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**f. Titulli i Gjetjes:** Mos kryerja e proceseve të inventarizimit konform procedurave.

**Situata:** Komisionet e ngarkuara me inventarizimet e aktiveve të shoqërisë për periudhat 2017 e 2018, kanë mbajtur vetëm proces verbale lidhur me gjendjen materialeve në dorëzim dhe nuk kanë përpiluar një raport për inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendet fizike si dhe vërejtjet lidhur me to.

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenet 83 e 85.

**Ndikimi:** Paraqitje e riskut për mos pasjen e qartë të situatës nga drejtimi, të aktiveve që shoqëria ka në dispozicion.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit dhe mosnjohja e legjislacionit.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** Administratori i shoqërisë duhet të marrë masa që komisionet e inventarizimit të kryejnë procedurat përkatëse duke paraqitur vlerësimet e tyre në raportet përfundimtare.

**Afati:** Në vazhdimësi.

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me Projekt Raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*

## 7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Lista e prokurimeve të periudhës 01.01.2017 – 31.08.2019;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si auditues;

Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi në total janë realizuar **13** procedura prokurimi nga të cilat u audituan **13** procedura, ose 100 % e tyre. Shprehur në vlerë, janë prokuruar fonde me vlerë **294,844,480 lekë pa TVSh** dhe nga kjo shumë u audituan 100 % e tyre. Për këto 13 procedura prokurimi janë lidhur kontratat përkatëse në shumën totale prej **276,493,237 lekë pa TVSh**, ose me një diferencë nga vlera e prokuruar prej 21,351,243 lekë pa TVSh ose 6 %. Në 11 procedura nga 13 në total, rezulton se fitues është shpallur OE me ofertën më të ulët. Për sa i përket procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i godinave 11 – 12”, me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh, vlerë kjo e cila përbënte gati 85 % të gjithë vlerës së kontratave, auditimi i saj u krye për dokumentacionin e disponuar brenda periudhës objekt auditimi, pra deri në 31.08.2019. Rrjedhimisht, kjo procedurë do të jetë objekti i auditimeve pasardhëse. Konkretisht tabela:

Nr.	Procedura prokurimi	Procedura	Fondi limit
-----	---------------------	-----------	-------------



KONTROLLI I LARTË I SHITIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Nr.	Procedura prokurimi	Procedura	Fondi limit
A	Viti 2017		
1	Kërkesë për propozim	3	7,288,669
	Shuma A	3	7,288,669
	<b>Audituar nga KLSH</b>	<b>3</b>	<b>7,288,669</b>
-	<b>në % ndaj procedurave të kryera</b>	<b>100 %</b>	<b>100 %</b>
B	Viti 2018		
1	Kërkesë për propozim	6	10,208,334
	Shuma B	6	10,208,334
	<b>Audituar nga KLSH</b>	<b>6</b>	<b>10,208,334</b>
-	<b>Në % ndaj procedurave të kryera</b>	<b>100 %</b>	<b>100 %</b>
C	1 Janar – 31 Gusht 2019		
1	Kërkesë për propozim	2	9,833,333
2	E Hapur	2	267,514,144
	Shuma C	4	277,347,477
	<b>Audituar nga KLSH për periudhën objekt auditimi*</b>	<b>4</b>	<b>277,347,477</b>
-	<b>Në % ndaj procedurave të kryera</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<b>PËRMBLEDHËSE</b>			
	Kërkesë për propozim	11	27,330,336
	Procedura e hapur	2	267,514,144
	Totali A + B + C	13	294,844,480
	<b>Audituar nga KLSH për periudhën objekt auditimi</b>	<b>13</b>	<b>294,844,480</b>
-	<b>Në % ndaj procedurave të kryera</b>	<b>100 %</b>	<b>100 %</b>

Mangësitë e konstatuara për procedurat e auditimit në mënyrë të detajuar, paraqiten si më poshtë:  
**a. Titulli i gjetjes:** Nuk është caktuar personi/personat përgjegjës për prokurimin për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nga ana e Titullarit të AK nuk janë marrë masa për emërimin dhe dërgimin e personit/personave përgjegjës për prokurimet në APP.

**Kriteri:** VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 57, pika 1.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e një administrimi të rregullt në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit i cili është reflektuar edhe në mangësitë e konstatuara përgjatë të gjitha procedurave të prokurimit.

**Shkaku:** Mungesa e emërimit të personit/personave nga ana e Titullarit për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për emërimin e personit/personave përgjegjës për procedurat e prokurimit me qëllim administrimin e rregullt të tyre në përpunje me kuadrin rregullator përkatës.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**b. Titulli i gjetjes:** Krite në kundërshtim me LPP dhe RrPP.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 2 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2017

është vendosur ndër të tjera kriteri që: “Dy ditë pas hapjes së ofertave ofertuesit do të sjellin mostrat e mëposh...Te të mallit (ende pa përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave)”.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 48, pika 4, paragrafi dytë, neni 51, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 58, paragrafi i fundit.

**Ndikimi/efekti:** Shmangie nga parimet e Ligjit të Prokurimit Publik.

**Shkaku:** Mos njohje e mirë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**c. Titulli i gjetjes:** Kriteret në kundërshtim me LPP dhe RrPP.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 6 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2017;

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2018;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2018;

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2019;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2019;

në DST nga NJP nuk është parashikuar grafiku i lëvrimit të mallit por vetëm afati ditor i dorëzimit të tij. Gjithashtu, në 2 raste (1 rast në 2018 dhe 1 rast në 2019) në DST nga NJP është parashikuar afati 45 ditë për ekzekutimin e kontratës, në një kohë kur specifikimet teknike kanë parashikuar një citim si më poshtë: “*materialet inerte, çimento, dërrasa, gëlqerja do të furnizohen në mënyrë periodike sipas kërkesave të AK për efekt magazinimi, duke mos tejkaluar muajin Korrik 2019*” pra duke krijuar mos përputhje mes afatit të zbatimit të kontratës dhe afatit të dorëzimit të mallit.

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Kreu I, neni 11, pika 3, germa b si dhe Kreu II, Seksioni 2, neni 27.

**Ndikimi/efekti:** Vendosje e kriterëve konfuzë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

**Shkaku:** Mos njohje e mirë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa evidentimin e saktë të nevojave për mallra duke u bazuar në eksperiencën e viteve të mëparshme me qëllim hartimin sa më të saktë të grafikut të lëvrimit të mallit. Gjithashtu, afati i lëvrimit të mallit dhe të vendoset i njëjtë me atë të zbatimit të kontratës.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**d. Titulli i gjetjes:** Kriteret në kundërshtim me LPP dhe RrPP.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 2 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2018;

në DST, në brendësi të preventivit rezulton se janë kërkuar materiale elektrike të cilat përmendin marka.

**Kriteri:** Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5.

**Ndikimi/efekti:** Vendosje e kriterëve kufizuese për tregtimin e produkteve të tjera ekuivalente me produktet për të cilat u është përmendura marka.

**Shkaku:** Mos njohje e mirë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E ulët.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa që në hartimin e DST të shmang përdorimin e markave pa vendosur fjalën ekuivalent.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**e. Titulli i gjetjes:** Kriteret të paargumentuara dhe/apo jo në përputhje me nevojat e objektit të prokurimit.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 9 raste konkretisht:

a) Në 2 procedura në vitin 2017:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”;

në 3 procedura në vitin 2018:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”;

“Lyerje e Godinave me Gëlqere”;

në 2 procedura në vitin 2019:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”;

“Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”;

në DST është kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të zotërojë certifikatën ISO 9001:2008” apo “Operatori ekonomik duhet të zotërojë certifikatën ISO 18001:2007”. Në fakt, vendosja e kriterëve të tilla, të shprehura në të njëjtën mënyrë siç është paraqitur në DST rezulton se nuk lidhet ngushtë me nevojat konkrete të kontratës së blerjes pasi nuk është specifikuar fusha në të cilët duhet të jenë të certifikuar OE pjesëmarrës por është kërkuar thjesht që OE të jenë të pajisur me këto dy certifikata;

b) Në 1 procedurë në 2019, konkretisht atë me objekt “Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”, me vlerë të fondit limit 20,040,052 lekë pa TVSh, rezulton se:

- janë kërkuar 5 pika licencash zbatimi nga të cilat 3 prej tyre nuk lidhen me nevojat e objektit të prokurimit;

- nuk është i argumentuar teknikisht mënyra e përcaktimit për 10 muratorë, 6 bojaxhinj dhe 2 elektrikistë në një kohë kur në total janë kërkuar 65 punëtorë.

- është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Në fakt, vendosja e këtij kriteri nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe nuk lidhet aspak me nevojat e investimit pasi, ISHTI sikundër edhe është emërtuar (Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial), ka kompetenca Inspektimi dhe jo për të lëshuar dëshmi kualifikimi e si rrjedhojë nuk



KONTROLI I LARTË I SHITIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

duhej vendosur dhe miratuar si kriter për gjithë stafin e punës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender.

c) Në 1 procedurë në 2019, konkretisht atë me objekt “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh, në lidhje me DST rezultoi se:

Nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e vendosura në lidhje me:

- Numrin total të punonjësve. Ky numër nuk është argumentuar në përputhje me grafikun e realizimit dhe zërat e preventivit të punimeve me qëllim lehtësimin edhe të vlerësimit të punëtorisë në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë;
- Kriterin “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori dhe certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit/distributorit të autorizuar, ose një vetë deklaram nga ofertuesi pjesëmarrës që prodhuesi është i certifikuar me ISO 9001:2015 i cili do të jetë objekt verifikimi nga AK, për pajisjet e pasqyruara në preventiv, për:*”
  - *Autorizim prodhuesi/distributori për sistemet e akses kontrollit;*
  - *Autorizim prodhuesi/distributori për kaldaja.*

*Në rast se autorizimi do të merret nga prodhuesi, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me anë të një autorizimi/kontrate midis tyre dhe prodhuesit; Në rastin e marrjes së autorizimit nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me distributorin e autorizuar me anë të një autorizimi/kontratë midis tyre.”*

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, nuk lidhet ngushtë me nevojat e investimit në fjalë dhe as nuk shpreh qartësisht se për çfarë duhet ky autorizim (për furnizim, për tregtim me shumicë/pakicë, transportim etj., pra e thënë ndryshe se për çfarë kërkohet të autorizohen OE pjesëmarrës). Ky kriter nuk përcakton nevojat konkrete se nga lind domosdoshmëria për një autorizim të tillë dhe nuk ka përcaktuar qartë objektin e autorizimit.

- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë kategorinë e licencës **NS 19 A Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë**. Në fakt, referuar përshkrimit të kësaj pike licence rezultoi se në tek kjo kategori përfshin punime zbatimi si më poshtë:

*“Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopjo, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zë izoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve”.* Referuar preventivit të punimeve kjo pikë licence është e panevojshme;

- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Në fakt, vendosja e këtij kriteri nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe nuk lidhet aspak me nevojat e investimit pasi, ISHTI sikundër edhe është emërtuar (Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial), ka kompetenca Inspektimi dhe jo për të lëshuar dëshmi kualifikimi e si rrjedhojë nuk duhej vendosur dhe miratuar si kriter për gjithë stafin e punës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh).

neni 20 neni 46 VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, neni 26, pika 3, pika 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, neni 27, pika 3i, neni 61, pika 2, VKM nr. 410 datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, pika 1.

**Ndikimi/efekti:** Ulje e eficiencës, efikasitetit, mirë përdorimit të fondeve publike, ulje e konkurrencës si dhe krijimi i konfuzionit mes OE.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve diskriminuesë, të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht dhe mos njohje e bazës ligjore për prokurimet.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Komisionet e ngritura për hartimin e Kriterëve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të vendosur si kushte për kualifikim vetëm kriterë të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë me Investimin / mallin / shërbimin. Gjithashtu, nga ana e Shoqërisë të merren masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik.

**Afati:** Në vazhdimësi

**f. Titulli i gjetjes:** Kualifikim i OE me mangësi në dokumentacion.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për vitet 2017, 2018 dhe deri më 31.08.2019, në 4 raste, përkatësisht në procedurat:

- “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*”, viti 2017 me vlerë të fondit limit 3,622,000 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 3,482,010 lekë pa TVSh;
- “*Lyerje e godinave me gëlqere*”, viti 2018 me vlerë të fondit limit 4,084,140 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 1,989,432 lekë pa TVSh;
- “*Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29*”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 20,040,252 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 17,744,410 lekë pa TVSh;
- “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës së vetme të kualifikuar 232,793,719 lekë pa TVSh;

nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit dhe/apo kanë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Nga këto, në 2 raste, konkretisht në procedurat “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*”, viti 2017 dhe “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, viti 2019, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re dhe në dy rastet e tjera duhet të ishte shpallur fitues OE pasardhës pasi OE të shpallur fitues janë rezultojnë me mangësi në dokumentacion. Konkretisht nga auditimi rezultoi se:

- a) Në vitin 2017 në procedurën me objekt “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*” OE “*M...D*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përbushur kriterin në lidhje me Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore për Tatimpaguesin. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar;
- b) Në vitin 2018 në procedurën me objekt “*Lyerje e godinave me gëlqere*” OE “*F...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përbushur kriterin në lidhje me Stafin teknik të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;
- c) Në vitin 2019 në procedurën me objekt “*Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29*” OE “*I...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

1. Në lidhje me Stafin jo vetëm që janë paraqitur kontrata pune për 17 punëtorë nga 18 të kërkuar por njëkohësisht janë paraqitur 17 dëshmi kualifikimi të lëshuara nga subjekti “H...M” ShPK. Referuar dokumentacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në faqen Web të kësaj Drejtorie <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> rezulton se ky subjekt është i akredituar si organizëm certifikimi personeli që certifikon personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/ IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli” dhe jo për punime ndërtimi. Njëkohësisht referuar dokumentacionit të QKB rezulton se subjekti “H...M” ShPK me NIPT K9...4D ka si objekt të aktivitetit të tij “...Certifikim personeli sipas standardit EN ISO/IEC 17024, për sigurimin teknik në fushën elektrike”;

Për punonjësit, F. K, i paraqitur si punonjës me profesion Bojaxhi dhe A. M, E. Rr, I. Z, K. Z L. Gj dhe V. H të paraqitur si punonjës me profesion Murator, në fakt sipas listë pagesave rezultojnë përkatësisht *Teknik Ndërtimi* (F. K), *Shtrues Pllakash* (A. M, E. Rr, L. Gj dhe V. H) dhe *Punëtor Krahu* (I. Z dhe K. Z). Pra këta punonjës nuk plotësojnë kushtin që lidhet me pasqyrimin e tyre në listë pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit;

2. Nga ana e OE “I...A” ShPK nuk është deklaruar e saktë Shtojca 11 “*Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces*” pasi sipas buletinit nr. 25 të datës 24.06.2019 ky OE është shpallur fitues i një kontrate me objekt “*Rikonstruksioni i Bibliotekës së Qytetit NjA 11*” me vlerë 1,748,456 lekë pa TVSh ose 2,056,978 lekë me TVSh me afat 7 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Pas shpalljes fitues për këtë objekt, sipas buletinit nr. 26 të datës 01.07.2019, është lidhur kontrata mes AK Bashkia Tiranë dhe OE “I...A” ShPK;

3. Në pikën 10 janë kërkuar dy mjete me tonazh deri në 5 ton. Në fakt SPE rezulton se si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e OE të shpallur fitues është paraqitur mjeti me targa AA...UL ka një kapacitet prej 3.5 ton dhe mjeti me targa AA...AV ka një kapacitet prej 7.5 ton duke mos përmbushur kështu këtë kriter të DST;

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e OE “I...A” ShPK janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;

d) Në vitin 2019 në procedurën me objekt “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*” BOE “E...O” ShPK është i vetmi ofertues i kualifikuar edhe pse nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:

**E...N**

- Sipas dokumenteve të tenderit preventivi i punimeve ka parashikuar një fond rezervë prej 3 % kurse oferta ekonomike e BOE të kualifikuar rezulton se ka parashikuar një fond rezervë prej 5 % duke mos ju përmbajtur kështu strukturës së parashikuar nga projektuesi /preventivuesi;
- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE nuk e plotëson këtë kriter pasi referuar dokumentit të paraqitur nga OE si dëshmi për përmbushjen e kriterit është paraqitur një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.05.2019. Nisur nga fakti që është kërkuar që ky specialist të figurojë të paktën 3 muajt e fundit si dhe faktit se zhvillimi i procedurës është zhvilluar me datë 11.07.2019, rezulton se në momentin e zhvillimit të procedurës ky punonjës



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

nuk ka përmbushur kriterin e të qenit 3 muaj i punësuar si i ekspert zjarrfikës i certifikuar. Gjithashtu, referuar listë pagesave rezulton se ky punonjës, përgjatë muajve, janar – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, është paguar si Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë dhe asnjë muaj si ekspert zjarrfikës;

- Për dy specialistë termoteknikë është kërkuar si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontratat e punës dhe diplomat/dëftesat përkatëse, libreza e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE ka paraqitur dy certifikata, konkretisht për D. Ll dhe A. H. Pra në asnjë rast nuk janë paraqitur diplomat/dëftesat për termoteknikë. Gjithashtu, kontrata e lidhur me D. Ll rezulton se është e lidhur mes palëve (punëdhënësit “E...N” ShPK dhe punëmarrësit D. Ll) me përshkrim pune Inxhinier Civil dhe jo termoteknik. Për sa i përket listë pagesave rezulton se D. Ll është paguar si “*Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë*” kurse A. H. është paguar si “*Specialist për tavane me gips*”, një profesion ky i cili bën pjesë në kategorinë *Suvatues* dhe kurrsesi pa asnjë lidhje me termoteknikën.

- Për sa i përket deklaratës në lidhje me Shtojcën nr. 8 Deklaratë mbi Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme, rezulton se G.K. i cili është deklaruar si inxhinier mekanik dhe Drejtues teknik i objektit në fjalë, referuar listë pagesave për të paktën periudhën janar 2018 – maj 2019 është paguar si teknik mekanik dhe jo si inxhinier mekanik;

- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:*

- Teknik ndërtimi të mesëm, 2 ( dy ) me diplomë/dëftesë përkatëse-(kategoria I);

Rezulton se njëri nga teknikët nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si teknik ndërtimi pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 06.01.2017 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori D. D është paguar si Karpentier dhe jo si teknik ndërtimi për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Elektracist 3 ( tre ) - (kategoria minimumi II);

Rezulton se dy nga të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si elektracist pasi, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 01.06.2017 dhe 06.01.2017 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jetë fiktive, punëtorët F. D dhe A. K janë paguar si Punëtor mirëmbajtës dhe jo si Elektracist për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Njëri tjetër nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si elektracist pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 01.06.2017 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori M. M është paguar si Marangoz dhe jo si Elektracist për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Hidraulikë 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Njëri nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si hidraulik pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 17.10.2018 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori Q. M është paguar si Karpentier dhe jo si Hidraulik për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Karpentierë 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Njëri nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si karpentier pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 17.01.2017 e cila sipas





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori N. H është paguar si Suvatues dhe jo si Karpentier për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Bojaxhinj 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Njëri nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si bojaxhi pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 01.10.2017 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori A. Sh është paguar si Punëtor i pastrimit të rrugëve dhe jo si Bojaxhi për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Mekanik 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

I punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si mekanik pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 01.10.2016 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori S. K është paguar si Drejtues i makinave të pastrimit të rrugëve dhe jo si Mekanik për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Saldatorë 3 ( tre ) - (kategoria minimumi I);

Njëri nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si saldator pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 17.01.2017 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori E. H është paguar si Punëtor mirëmbajtës mekanik i makinerive të kabllave dhe jo si Saldator për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Pllakashtrues 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Njëri nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si pllakashtrues pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 21.11.2016 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori I. G është paguar si Magazinier dhe jo si Pllakashtrues për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Hekurkthyes 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

I punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si hekurkthyes pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 03.11.2016 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori V. K është paguar si Punëtor i pastrimit të rrugëve dhe jo si hekurkthyes për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Suvatues 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si suvatues pasi, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 08.11.201 dhe 29.08.2018 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, punëtorët A. F dhe S. K janë paguar përkatësisht si Punëtor krahu ndërtimi dhe Zhblllokues kanalesh/pusetash dhe jo si suvatues për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Punëtor ndërtimi 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

I punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si punëtor ndërtimi pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 07.02.2018 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori K. Q është paguar si Punëtor i pastrimit të rrugëve dhe jo si Punëtor ndërtimi për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Specialist për punime durale 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Asnjë nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si specialistë për durale, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 24.06.2018 dhe 08.11.2018 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, pasi K. Zh është paguar si Saldator



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

dhe E. B është paguar si Punëtor krahu ndërtimit dhe jo si specialistë për punime durale, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Specialist për punime druri 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Asnjë nga të punësuarit nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si specialistë për punime druri, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 03.11.2016 dhe 09.11.2018 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, pasi Y. D është paguar si Magazinier dhe S. G është paguar si Punëtor i pastrimit të rrugëve dhe jo si specialistë për punime druri, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Specialist për punime PVC dhe gome 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Asnjë nga të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si specialistë për punime PVC dhe gome, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 30.03.2018 dhe 30.10.2018 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, pasi A. Z është paguar si Marangoz dhe N. H është paguar si Punëtor i pastrimit të rrugëve dhe jo si specialistë për punime PVC dhe gome, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Specialist të certifikuar për punime në lartësi 3 ( tre ) - (kategoria minimumi I);

Asnjë nga të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë, pasi pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 17.02.2017, 28.05.2017 dhe 01.06.201 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, pasi M. I është paguar si Bojaxhi dhe F. R dhe V. K janë paguar si Ekonomistë dhe jo si specialistë për punime në lartësi, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Nga ana e OE janë paraqitur si dëshmi për specialistë të certifikuar për punime në lartësi edhe për dy punëtorë të tjerë, H. K dhe A. Sh të cilët nga ana e KVO nuk duhet të ishin marrë në konsideratë pasi referuar kërkesave të NJP është kërkuar që në total të jenë të paktën 36 punonjës me specialitete të veçanta dhe jo të ketë një apo më shumë punëtorë që mbulojnë dy apo më shumë profesione.

Nga sa më sipër rezulton se janë pasqyruar dëshmi në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 10 punëtorë nga të paktën 48 të tillë që i takojnë OE "E...N" ShPK në raport me pjesën takuese (44 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

### **ALBA**

- Eksperti Zjarrfikës në muajt shkurt, mars, prill dhe maj 2019 ka punuar si Inxhinier ndërtesash dhe jo si ekspert zjarrfikës. Për rrjedhojë ky OE nuk e përmbush këtë kriter pasi nuk rezulton në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit;
- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

Rezulton se:

- Specialist të certifikuar për punime në lartësi 3 ( tre ) - (kategoria minimumi I);

Asnjë nga të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë, pasi pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 15.01.2019 dhe 01.01.2019 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, A. M është paguar si Saldator dhe B. B është paguar si Marangoz, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu, për këta dy punëtorë nuk janë paraqitur dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik.

- Elektracist 3 ( tre ) - (kategoria minimumi II);



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

Nga 6 punëtorë të paraqitur rezulton se për R. Q, Sh. S dhe P. M mungojnë kontratat e punës. Nga tre të punësuarit e tjerë, për një prej tyre rezulton se nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si elektrikistë pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 05.08.2017 e cilat sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori F. M është paguar si Drejtues ekskavatori dhe jo si Elektricitist për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti.

- Karpentierë 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

I punësuarit N. L nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si karpentier pasi, pavarësisht kontratës individuale të punës të lidhur më 05.07.2016 e cila sipas fakteve rezulton të jetë fiktive, punëtori N. H është paguar si Shofer Kamioni dhe jo si Karpentier për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Mekanikë 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Nga dy të punësuarit rezulton se me punëtorin Xh. K është lidhur kontratë për elektromekanikë dhe jo për mekanikë dhe dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknike është dhënë për elektromekanik. Gjithashtu, në listë pagesa ky punonjës figuron si punëtor murature. Për sa i përket punonjësit M. H rezulton se është paguar si karpentier. Nga sa më sipër rezulton se nuk përmbushet kriteri mbi pasqyrimin e këtyre punonjësve në listë pagesa, sikundër është kërkuar.

- Pllakashtrues 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Të tre të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si pllakashtrues pasi, pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më datë 09.01.2017, 23.05.2017 dhe 19.07.2017 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, punëtorët E. Sh, D. D dhe E. D I. G janë paguar përkatësisht si muratorë, Punëtor krahu në ndërtim dhe Bojaxhi jo si Pllakashtrues për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;

- Suvatues 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);

Të tre të punësuarit nuk plotësojnë kriteret e vendosura pasi, Q. Xh kontrata e lidhur me datë 15.01.2019 e cila sipas fakteve rezulton të jenë fiktive, tregon se ky punonjës është paguar si Punëtor krahu ndërtimi, pra nuk figuron në listë pagesa si suvatues. Për sa i përket dy punëtorëve të tjerë A. Y dhe A. V asnjë prej tyre nuk figuron në listë pagesa si i punësuar për periudhën e kërkuar. Për A. V nuk rezulton asnjë kontratë pune;

Nga sa më sipër rezulton se nuk janë pasqyruar dëshmi të plota në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 17 punëtorë nga të paktën 56 të tillë që i takojnë OE "A...N" ShPK në raport me pjesën takuese (51 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

### **ARKON**

- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas materialeve të ngarkuara në sistem nga ky OE është paraqitur si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.04.2015 për L. D. Në fakt, referuar listë pagesave kjo punonjëse, përgjatë muajve shkurt – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, figuron si *Inxhinierë mjedisi për trajtim ujërash* (pavarësisht se nuk ka kryer asnjë ditë punë) dhe në asnjë muaj nuk figuron si ekspert zjarrfikës, ndryshe nga sa është kërkuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

Rezulton se:

- Specialist të certifikuar për punime në lartësi 3 ( tre ) - (kategoria minimumi I);  
Asnjë nga të punësuarit nuk plotësojnë kriterin e të qenit të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë, pasi pavarësisht kontratave individuale të punës të lidhura më 10.05.2019, 06.05.2019, 06.05.2019 dhe 06.05.2019 të cilat sipas fakteve rezultojnë të jenë fiktive, P. H është paguar si Elektracist, O. M është paguar si Hekurkthyes dhe Sh. A është paguar si Bojaxhi, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu, për këta punëtorë nuk janë paraqitur dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik.

- Elektracist 3 ( tre ) - (kategoria minimumi II);  
Punëtori i paraqitur rezulton se nuk përmbush kriterin e kategorisë pasi rezulton të jetë kategoria e I kur në fakt është kërkuar minimumi kategoria II.

- Specialist për punime druri 2 ( dy ) - (kategoria minimumi I);  
I punësuar nuk plotëson kriterin e të qenit i përfshirë në listë pagesat e shoqërisë si specialist për punime druri, pasi N. K. është paguar si Punëtor krahu ndërtimi dhe jo si specialist për punime druri, për të paktën periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, kjo pavarësisht kontratës individuale të punës e lidhur më 03.06.2019 e cilat sipas fakteve rezulton të jetë fiktive;

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e BOE janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi pasi kontratat e lidhura mes palëve janë fiktive dhe nuk përputhen me dokumentacionin e ngarkuar në SPE. Në total ky BOE nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe në këto kushte duhet të ishte s'kualifikuar. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar pasi nga auditimi rezultoi se BOE i mësipërm është i vetmi ofertues i kualifikuar. Sipas verifikimit në faqe e APP, referuar buletinit nr. 36 datë 09.10.2019 rezulton se është bërë shpallja e fituesit i cili rezulton të jetë BOE i vetëm i kualifikuar.

**Kriteri:** ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 2, germa a dhe c, neni 24, pika 1, germa ç, neni 53, pika 3, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 66 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1.

**Ndikimi/efekti:** Kualifikimi i OE të cilët nuk kanë kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës në përputhje me parashikimet e saj, ulje e eficiencës, efikasitetit, mirë përdorimit të fondeve publike, ulje e konkurrencës si dhe trajtimi jo i barabartë mes OE pjesëmarrës.

**Shkaku:** Mos shqyrtimi me korrektësi i dokumentacionit të paraqitur nga OE.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA dhe komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave/ankesave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**g. Titulli i gjetjes:** Qëndrim me dy standarde në lidhje me vlerësimin e ofertave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në procedurën me objekt “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*” nga ana e KVO dhe KSHA janë mbajtur qëndrime të ndryshme për mangësi të njëjta në të paktën tre raste. Konkretisht kjo argumentohet si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 83 me nr. 140 prot., datë 06.06.2019 të Titullarit është pezulluar procedura e Prokurimit deri në trajtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra nga APP. Me shkresën nr. 331 prot., datë 06.06.2019 është bërë ankesë nga OE “*K...N*” ShPK për 5 kritere. Me shkresën nr. 325 prot., datë 05.06.2019 është bërë ankesë nga OE “*S...I*” ShPK për 2 kritere. Sipas Urdhrit nr. 85 me nr. 142 prot., datë 06.06.2019 të Titullarit është pezulluar procedura e Prokurimit deri në trajtimin e ankesave të mësipërme. Sipas Urdhrit nr. 96 me nr. 143 prot., datë 06.06.2019 të Titullarit është krijuar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me përbërje T.Ç., Kryetar dhe D.L. dhe A.M., anëtare (KSHA). Sipas shkresës me nr. 171 prot., datë 08.06.2019 nga Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave është pranuar kërkesa e OE “*S...I*” ShPK dhe është refuzuar kërkesa e OE “*K...N*” ShPK me argumentin se kjo e fundit është jashtë afateve të përcaktuara në DST. Me shkresat me nr. 340 prot., datë 10.06.2019 dhe nr. 344 prot., datë 11.06.2019 u është kthyer përgjigje dy OE të mësipërm. Pas reflektimit të një pjesë të sugjerimeve të bëra nga APP dhe atyre të bëra nga OE “*S...I*” ShPK, për të cilin është mbajtur edhe procesverbali i datës 12.06.2019 për ndryshimin e ofertave sipas shtojcës përkatëse, afati kohor i dorëzimit të ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është shtyrë me datë 08.07.2019, ora 12:00.

**Në lidhje me veprimtarinë e KVO dhe KSHA**

Me datë 08.07.2019 është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga ku ka rezultuar se janë s’kualifikuar 13 nga 14 OE pjesëmarrës, konkretisht si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Refuzuar
1	L...A	-	Po
2	E...L	-	Po
3	K...8	180,439,832	Po
4	R...Y & B...B & B...3	189,320,675	Po
5	S...A	191,664,079	Po
6	S...I	193,944,554	Po
7	S...I	200,037,044	Po
8	2...T & C...A & N...I	205,401,179	Po
9	A...S & B...S	205,462,861	Po
10	A...X & E...T	217,631,397	Po
11	<b><u>E...N &amp; A...N &amp; A...O</u></b>	<b><u>232,570,443</u></b>	<b><u>Jo</u></b>
12	F...N	238,713,719	Po
13	4 ...M	242,001,700	Po
14	F...A	244,527,136	Po

Konstatohet se, midisi të tjerave, prej kriterit që lidhet me autorizimin e prodhuesit/distributorit i cili nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, nuk lidhet ngushtë me nevojat e investimit në fjalë, nuk shpreh qartësisht se për çfarë duhet ky autorizim (për furnizim, për tregtim me shumicë/pakicë, transportim etj.) dhe mbi të gjitha nuk përcakton nevojat konkrete se nga lind domosdoshmëria për një kriter të tillë, janë s’kualifikuar 7 nga 13 operatorët e s’kualifikuar në total, çka arrihet në konkluzionin se vendosja e këtij kriteri ka është diskriminuese ndaj ofertuesve.



KONTROLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Nga 13 OE të s'kualifikuar është bërë ankesë në lidhje me s'kualifikimin nga 3 OE, "K...A & C...8", "A...X & E...T" dhe "S...I". Sipas Urdhrit nr. 22 me nr. 230 prot., datë 02.08.2019 është krijuar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) me përbërje të komisionit T.Ç., Kryetar dhe D.L. dhe A.M., anëtare. Sipas akteve me nr. 233 prot. datë 07.08.2019, 234 prot. datë 08.09.2019 dhe 235 prot., datë 09.08.2019 janë miratuar nga ana e Titullarit shqyrtimet dhe konkluzionet në lidhje me ankesat e trajtuara nga ana e KSHA. Gjithashtu, me shkresat me nr. 477 prot., datë 07.08.2019/478 prot., datë 08.08.2019 dhe 479 prot., datë 09.08.2019 nga ana e Titullarit të AK janë njoftuar OE pjesëmarrës lidhur me mos marrjen në konsideratë (apo pjesërisht sipas rastit) të ankesave drejtuar AK.

Në lidhje me s'kualifikimin e OE "S...I" ShPK

Rezulton se OE "S...I" ShPK i cili ka bërë edhe ankesën, administruar në RSU nr. 1 Tiranë SHA me nr. 474 prot., datë 02.08.2019, është s'kualifikuar për shkak se:

*"1. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi punonjësit në lartësi pasi në kriterin e kualifikimit është kërkuar specialist të certifikuar për punime në lartësi 3 (tre) kategoria e I. Për punonjësit e sipërpërmendur nuk është paraqitur Certifikata e trajnimit;*

*2. Në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori, nuk plotëson kriterin mbi 2 (dy) specialistë termoteknikë. Operatori ekonomik ka paraqitur kontratë ku punonjësit janë të punësuar specialistë dhe certifikatë trajnimi. Specialistët e paraqitur janë me certifikatë trajnimi jo diplomë apo dëftesë si është kërkuar në DST dhe nuk kanë paraqitur librezat pune".*

Sipas KSHA, në lidhje me kriterin e parë që lidhet me punonjësit në lartësi, nuk janë pranuar si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri Dëshmitë e Sigurimit Teknik për punonjësit R. D, H. V dhe U. D dhe as kontratat përkatëse pasi këto dëshmi nuk tregojnë aftësinë teknike si specialist lartësie por tregojnë që këta punonjës janë të aftë për të punuar pranë impianteve elektrike. KSHA, në lidhje me kriterin e dytë që lidhet me specialistët termoteknikë, ka rrëzuar pjesërisht gjykimin e KVO duke pranuar si mangësi të OE "S...I" ShPK vetëm librezat e punës dhe certifikatat e punonjësve në lartësi.

**Gjykimi i grupit të auditimit**

Në lidhje me s'kualifikimin dhe mos marrjen në konsideratë të OE "S...I" ShPK rezulton se KSHA, në lidhje me kriterin e dytë që lidhet me specialistët termoteknikë, ka rrëzuar pjesërisht gjykimin e KVO duke **pranuar si mangësi të OE "S...I" ShPK:**

- 1. Certifikimin e punonjësve në lartësi;**
- 2. Librezat e punës;**

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit në lidhje me punonjësit në lartësi, referuar dokumentacionit të sjellë nga OE "S...I" ShPK rezulton se në SPE janë ngarkuar 3 dëshmi të lëshuara nga "T...E" ShPK, për Specialistë pune në lartësi si dhe kontratat përkatëse. Për sa i takon kriterit të parë që lidhet me certifikimin të punonjësve në lartësi rezulton se ankesa e OE "S...I" ShPK nuk është marrë në konsideratë nga KSHA pasi: *"Nga dokumentacioni i paraqitur rezultojnë vetëm Dëshmitë e Sigurimit Teknik për punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike apo në afërsi të tyre për të tre punonjësit që ka paraqitur Operatori dhe jo certifikatat e trajnimit për këta punonjës të cilat vërtetojnë aftësitë e kërkuara në DST. Dëshmitë e Sigurimit teknik nuk tregojnë aftësinë profesionale si specialist lartësie por që ky punonjës është i aftë për të punuar pranë impianteve elektrike".*

Në fakt, siç u shpjegua edhe më sipër për mangësitë në DST të hartuara nga NJP, kriteri i vendosur për dëshmi nga ISHTI ose institucione ekuivalente me të është i pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe nuk lidhet me nevojat e investimit pasi referuar VKM nr. 410, datë



KONTROLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, ky institucion përveçse është i ligjëruar në ushtrimin e inspektimeve në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre, e garantimit të sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion, si dhe nga pajisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtrimin e funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut, nuk ka kompetenca për të lëshuar dëshmi kualifikimi.

*E thënë ndryshe, në këtë rast është s’kualifikuar padrejtësisht një OE edhe pasi ka sjellë pikërisht atë dokument të cilit i është kërkuar në Kërkesat e Veçanta të DST të miratuara nga AK.*

Njëkohësisht, nga verifikimi në SPE i dokumentacionit të ngarkuar nga BOE “E...N & A...N & A...O” i kualifikuar, ky i fundit rezulton me po të njëjtat mangësi (dhe me mangësi të tjera të trajtuara më poshtë) të cilat nuk kanë përmbushur kriteret e vendosura nga NJP të miratuara nga Titullari i AK. Konkretisht për sa i përket kriterit në lidhje me dëshmitë e kualifikimit për punëtorët nga ISHTI ose institucione ekuivalente me të, rezulton se i gjithë stafi i punës i paraqitur nga bashkimit i operatorëve “E...N” ShPK “A...N” ShPK dhe “A...O” ShPK është certifikuar nga dy subjekte “H...T” ShPK dhe “T...E” ShPK, ku ky i fundit është i njëjti subjekt i cili ka certifikuar edhe punonjësit e OE “S...I” ShPK, i s’kualifikuar për shkak se dëshmitë janë dhënë nga një subjekt si “T...E” ShPK.

Referuar dokumentacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në faqen Web të kësaj Drejtorie <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> rezulton se këto subjekte janë të akredituara si organizma certifikimi personeli që certifikojnë personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/ IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli” dhe jo për punime ndërtimi. Referuar po këtyre dokumenteve, konkretisht anekseve të Certifikatës së Akreditimit, Fusha e Akreditimit citon si më poshtë:

*“Akreditohet si organizëm certifikimi personeli që certifikon personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me:*

- *Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike” miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës me Nr. 3403/1 Prot. datë 30.06.2003;*
- *Ligjin Nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar;*
- *Ligjin Nr. 13/2013 datë 14.02.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike.”*

Njëkohësisht referuar dokumentacionit të QKB rezulton se subjekti “H...T” ShPK me NIPT K9...4D ka si objekt të aktivitetit të tij “...Certifikim personeli sipas standardit EN ISO/IEC 17024, për sigurimin teknik në fushën elektrike” kurse subjekti “T...E” ShPK me NIPT L5...0F ka si objekt të aktivitetit të tij “Certifikim i personelit në profesionin elektrik, për nivelet, të ulet, të mesëm, të lartë”.

Pra, nga ana e KVO, KSHA dhe Titullarit të AK për të njëjtat mangësi janë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të vlerësimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Për sa i takon argumentit s’kualifikues që lidhet me mungesën e librezës së punës, referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 1, neni 53, pika 1,



KONTROLI I LARTË I SHITIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

pika 4 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar neni 26, pika 8, rezulton se KVO, KSHA dhe vetë Titullari i AK kanë vepruar në kundërshtim me sa më sipër pasi referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nisur nga fakti që në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pikat **a** dhe **b** përcaktohet se qëllimi i ligjit është rritja e eficiencës dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik si dhe mirë përdorimi i fondeve publike dhe ulja e shpenzimeve procedurale si dhe nisur nga fakti se mungesa e librezës së punës përbën devijim të vogël pasi kontrata e punës dhe listë pagesat përkatëse të kontributeve shoqërore e shëndetësore janë dokumente të mjaftueshme për të konfirmuar kapacitete të tilla, por aq më tepër kur edhe vetë BOE i kualifikuar nuk përmbush këtë kriter, arrihet në konkluzionin se të tre palët e përmendura në krye të këtij paragrafi nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore në lidhje me vlerësimin e duhur të OE “S...I” ShPK.

**Në këto kushte, nga ana e KVO, KSHA dhe Titullari i AK është kualifikuar një OE i cili nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit të përmendura më sipër si dhe është s’kualifikuar për të njëjtat mangësi dhe/apo devijime të vogla (dy librezat pune) një OE me vlerë të ofertës 38,625,889 lekë pa TVSh më pak.**

Në lidhje me s’kualifikimin e BOE “A...N& E...T”

Rezulton se BOE i mësipërm i cili ka bërë edhe ankesën e administruar në RSU nr. 1 Tiranë SHA me nr. 467 prot., datë 31.07.019, është s’kualifikuar për shkak se:

“1. Bashkimi i operatorëve nuk përmbush punën e ngjashme në raport me përqindjen e deklaruar;

2. Operatoret ekonomik nuk plotësojnë kriterin mbi 2 specialistë termoteknikë sipas kriterëve në DST.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret mbi autorizim prodhuesi/distributori me certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për pajisjet e pasqyruara në preventiv. Mungon autorizim prodhuesi/distributori për sistemin e akses kontrollit dhe autorizim prodhuesi/distributori për kaldajën është i pa përkthyer dhe i pa noterizuar;

4. Bashkimi i Operatoreve ekonomik ka përllogaritur gabim vlerën e TVSH mbi pajisjet e furnizuara;”

Sipas KSHA, në lidhje me kriterin e dytë që lidhet me specialistët termoteknikë, nuk janë pranuar si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri pasi nga ana e BOE janë paraqitur certifikata dhe trajnimi dhe jo dëftesa/diploma siç është përcaktuar në kriteret e kualifikimit.

#### **Gjykimi i grupit të auditimit**

S’kualifikimi i BOE “A...N& E...T” ShPK, sipas KVO dhe njëkohësisht konfirmimin nga KSHA, është bërë midis të tjerave pasi nuk është përmbushur kriteri mbi specialistët termoteknikë, pasi “...nga ana e BOE janë paraqitur certifikata trajnimi dhe jo dëftesa apo diploma siç është përcaktuar në kriteret e kualifikimit...”.

Në fakt, siç u përshkruar dhe më sipër rezulton se në mënyrë të përsëritur (njësojë si në rastin e s’kualifikimit të OE “S...A” ShPK), nga KVO dhe KSHA janë mbajtur qëndrime të ndryshme për një mangësi të njëjtë pasi edhe BOE i kualifikuar “E...N & A...N & A...O” ndodhet në të





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**njëjtat kushte dhe me të njëjtën mangësi pasi edhe nga ky BOE janë paraqitur certifikata dhe jo dëftesa apo diploma.**

Në lidhje me s'kualifikimin e OE "S...A" ShPK

Sipas KVO, ky OE është s'kualifikuar pasi:

1. *Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret mbi: autorizim prodhuesi /distributori me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit ose distributorit te autorizuar për pajisjet e pasqyruara ne preventiv për:*

- *autorizim prodhuesi/distributori për sistemin e akses kontrollit;*
- *autorizim prodhuesi /distributori për kaldajën*

2. *Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi specialistet termoteknik. Nuk ka paraqitur diplomat/dëftesat përkatëse dhe librezë e punës. z. K.LL dhe R.D janë të pajisur me certifikate si trajnimi termoteknik dhe nuk është paraqitur librezë pune për të dy punonjësit.*

**Gjykimi i grupit të auditimit**

Sipas DST dhe konkretisht Shtojcës mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar që:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori dhe certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit/distributorit të autorizuar, ose një vetë deklaram nga ofertuesi pjesëmarrës që prodhuesi është i certifikuar me ISO 9001:2015 i cili do të jetë objekt verifikimi nga AK, për pajisjet e pasqyruara në preventiv, për:*

- *Autorizim prodhuesi/distributori për sistemet e akses kontrollit;*
- *Autorizim prodhuesi/distributori për kaldaja.*

*Në rast se autorizimi do të merret nga prodhuesi, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me anë të një autorizimi/kontrate midis tyre dhe prodhuesit; Në rastin e marrjes së autorizimit nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me distributorin e autorizuar me anë të një autorizimi/kontratë midis tyre.*

Në zbatim të këtij kriteri të cituar në mënyrë të tillë, nga ana e OE "S...A" ShPK janë paraqitur në sistem dy deklaratat të cilat citojnë se:

*“... prodhuesi për sistemet e akses kontrollit është i certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015”*

*“... prodhuesi për Kaldaja është i certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015”*

Nga sa më sipër rezulton se OE "S...A" ShPK ka përmbushur kriterin në lidhje me sistemet e akses kontrollit dhe ato të kaldajës nëpërmjet deklaratës së kërkuar sipas DST – ve pasi midis dy mundësive opsionale për të sjellë **autorizime**, për të cilat do të duhej të vërtetonte lidhjen me anë të autorizimit/kontratës me prodhuesin/distributorit **apo deklaratat**, OE "S...A" ShPK nuk ka sjellë autorizime prodhuesi/distributori por deklaratat përkatëse. Për rastin e dorëzimit të deklaratës rezulton se NJP nuk ka specifikuar se cilat janë dokumentet dëshmuës për ta konsideruar kriterin të përmbushur por NJP është mjaftuar duke kërkuar një deklaratë nga OE pjesëmarrës. Në këtë mënyrë rezulton se ky OE ka përmbushur këtë kriter dhe si rrjedhojë është s'kualifikuar padrejtësisht.

Në lidhje me kriterin e dytë dhe konkretisht DST – ve është kërkuar që: *Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 2 (dy) specialistë termoteknikë. Për specialistet termoteknikë të paraqiten kontrata e punës dhe diplomat/dëftesat përkatëse, librezë e punës.*

Në zbatim të këtij kriteri të cituar në mënyrë të tillë, nga ana e OE janë paraqitur në sistem:

- Dy kontrata pune të lidhura mes "S...A" ShPK në cilësinë e punëdhënësit dhe R. D dhe K. Ll në cilësinë e punëmarrësit si specialist termoteknik;
- Dy Certifikata trajnimi të R. D dhe K. Ll;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Këto dokumente nuk janë miratuar nga ana e KVO me argumentin se nga NJP është kërkuar të paraqiten Diploma/dëftesa dhe jo certifikata si dhe se mungojnë librezat e punës.

Për sa i takon argumentit s'kualifikues që lidhet me mungesën e librezës së punës, referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1, neni 53, pika 1, pika 4 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, rezulton se KVO dhe vetë Titullari i AK kanë vepruar në kundërshtim me sa më sipër pasi referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nisur nga fakti që në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, pikat **a** dhe **b** përcaktohet se qëllimi i ligjit është rritja e efikasitetit dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik si dhe mirë përdorimi i fondeve publike dhe ulja e shpenzimeve procedurale si dhe **nisur nga fakti se mungesa e librezës së punës përbën devijim të vogël** pasi kontrata e punës dhe listë pagesat përkatëse të kontributeve shoqërore e shëndetësore janë dokumente të mjaftueshme për të konfirmuar kapacitete të tilla, por aq më tepër kur edhe vetë BOE i kualifikuar nuk përmbush këtë kriter, arrihet në konkluzionin se të KVO dhe Titullari i AK nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore në lidhje me vlerësimin e duhur të OE "S...A" ShPK.

Referuar vlerësimit të bërë nga KVO, sipas njoftimit të datës 08.07.2019 rezulton se BOE "E...N & A...N & A...O" është kualifikuar edhe pse dokumentacioni i ngarkuar në SPE është shoqëruar me po të njëjtat mangësi (dhe me mangësi të tjera të trajtuara më poshtë) të cilat nuk kanë përmbushur kriteret e vendosura nga NJP të miratuara nga Titullari i AK. Konkretisht për sa i përket kriterit në lidhje me specialistët termoteknikë, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe atij në SPE rezulton se nga ana e BOE të kualifikuar janë paraqitur si dëshmi për përmbushjen e kriterit të mësipërm dy certifikata, konkretisht për D. Ll dhe A. H. Pra në asnjë rast nuk janë paraqitur diplomat/dëftesat për termoteknikë. Gjithashtu, kontrata e lidhur me D. Ll rezulton se është e lidhur mes palëve (punëdhënësit "E...N" ShPK dhe punëmarrësit D. Ll) me përshkrim pune Inxhinier Civil dhe jo termoteknik. Për sa i përket listë pagesave rezulton se D. Ll është paguar si Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë kurse A. H. është paguar si "Specialist për tavane me gips", një profesion ky i cili bën pjesë në kategorinë **Suvatues** dhe pa lidhje me termoteknikën. Për sa i përket librezave të punës të paraqitura në sistem nga BOE i kualifikuar rezulton se këto dy dokumente janë fiktive pasi bien në kundërshtim me listë pagesat. Konkretisht, sipas librezave të punës këta punonjës janë A. H – Termoteknik dhe D. Ll – Inxhinier hidroteknik kurse në listë pagesa janë si më sipër shpjeguar. **Në këto kushte, KVO ka mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtën mangësi të OE "S...A" ShPK dhe BOE "E...N & A...N & A...O", diferenca midis të cilëve është në shumën 40,906,364 lekë pa TVSh.**

**Kështu KVO, KSHA dhe Titullari i AK kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtat mangësi mes atyre të OE "S...A" ShPK, BOE "A...N & E...T" ShPK dhe OE "S...I" ShPK dhe mangësive të BOE të vetëm të kualifikuar "E...N & A...N & A...O" kur në fakt, duhet të kishte anuluar procedurën.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Kriteri:** ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 2, germa a dhe c, neni 24, pika 1, germa ç, neni 46, pika 1, neni 53, pika 1, pika 3 dhe pika 4, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8 dhe neni 66 si dhe VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1.

**Ndikimi/efekti:** Kualifikimi i OE të cilët nuk kanë kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës në përputhje me parashikimet e saj, ulje e eficiencës, efikasitetit, mirë përdorimit të fondeve publike, ulje e konkurrencës si dhe trajtimi diskriminues dhe jo i barabartë për operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

**Shkaku:** Mos shqyrtimi me korrektësi dhe trajtim me dy standarde i dokumentacionit të paraqitur nga OE.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Rezenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA dhe komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave/ankesave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**h. Titulli i gjetjes:** Kryerje e punimeve pa kontratë punimesh dhe pa kontratë shërbimi për mbikëqyrjen e punimeve.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se punimet në godinat me nr. 11 – 12 kanë nisur pa prezencën e një mbikëqyrësi punimesh dhe pa kontratë të lidhur mes Autoritetit RSU nr. 1 Tiranë SHA. Gjithashtu, nga verifikimi u konstatua se punimet në proces rezultuan se ishin zëra punimesh të cilat ishin prokuruar sipas procedurës me objekt “Rikonstruksion i godinës 11-12”. Në momentin e kryerjes së verifikimit rezultuan në proces prokurimi dhe ende pa u lidhur kontrata përkatëse e zbatimit të punimeve dhe ajo e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve.

**Kriteri:** Ligjin Nr. 8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 7;

Ligjin nr. 107 datë 31.07.2014 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar Kreu I, pika 1 dhe pika 4 si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;

**Ndikimi/efekti:** Shkelje e rëndë e kuadrit ligjor në drejtim të zbatimit të punimeve të ndërtimit.

**Shkaku:** Mungesa e monitorimit dhe koordinimit efektiv të aktivitetit të stafit të RSU nr. 1 Tiranë SHA në lidhje me këtë praktikë nga drejtimi i Shoqërisë.

**Rëndësia:** E lartë.

**1. Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përllogaritjen dhe zbritjen e volumeve të punimeve të cilat janë kryer me punëtorët dhe specialistët e sektorëve nga kontrata e punimeve për zbatimin e kontratës.

**2. Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për personat e përfshirë për nisjen dhe vazhdimin e proceseve të punës në një kohë që këto procese



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

dhe volume punimesh ishin objekt i një procedure prokurimi, vlerësimi i të cilës rezultoi të ishte kryer në momentin e nisjes së punimeve të zbatimit.

**Afati:** Menjëherë.

**i. Titulli i gjetjes:** Kryerje e punimeve pa cilësi dhe pa respektuar afatet e nevojshme të proceseve të punës.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e bërë publike dhe në media në lidhje me cilësinë e punimeve në kontratën me objekt *“Riparim i pjesshëm i dhomave të akomodimit të studentëve të godinave 5, 20 – 21, 26 – 27, 28 – 29”* u krye një verifikim nga grupi i audituesve të KLSH, zbatimi i të cilës do të jetë përsëri objekt auditimi në auditimet e ardhshme. Nga verifikimi rezultoi se në godinat e përmendura më sipër dhe konkretisht në dhomat e konstatuara me probleme në lidhje me rënien e suvatimeve punimet e shtrimit të tavaneve të gipsit rezultojnë se janë realizuar pa fino pra të pa stukuara po të lyera direkt me bojë. Gjithashtu, rezultojnë se nuk janë analizuar drejtë shkaqet e rënies së suvatimeve pasi sipas të dhënave rezultojnë se tërmeti ka rënë në datën 21.09.2019, datë në të cilën nuk ka një procesverbal të konstatimit të problemeve në lidhje me rënien e suvatimeve në dhomat e përmendura.

**Kriteri:** Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*;

**Ndikimi/efekti:** Shkelje e rëndë e kuadrit ligjor në drejtim të zbatimit të punimeve të ndërtimit.

**Shkaku:** Mungesa e llogaridhënies për problematikën e sipërpërmendur.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përlllogaritjen dhe zbritjen e votimeve të punimeve të cilat janë kryer pa cilësinë dhe proceset e nevojshme të punës në lidhje me tavanet e gipsit, suvatimet dhe çdo zë tjetër të përfshirë në preventiv.

**Afati:** Menjëherë.

**h. Titulli i gjetjes:** Përshkrim jo i qartë i objektit të prokurimit.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në 2 raste konkretisht procedurat:

*“Lyerje e godinave me gëlqere”*, viti 2018, vlera 4,084,140 lekë pa TVSh;

*“Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”* viti 2019 vlera 20,040,052 lekë pa TVSh;

dokumentet e paraqitura në SPE nuk japin një përshkrim të plotë të punimeve të parashikuara në total në shumën **24,124,192 lekë pa TVSh** që do të kryhen pasi:

**Për kontratën “Lyerje e godinave me gëlqere”:**

- a. Planimetritë nuk janë për të gjitha godinat e përfshira në përshkrimin që ka emërtimi i preventivit. Konkretisht, në SPE janë ngarkuar planimetri vetëm për 6 godina nga 24 godina të parashikuara për tu ndërhyrë nëpërmjet investimeve me lyerje dhe gëlqere dhe suvatim;
- b. Preventivi nuk rezultojnë të jetë hartuar në bazë të kërkesave nga sektorët përkatëse dhe as nga planimetritë pasi ka mospërputhje mes numrit të dhomave sipas kërkesës së administratorëve dhe numrit të dhomave të pasqyruar në preventiv. Gjithashtu, për të gjithë preventivin nuk janë saktësuar apo specifikuar dhomat, hollit dhe korridoret të cilët janë parashikuar për t’iu nënshtruar ndërhyrjeve me lyerje me gëlqere apo me suvatim;



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e hartuesit të preventivit, anëtarëve të NJP dhe Titullarit të AK nuk janë marrë masat e duhura për saktësimin dhe konkretizimin e investimit të parashikuar nëpërmjet fondit të vënë në dispozicion prej **4,084,140 lekë pa TVSh**. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për argumentimin e volumeve rezulton se nuk është paraqitur asnjë kërkesë ana e administratorëve për sa i përket godinave me nr. 2, 4, 24 dhe 25 të cilit i korrespondon volumi prej 16,704 m<sup>2</sup> lyerje me gëlqere ose vlera prej **584,640 lekë pa TVSh**.

**Për kontratën “Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”:**

- a. Konstatohet se planimetritë e pasqyruara në DST nuk reflektojnë dhomat në të cilat parashikohet të bëhet ndërhyrja nëpërmjet prishjes së suvatimit, riparimit nëpërmjet suvatimit, suvatimit të soletës apo murit si dhe vendosja e linjave për punimet elektrike;
- b. Konstatohet se nuk përputhen volumet e punës mes atyre të parashikuara për prishje dhe suvatimeve të mureve dhe soletave. Konkretisht rezultojnë diferenca si më poshtë:

Për godinat nr. 20 – 21

4,500 m<sup>2</sup> prishje suvatimi – 8,916 m<sup>2</sup> suvatim. Si rrjedhojë kemi një diferencë prej 4,416 m<sup>2</sup>

Për godinat nr. 26 – 27

4,200 m<sup>2</sup> prishje suvatimi – 8,550 m<sup>2</sup> suvatim. Si rrjedhojë kemi një diferencë prej 4,350 m<sup>2</sup>

Për godinat nr. 28 – 29

5,000 m<sup>2</sup> prishje suvatimi – 9,032 m<sup>2</sup> suvatim. Si rrjedhojë kemi një diferencë prej 4,032 m<sup>2</sup>

Për godinën nr. 5

500 m<sup>2</sup> prishje suvatimi – 1,396 m<sup>2</sup> suvatim. Si rrjedhojë kemi një diferencë prej 896 m<sup>2</sup>

***Në total rezulton se 13,694 m<sup>2</sup> suvatime janë parashikuar të kryhen pa përfshirë njëkohësisht në preventiv volume pune për prishjen e suvatimit çka do të thotë se ose këto mure janë të pa suvatuara fare ose që janë parashikuar të kryen direkt mbi suva.***

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e hartuesve të preventivit ing. V.Ll., ing. D.L., Drejtori i Shërbimeve Studentore O.D., anëtarëve të NJP dhe Titullarit të AK nuk janë marrë masat e duhura për saktësimin apo konkretizimin e investimit të parashikuar nëpërmjet fondit të vënë në dispozicion prej **20,040,052 lekë pa TVSh**.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, paragrafi dh, neni 23 “Specifikimet teknike”; Ligjin 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 16 pika 2 dhe 3; Urdhrin nr. 33 datë 11.07.2013 të Ministrisë së Financave, “Për gjurmët standarde të Auditimit për Prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Ndikimi/efekti:** Zhvillimi i procedurave në mungesë të transparencës për shkak të mungesës së gjurmëve standarde të auditimit.

**Shkaku:** Mos dokumentimi i zbatimit të punimeve.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për dokumentimin e të gjitha nevojave për prokurim punimesh/mallrash/shërbimesh me qëllim krijimin e gjurmës standarde të auditimit dhe vendosjen e transparencës përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**i. Titulli i gjetjes:** Mangësi në dokumentacion.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në punimet me objekt “**Lyerje e godinave me gëlqere**” janë kryer nga OE “F...A” ShPK me të cilin është lidhur kontrata përkatëse me vlerë **2,387,318 lekë me TVSh**. Për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

kontrata e shërbimit me vlerë 88,560 lekë me TVSh dhe për kolaudimin e punimeve është lidhur kontrata e shërbimit me vlerë 14,000 lekë me TVSh.

- a. Konstatohet se volumet e punimeve të pasqyruara në librezën e masave nuk përcaktojnë dhomat në të cilat janë realizuar 108,024 m<sup>2</sup> lyerje me gëlqere por vetëm numrin e dhomave për çdo godinë.
- b. Konstatohet se ana e mbikëqyrësit të punimeve është firmosur *Akti i dorëzimit të sheshit* i datës 21.09.2018, *Proces-verbali i fillimit të punimeve* i datës 21.09.2018, *Njoftimi për fillimin e punimeve* i datës 21.09.2018 si dhe *Ditari i punimeve* i datave 21.09.2018 – 23.09.2018, në një kohë kur kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes është lidhur me datë 24.09.2018. Sipas njoftimeve përkatëse punimet kanë përfunduar me datë 17.10.2018. Nga sa më sipër rezulton se dokumentacioni i mësipërm është plotësuar formalisht pasi aktet nuk i përmbahen kronologjisë së veprimeve të kryera;

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit arrihet në konkluzionin se nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, NJP, sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve si dhe grupit të marrjes në dorëzim nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik dhe ligjor për sa i takon shumës prej **2,489,878 lekë me TVSh** nga të cilat shuma 2,387,318 lekë me TVSh të paguar kontraktorit të punimeve, shumës prej 88,560 lekë me TVSh të paguar mbikëqyrësit të punimeve dhe shumës prej 14,000 lekë me TVSh të paguar kolaudatorit të punimeve.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, paragrafi dh, neni 23 “Specifikimet teknike”; Ligjin 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 16 pika 2 dhe 3, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar”, Urdhrin nr. 33 datë 11.07.2013 të Ministrisë së Financave, “Për gjurmët standarde të Auditimit për Prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Ndikimi/efekti:** Zhvillimi i procedurave në mungesë të transparencës për shkak të mungesës së gjurmëve standarde të auditimit.

**Shkaku:** Mungesa e gjurmëve të auditimit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për dokumentimin e të gjitha praktikave për zbatimin e kontratave për punime/mallra/shërbime me qëllim krijimin e gjurmës standarde të auditimit dhe vendosjen e transparencës përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**j. Titulli i gjetjes:** Mangësi në specifikimet teknike.

**Situata:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje detergjente dhe materiale pastrimi”, specifikimet teknike të produkteve të kërkuara nga njësia e prokurimit janë të pabazuara në standardet kombëtare, të paqarta, të paverifikueshme dhe diskriminuese.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën a, neni 23 të, Standardet kombëtare për kimikatet dhe detergjentet të përcaktuara në ligjin nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr. 488, datë 29.06.2016, “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, VKM nr. 669, datë 28.9.2011, “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve të detergjenteve”.

**Ndikimi/efekti:** Specifikimet teknike sjellin konfuzion, janë diskriminuese dhe nuk janë të verifikueshme nga KVO.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Shkaku:** Mos njohje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që ngarkohen me realizimin e procedurave të prokurimit.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**k. Titulli i gjetjes:** Marrja në dorëzim e mallrave pa u kolauduar dhe verifikuar për specifikimet teknike të kërkuara.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në procedurën me objekt “*Blerje detergjente dhe materiale pastrimi*” marrja në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me urdhrin nr. 1 datë 15.01.2019, ka mbajtur akt kolaudimit të mallrave të sjella nga OE “*M...D*” ShPK me faturën nr. 623, datë 27.01.2019. Komisioni gjatë kolaudit pasi kreu provat në lavanderinë kryesore, në Rezidencën nr. 17 dhe Rezidencën nr. 20 deklaroi se materialet janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

-Për zërin acid me sasi 1500 litra me **vlërë 82,500 lekë pa TVSh** nuk u verifikua se “*Përbërësit organike të halogjenuar (mg/kg) si :Plumb, hekuri, kadmiumi, kromi, nikeli, zhiva, arseniku etj ishin në total maximum deri në 17%*”

-Për zërin pluhur larës për rroba cilësi e parë, me sasi 3000 kg, me **vlërë 240,000 lekë pa TVSh**, nuk u verifikua se kërkesat cilësore të pluhurit larës për rroba ishin si:

1. Përmbajtja e lagështisë jo më shumë se 10 %.
2. Përmbajtja e joneve hidrogjen PH 9 – 11.
3. Aftësia shkumëzuese, vëllimi i shkumës kundrejt vëllimit të tretësirës së marrë për analizë 1–2
4. Tretshmëria në ujë jo më pak se 95 %.
5. Përmbajtja e perboratit të natriumit 6 – 8%.
6. Përmbajtja e karbonatit të natriumit 25 – 30%.
7. Era parfum 10-15%

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 45.

**Ndikimi/efekti:** Vlera 322,500 lekë pa TVSh ose 387,000 lekë me TVSh përbën efekt ekonomik negativ për shoqërinë.

**Shkaku:** Mos kryerja nga komisioni i marrjes në dorëzim të kontroleve në cilësi dhe llojshmëri të mallrave për specifikimet teknike të kërkuara në DST.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për të ushtruar verifikimet përkatëse që komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, i kryejnë detyrat e ngarkuara me përgjegjshmëri dhe në përputhje të specifikimeve teknike të kërkuara në DST e procedurës së prokuruar.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**l. Titulli i gjetjes:** Hartimi i kriterëve për kualifikim nga njësia e prokurimit konfuze dhe jo në përshtatje me normativat ligjore që duhet të kenë OE pjesëmarrës.

**Situata:** Në specifikimet teknike të DST nga NJP është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin licencë për tregtimin e karburanteve pa specifikuar objektin e saj. Në fakt, në rastin konkret do duhet të ishte kërkuar licencë për shitje me pakicë të lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, siç edhe është rasti i objektit të prokurimit.

**Kriteri:** Nenin 46 të LPP, kualifikimi i ofertuesve, pikën 2 të nenit 57, VKM nr. 970, datë 02.12.2015, i ndryshuar “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*”, pikat I dhe II.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Ndikimi/efekti:** Ulje e eficiencës, efikasitetit, mirë përdorimit të fondeve publike, ulje e konkurrencës si dhe krijimi i konfuzionit mes OE.

**Shkaku:** Vendosija e kritereve diskriminuese, të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht dhe mos njohje e bazës ligjore për prokurimet.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që ngarkohen me realizimin e procedurave të prokurimit.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**II. Titulli i gjetjes:** Kualifikimi i OE me mangësi në dokumentacion.

**Situata:** Lidhur me kërkesën e AK për kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, pika d. “OE ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.”, u konstatua se KVO:

-Ka pranuar si të vlefshme vërtetimin e marrë nga OE më datë 03.03.2017, nga Drejtoria e Tatim-Taksave për detyrime të shlyera deri më datën 02.03.2017, që i përkasin muajit janar 2017. Duke u nisur se data e hapjes së ofertave ishte 25.04.2017, detyrimet e maturuara të subjektit deri më 02.03.2017 janë dhe ato të muajit janar, si dhe nga vërtetimi i marrë nuk është e mundur të kuptohet nëse janë paguar detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe muajin shkurt 2017 pasi afati i tyre për pagesë është deri më datën 20 mars;

- Lidhur me kërkesën e AK për kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën ç, ku është kërkuar “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”, OE “A...T” SHA, nuk ka sjellë vërtetim që të konfirmojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuar të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë për vendet e tjera ku ushtron aktivitetin.

- Në kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3, për aftësitë teknike e profesionale, është kërkuar që OE ofertues të sjellin certifikatën e cilësisë së karburantit.

Lidhur me këtë kriter nga OE fitues është sjellë një raport analize për një sasi 50,000 litra e marrë në një rezervuar në Vorë, Muçaj, Rruga Nacionale Fushë-Krujë., duke mos e përcaktuar saktë se cilat parametra, nga cili autoritet lëshohet certifikata e cilësisë, raport analiza e sjellë nga OE është e pavlefshme për këtë kriter.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3, është kërkuar që pika e furnizimit duhet të jetë në një largësi jo më shumë se 5 km larg godinës së Institucionit.

Në dokumentacionin e paraqitur në ofertat e OE, A...T me administrator z. F.G., ka paraqitur një kontratë qiraje me shoqërinë 2...L, me administrator të njëjtin person sa më sipër, për marrjen me qira të një pike karburanti që ndodhet në rrugën “Shemsi Haka”, Ali Demi, Tiranë.

Kontrata e Bashkëpunimit Nr. 2286 Rep. Nr. 496 Kol. e datës 07.07.2016, me Shoqërinë “2...L” SHPK, me objekt: “1.1 Objekti i kontratës së qirasë është dhënia me qira nga qiradhënësi e një pike karburanti me të gjitha anekset e saj, si dhe truallin në të cilin është ndërtuar dhe shërben për funksionimin e pikës. 1.2 Qëllimi i përdorimit do të jetë shfrytëzimi në dobi të qiramarrësit të objektit të kontratës për ushtrimin e aktivitetit të tij në tregtimin me pakice të naftës dhe nënprodukteve të saj.”

Nga verifikimi i Ekstraktit Historik të QKB, dorëzuar nga OE, nuk rezultoi që aktiviteti të ushtrohej në pikën e marrë me qira, pra **jemi në rastin e evazionit fiskal që shoqëria A...T SHA, ka ushtruar aktivitet në këtë pikë për tregtimin me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, dhe nuk ka kryer njoftimet e duhura në QKB dhe në organet tatimore.**





KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Të gjitha procedurat që parashikon udhëzimi sa më sipër nuk janë kryer nga OE A...T SHA , pasi nuk ka kryer deklarimet e nevojshme në QKB se ka ushtruar aktivitet në pikën që ndodhet në rrugën “Shemsi Haka”, Ali Demi, Tiranë.

Gjithashtu, në kërkesat për kualifikim parashikohet se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri për kualifikim, rasti i mosdorëzimit të një dokumenti, **ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.**

**Kriteri:** VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenin 14, Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët, pika 5, Udhëzimi Nr. 16, datë 3.5.2010, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, Neni 53, pika 3 e LPP, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, Neni 62, Certifikatat e regjistrimit fillestar, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 43.

**Ndikimi/efekti:** Kualifikimi i OE me deklarime të rreme për përmbushjen e aftësive fizike dhe zotërimin e licencave profesionale, në kundërshtim me LPP si dhe favorizimin e një OE për kryerjen e evazionit fiskal.

**Shkaku:** Mos njohje e mirë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 SHA duhet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që ngarkohen me realizimin e procedurave të prokurimit.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**m. Titulli i gjetjes:** Përfshirja e kostos së shërbimit të shënjimit në çmimin e produktit, gazoil.

**Situata:**-Lidhur me zbatimin e kontratës në skemën e llogaritjes së kostos së produktit, OE ka përfshirë dhe taksën e markimit me vlerë pa TVSh 0.61 lekë. Rezulton se përfshirja e kësaj tarife në koston për litër ka bërë që Operatorit Ekonomik “A...T” SHA, të përfitojë padrejtësisht 0.79 lekë/litër me tepër (0.61 + 7.7 % fitim + 20% TVSh), ose shumë prej 4,734 lekë me TVSh për 6000 litra naftë të faturuar për periudhën objekt auditimi. Shuma e mësipërme duhet të zhdëmtohet nga OE dhe për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi personat që kanë pranuar faturat tatimore.

-Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 106 prot, datë 17.05.2017, me afat deri më 31.12.2017, të lidhur midis RSU nr. 1 Tiranë SHA dhe shoqërisë “A...T” SHA, me objekt “Blerje karburanti për nevojat e RSU 1” , u konstatua shkelje kontraktuale në afatin e lëvrimit të mallit.

-Në lidhje me tollonat e karburantit, OE e ka lëvruar me datë 15.01.2018, me faturën tatimore nr. 412, me vlerë 244,905 lekë, duke e tejkualuar afatin me 15 ditë dhe me faturën tatimore nr.722 datë 03.04.2018, me vlerë 372,170 lekë rezulton se është tejkualuar afati me 108 ditë. Në nenin 23 të kontratës të lidhur mes palëve, Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar, përcaktohet llogaritja e penaltetit në masën 2/1000 e vlerës së mbetur, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës, duke maturuar në total një penaltitet në vlerën 70,200 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimit Nr. 26, datë 04.09.2008, Për taksat kombëtare, i ndryshuar, pika 1.1 si dhe VKM Nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, i ndryshuar, pika 1.3, “Çmimi i shërbimit të shënjimit”, 1.10 “Subjektet e detyruara” dhe pika 4.1, germa b.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Në nenin 23 të kontratës të lidhur mes palëve, Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar, përcaktohet llogaritja e penaltetit në masën 2/1000 e vlerës së mbetur, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës.

**Ndikimi/efekti:** Përfshirja e tarifë së shënjitimit në koston për litër ka bërë që Operatorit Ekonomik “A...T” SHA të përfitojë padrejtësisht 0.79 lekë/litër me tepër (0.61 + 7.7 % fitim + 20% TVSh), ose **shumën prej 4,734 lekë me TVSh** për 6000 litra naftë të faturuar për periudhën objekt auditimi. Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar ka **maturuar në total një penaltitet në vlerën 70,200 lekë.**

**Shkaku:** Mos njohje e mirë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zhdëmtimin e vlerave të mësipërme nga OE “A...T” SHA.

**Afati:** Menjëherë.

**n. Titulli i gjetjes:** Hartimi i kriterëve për kualifikim nga njësia e prokurimit konfuze dhe jo në përshtatje me normativat ligjore që duhet të kenë OE pjesëmarrës.

**Situata:** Në specifikimet teknike të DST, nga NJP është kërkuar që xhiro vjetore e tre viteve të fundit 2013,2014,2015 të ketë një vlerë sa ajo e fondit limit. Ky specifikim është i pasaktë pasi tre vitet e fundit janë 2014,2015 dhe 2016. Në specifikimet teknike të DST, nga komisioni është kërkuar që OE fitues duhet të paraqesë certifikatën e cilësisë së karburantit që kërkohet. Kjo kërkesë është e pasaktë dhe konfuze pasi nuk përcakton llojin e certifikatës, autoritetin që e lëshon, vlefshmërinë, afatin. Në specifikimet teknike të DST, nga NJP është kërkuar që OE fitues duhet të paraqesë licencë të subjektit për tregtimin e karburanteve.

**Kriteri:** Sa më sipër, AK ka hartuar kriterë për kualifikim, të cilat bien në kundërshtim me: Nenin 46 të LPP, kualifikimi i ofertuesve, pikën 2 të nenit 57 të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, pikat I dhe II, ku përcaktohen licencat për shitje me shumicë dhe shitje me pakicë të lëndëve djegëse nga konsumatorët fundorë.

**Ndikimi/efekti:** Specifikimet teknike sjellin konfuzion, janë diskriminuese dhe nuk janë të verifikueshme nga KVO.

**Shkaku:** Mos njohje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që ngarkohen me realizimin e procedurave të prokurimit.

**Afati:** Menjëherë dhe në vazhdimësi.

**o. Titulli i gjetjes:** Kualifikimi i OE me mangësi në dokumentacion.

**Situata:** Nga shqyrtimi i materialeve të vëna në dispozicion rezultoi se në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti për nevojat e RSU nr. 1 për vitin 2018”:

KVO ka pranuar si të vlefshme për përmbushjen e kriterit që “OE ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.” vërtetimin e marrë nga OE më datë 15.05.2018, nga Drejtoria e Tatim Taksave për detyrime të shlyera deri më datën 14.05.2018, që i përkasin muajit prill 2018. Duke u nisur se data e hapjes së ofertave ishte 30.07.2018, detyrimet e maturuara të subjektit deri më 02.07.2018 janë dhe ato të muajit maj dhe qershor, si dhe nga vërtetimi i marrë nuk është e mundur të kuptohet nëse janë paguar detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe muajin prill 2018 pasi afati i tyre për pagesë është deri më datën 20 maj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

-Lidhur me kërkesën e AK për kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën ç, ka kërkuar “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”, OE “A...T” SHA, nuk ka sjellë vërtetim për të gjitha pikat ku ushtron aktivitetin sipas NIPT – eve sekondare që ka në ekstraktin e QKB. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3, për aftësitë teknike e profesionale, është kërkuar që OE ofertues të sjellin certifikatën e cilësisë së karburantit. Lidhur me këtë kriter nga OE fitues është sjellë një raport analize për një sasi 50,000 litra e marrë në një rezervuar në Vorë, Muçaj, Rruga Nacionale Fushë-Krujë. Duke mos e përcaktuar saktë se cilat parametra, nga cili autoritet lëshohet certifikata e cilësisë, raport analiza e sjellë nga OE është e pavlefshme për këtë kriter.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3, është kërkuar që pika e furnizimit duhet të jetë në një largësi jo më shumë se 5 km larg godinës së Institucionit. Në dokumentacionin e paraqitur në ofertat e OE, A...T me administrator z. F.G., ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi me shoqërinë 2...L, me administrator të njëjtin person sa më sipër, për furnizimin e sasisë së kërkuar të karburantit në pikat e kësaj shoqërie.

-Në dokumentet e dorëzuara nga Operatori Ekonomik fitues, për të përmbushur kriterin e mësipërm, është paraqitur Kontrata e Bashkëpunimit nr. 4480 Rep. Nr.855 Kol. e datës 05.12.2017, me Shoqërinë “2...L” SHPK. Pavarësisht se titulli i kontratës është “Kontratë bashkëpunimi.”, nisur nga leximi i neneve të kësaj kontrate dhe termave të përdorur, rezulton që kjo kontratë është një kontratë shitblerje. Qëllimi i kësaj kontrate është që, duke qenë se “A...T” SHA nuk ka një stacion shitje me pakicë në Tiranë, ndërsa “2...L” SHPK, disponon stacion tregtimi me pakicë në Tiranë, kjo e fundit të marrë përsipër të pranojë dhe të kthejë në lëng tollonat/kartat elektronike O...W të shitura nga shoqëria “A...T” SHA palëve të treta të kontraktuara prej tij. PAGESA për karburantin, sipas nenit 5 do të bëhet në llogarinë bankare të shoqërisë “2...L” SHPK SHA. Pra, palët me të cilat shoqëria “A...T” SHA, në bazë të kontratës marrin nga kjo shoqëri tollonat/karta, por jo karburantin, sepse de facto palët e treta të kontraktuara marrin karburantin që tregton shoqëria “2...L” SHPK. Kontrata e Bashkëpunimit Nr.4480 Rep. Nr.855 Kol. e datës 05.12.2017 e Shoqërisë “A...T” SHA me Shoqërinë 2...L SHPK, de facto është një kontratë nën kontraktimi, sepse objekti i kontratës përmbushet nga “2...L” SHPK, dhe theksojmë se në dokumentet e tenderit nën kontraktimi nuk lejohet. Nëse, Kontrata e Bashkëpunimit nr. 4480 Rep. Nr.855Kol. e datës 05.12.2017 e Shoqërisë “A...T” SHA me Shoqërinë “2...L” SHPK, do të interpretohej si një kontratë bashkimi të operatorëve ekonomik duhet që në këtë rast të ishin respektuar rregullat e prokurimit publik. Në dokumentet e dorëzuara nga ky Operator Ekonomik, në sistemin elektronik, ka një listë stacionesh me emërtimin “Adresat e pikave O...W në Shqipëri”, listë e cila nuk është e konfirmuar me firmë dhe me vulë nga subjekti.

*-Në deklaratën e OE, përfaqësuar nga z. F.D., mbi specifikimet teknike, deklarohet se subjekti i përmbush të gjitha specifikimet dhe e vërteton këtë me certifikata e dokumente të dorëzuara, deklaratë kjo jo e vërtetë dhe e përdorur për qëllim kualifikimi.*

*Operatori ekonomik “A...T” SHA, me lidhjen e kontratës me subjektin “2...L” SHPK, ka shmangur qëllimin e procesit të tenderimit pasi produkti final merret nga një OE i cili nuk i është nënshtruar procedurave të prokurimit.*

**Komisioni i vlerësimit të ofertave jo vetëm nuk duhet ta kualifikonte si fitues, por të kërkonte në Agjencinë e Prokurimit Publik për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike.**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

**Kriteri:** VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenin 14, Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët, pika 5, neni nr. 46, të ligjit të LPP, kërkohet për kualifikimin që OE të zotërojë licencat profesionale, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe aftësitë teknike duke pasur pajisjet dhe asetet fizike për veprimtaritë e kërkuara për të cilat do të lidhet kontrata, neni 13, pika 3/a të LPP-së, neni 53, pika 3 i LPP.

**Ndikimi/efekti:** Kualifikimi i OE me deklarime të rreme për përmbushjen e aftësive fizike dhe zotërimin e licencave profesionale, në kundërshtim me LPP si dhe favorizimin e një OE për kryerjen e evazionit fiskal.

**Shkaku:** Mos njohje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që ngarkohen me realizimin e procedurave të prokurimit.

**Afati:** Në vazhdimësi.

**p. Titulli i gjetjes:** Përfshirja e kostos së shërbimit të shënjimit në çmimin e produktit, gazoil.

**Situata:**-Lidhur me zbatimin e kontratës në skemën e llogaritjes së kostos së produktit, OE ka përfshirë dhe taksën e markimit me vlerë pa TVSh 0.61 lekë.

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës me nr. 268 prot, datë 28.08.2017, me afat deri më 30.06.2019, të lidhur midis RSU nr. 1 dhe shoqërisë “A...T” SHA, me objekt “Blerje karburanti për nevojat e RSU 1”, u konstatua shkelje kontraktuale në afatin e lëvrimit të mallit.

Në lidhje me tollonat e karburantit, OE e ka lëvruar me datë 12.07.201, me faturën tatimore nr. 275, me vlerë 202,759 lekë, duke e tejkaluar afatin me 12 ditë.

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, pika 1.1 si dhe VKM Nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, i ndryshuar, pika 1.3, “Çmimi i shërbimit të shënjimit”, 1.10 “Subjektet e detyruara” dhe pika 4.1, germa b.

Në nenin 23 të kontratës të lidhur mes palëve, Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar, përcaktohet llogaritja e penaltetit në masën 2/1000 e vlerës së mbetur, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës.

**Ndikimi/efekti:** Rezulton se përfshirja e tarifë së shënjimit në koston për litër ka bërë që Operatorit Ekonomik “A...T” SHA të përfitojë padrejtësisht 0.79 lekë/litër me tepër (0.61 + 7.8 % fitim + 20% TVSh), ose shumë prej 4740 lekë me TVSh për 6000 litra naftë të faturuar për periudhën objekt auditimi. Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar ka maturuar në total një penaltitet në vlerën 7,800 lekë.

**Shkaku:** Mos njohje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimet publike.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** RSU nr. 1 Tiranë SHA duhet të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zhdëmtimin e vlerave të mësipërme nga OE “A...T” SHA.

**Afati:** Menjëherë.

*Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me Projekt Raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.*



## 8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka një aktivitet të menaxhimit financiar në një ambient me risk për sa i përket ruajtjes dhe administrimit të pronave, truall dhe ndërtesa. Qyteti Studenti është një ambient i cili ka pasur në vijimësi pas tranzicionit, ndërtime pa leje, që janë në proces legalizimi. Kontrolli dhe zbatimi i ligjshmërisë së administrimit të pronës truall, pa përgjegjës material konkret, ul ndjeshëm informimin në kohë reale për përdorimin e truallit nga subjekte tregtare. Administrimi i ndërtesave në funksion të studentëve kushtëzohet nga përdorimi në vijimësi i disa godinave nga familjarë me probleme sociale. Nëpunësi Autorizues i shoqërisë është Drejtori i Përgjithshëm i cili kryen funksionin e Administratorit, ndërsa Nëpunësi Zbatues i shoqërisë është Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Financiar. Të dy këto funksione ushtrohen nga persona të pa emëruar për kryerjen e detyrave që ata mbajnë.

Administratorit ju dërgua një pyetësor për të vlerësuar nivelin e zbatimit të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit, dhe në përputhje me përgjigjet e Administratorit dhe vlerësimin nga grupi i auditimit mbi zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

### a. Titulli i Gjetjes: RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka bërë emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Njësisë.

**Situata:** Shoqëria në bazë të Vendimit nr. 1 të KM datë 17.11.2016 dhe Protokoll nr. 992 ka bërë emërimin e Znj. A.SH., si Drejtor të Përgjithshëm (*Administrator*). Me vendim të Administratorit të shoqërisë, me Vendim nr. 64, datë 09.04.2015, dhe Protokoll nr. 200, është emëruar Z. Sh.Sh., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Financiar, me arsim të lartë, ekonomist. Mbi këto emërimet janë ekzekutuar të drejtat e Nëpunësit Autorizues dhe të Nëpunësit Zbatues.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni (4) Përkufizime, pika (23). Nëpunësi Zbatues është po sipas ligjit nr. 10296, sipërcituar, neni (4) Përkufizime, pika (24). Ligji nr. 10296, sipërcituar, neni (8) Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit, pika (2).

**Ndikimi/Efekt:** Nëpunësi Autorizues, Znj. A.SH., ka kryer e pacaktuar këtë detyrë. Z. Sh.Sh. ka ushtruar detyrën e Nëpunësit Zbatues i pacaktuar në këtë detyrë.

**Shkaku:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, nuk janë informuar juridikisht për mënyrën e zgjedhjes dhe ushtrimit të kompetencave ligjore.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** AP të marrë për caktimin e Nëpunësit Autorizues. Nëpunësi Autorizues i caktuar të zgjedh Nëpunësin Zbatues.

**Afati:** Menjëherë

### b. Titulli i Gjetjes: Shoqëria nuk ka bërë përmirësime në mjedisin e kontrollit.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka përmirësuar mjedisin e kontrollit sepse: nuk ka marrë masa për krijimin e Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), nuk ka objektivë të planifikuara, të matshme dhe të arritshme, nuk ka një rregullore të përditësuar, Organi grama e funksionimit, e miratuar nga një organ në kundërshtim me ligjin, nuk krijon një mjedis të kuptueshëm kontrolli, ku Njësia e Auditit të Brendshëm është hallkë varësie nga Administratori (Drejtori i Përgjithshëm). Nuk ka një praktikë të shkruar për delegimin e kompetencave, rregullore apo vendim të Administratorit mbi delegimin e kompetencave.

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), të ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, nenin 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**Ndikimi/Efekti:** Shoqëria nuk ka bërë përmirësime në mjedisin e kontrollit, nuk ka ngritur GMS, nuk ka objektiva të matshëm kontrolli, nuk ka procedura deleguese të qarta të detyrave, si rrjedhojë nuk janë përmbushur detyrimet ligjore të MFK.

**Shkaku:** Nëpunësi Autorizues nuk ka ushtruar kompetencat e plota në fushën e MFK.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Nëpunësi Autorizues në funksion të marrë masa për përmirësimin e mjedisit të kontrollit në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, planifikimin e objektivave të matshme dhe të arritshme në fushën e menaxhimit financiar, për të pasur një bilanc pozitiv financiar, hartimin e një rregullore të përditësuar, dhe organi gramë në përputhje me detyrat e kompetencat e rregullores së përditësuar, të marrë masa për hartimin e një dokumenti për delegimin e kompetencave, me afate dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë.

**Afati:** Brenda datës 30.03.2020

**c. Titulli i Gjetjes:** Shoqëria ka probleme në menaxhimin e riskut.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, “Deklaratën e cilësisë” dhe Raporti përkatës “Për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë”, për vitet 2017, 2018, 2019. Shoqëria nuk ka dorëzuar “Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2017, 2018 dhe 2019” në Ministrinë e linjës. Nuk ka një regjistër risku dhe strategji risku. Nuk ka në funksion koordinatorin e riskut. Nuk ka krijuar njësinë anti-korrupsion.

**Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), të ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, nenin 18 “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, pika 1 dhe pika 3, Ligji nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, neni 10 Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse, pika (1), (2) dhe (3), përcakton ndihmesën që japin sinjalizueset në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

**Ndikimi/Efekti:** RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka menaxhuar riskun e shoqërisë sipas MFK.

**Shkaku:** Nëpunësi Autorizues në funksion s’ka ushtruar kompetencat e plota në fushën e MFK.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Nëpunësi Autorizues në funksion të marrë masa për menaxhimin e riskut në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Organet drejtuese të analizojnë dhe marrin masa për rastet e refuzimit të kryerjes së detyrës për personat e caktuar sipas MFK. Nëpunësi Autorizues në funksion të marrë masa për të hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: “Deklaratën e cilësisë”, “Për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë”, “Pyetësorin e Vetëvlerësimit të shoqërisë për vitin 2020”. Nëpunësi Autorizues në funksion të marrë masa për të hartuar dhe administruar regjistrin e riskut si edhe të hartojë një strategji për uljen e riskut. Të ushtror ose delegoj kompetencat e koordinatorit të riskut. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për caktimin e njësisë anti korrupsion në përputhje me aktet normative në fuqi.

**Afati:** Brenda datës 29.02.2020

**d. Titulli i Gjetjes:** Shoqëria ka probleme në Aktivitetet e Kontrollit, Informacionin dhe Komunikimin, si edhe Monitorimin.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka një gjurmë auditi për proceset bazë të shoqërisë. Në tre vitet e fundit shoqëria ka një bilanc negativ financiar, që tregon se ka ushtruar një aktivitet në pamundësi pagese. Nuk ka dokumentacion që informon Nëpunësin Autorizues për pamundësi pagesash. Nuk ka një hartë procesesh për ndjekjen e dokumentacionit dhe afatet e përgjigjeve,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

ndaj dokumenteve të deleguara për zbatim. Nuk ka masa të shkruara për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit me natyrë delikate, si prokurimet, ndjekja e kontratave, ruajtja e aktiveve afatgjata së bashku me inventarizimin e tyre. Aktivitetet e shoqërisë janë të pa mbrojtura, ku evidentohen kontrata që nisin para afatit të nënshkrimit, subjekte që operojnë pa kontrata qiramarrje. Nuk ka një procedurë të shkruar mbi rrjedhën dokumentare në RSU nr. 1 Tiranë SHA.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), të ndryshuar neni 4 “Përkufizime”, pika 19, ku cilësohet gjurma e auditit; Neni 12, pika 3 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”; Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, pika 2 dhe pika 3;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), të ndryshuar neni 4 “Përkufizime”, pika 23 Informacioni dhe komunikimi.

**Ndikimi/Efekti:** RSU nr. 1 Tiranë SHA në kushtet e mos mbajtjes së evidencave mbi gjurmën e auditimit, mungesës së një hartë procesesh për ndjekjen e dokumentacionit dhe përgjegjësitë e personave që administrojnë aktivitetet, nuk lejon monitorim të saktë në kohë të kontratave të qiradhënies.

**Shkaku:** Mungesa e përmbushjeve të detyrimeve ligjore nga Nëpunësi Autorizues në detyrë dhe Nëpunësi Zbatues në detyrë, sipas MFK.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për mbajtjen e gjurmës së Auditimit, dhe Nëpunësi Autorizues të marrë masa për arkivimin e gjurmës audituese. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për pakësimin e nivelit të riskut mbi aktivitetet, ruajtjen dhe mirë administrimin e tyre, si edhe kronologjinë e mbajtjes së përgjegjësive dokumentare, në lidhje me aktivitetet e shoqërisë.

**Afati:** Menjëherë

Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është dërguar observacioni Projekt-Raportit, i administruar në RSU nr. 1 me nr. 1185 prot., datë 19.12.2019 dhe në KLSH me protokoll nr. 598/4, datë 19.12.2019, nga ana e të cilëve pretendohet se:

*Gjurma e auditit për proceset me risk, aktivitetet, humbjet nga ana e Nëpunësit Zbatues është në përputhshmëri ligjore. Humbja në ulje në vitin 2018, në 7,773,000 lekë.*

**Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH – së:**

Observacioni pranon largimin e asetëve drejt aksionarit, lejim ushtrim të aktiviteteve nga Qendra shëndetësore pa qira, kioska që paguajnë drejtpërdrejtë aksionarin në qiradhënie, fast food dhe lokale që paguajnë qiradhënie aksionarit direkt dhe jo shoqërisë. Po ky observacion pranon se nuk ka mbaruar hipotekimi i asetëve të shoqërisë, nuk ka kalçeto në pronësi të shoqërisë, edhe pse paraqitet në hartë topografike etj. Kjo është mungesë e gjurmës së auditit në operacionet me risk. Asetet janë risku më i lartë i shoqërisë, ku janë evidentuar vlera të pajustificuara, edhe në pikat e tjera të grupit auditues.

*Observacioni nuk merret parasysh si i pambështetur në fakte e prova.*

**e. Titulli i Gjetjes:** Miratim i planit strategjik dhe vjetor të auditimit, të Njesisë së Auditit të Brendshëm (në vijim NJAB) dhe raportet e auditimit nga organ i paautorizuar sipas ligjit.

**Situata:** RSU nr. 1 Tiranë SHA ka miratuar: Një plan strategjik për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2019 të NJAB, si edhe planin vjetor të auditimit, për vitin 2017, me Vendim nr. 97, datë 13.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë e më pas në KM. Raporti i Auditimit është miratuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë e më pas në KM të Shoqërisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni (12) Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike, germa (ç), kompetenca e miratimit të planeve



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

audituese të subjektit. Ligjit nr. 114/2015, sipërcituar, neni (4) Përkufizime, pika (18). Ligji nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni (135) Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, pika (2), germa (a). Ligji nr. 114/2015, sipërcituar përcakton në nenin (10) Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika (2). Rrjedhimisht, NJAB raporton vetëm para Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve.

**Ndikimi/Efekti:** Administratori ose Nëpunësi Autorizues në funksion ka marrë kompetenca të Asamblesë së Përgjithshme në planifikimin dhe raportimin e NJAB.

**Shkaku:** Nëpunësi Autorizues ka ushtruar kompetencat e plota që nuk i përkasin.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Asambleja e Përgjithshme të marrë masa për të analizuar raportin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të shoqërisë për vitin 2019 dhe të miratojë planin e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, në përputhje me regjistrin e riskut të shoqërisë dhe gjetjeve të KLSH. Asambleja e Përgjithshme të marrë masa për të plotësuar numrin minimal të audituesve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm të përcaktuar sipas kërkesave ligjore.

**Afati:** Menjëherë dhe në vijim

Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është dërguar observacioni Projekt-Raportit, i administruar në RSU nr. 1 me nr. 1185 prot., datë 19.12.2019 dhe në KLSH me protokoll nr. 598/4, datë 19.12.2019, nga ana e të cilëve pretendohet se:

*NJAB raporton në KM të shoqërisë sipas ligjit.*

**Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH – së:**

Lidhur observacionin se NJAB raporton në KM, është provë e mjaftueshme e shkeljes së ligjit për auditimin e brendshëm, referuar gjetjeve për NJAB në Projekt Raport, specifikisht Kriterit të gjetjes 8.e.

*Observacioni nuk merret parasysht si i pambështetur në fakte e prova.*

## **9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale si dhe nga lidhja e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.**

RSU nr. 1 Tiranë SHA ka në funksion të qiradhënies objekte dhe troje. Në objektet e dhënë me qira janë për shërbim hotelerie 25 godina, dhe 4 godina janë në funksion të familjarëve të cilët janë të vendosura në këto ambiente prej viteve '90. Kapaciteti i hotelerisë për studentë është 5745 shtretër. Kapaciteti i hotelerisë për familjarë nuk është i shfrytëzuar i plotë, por ende jetojnë 130 familje në katër godina. Shoqëria ka 7 kontrata qiraje, prej të cilave 4 janë në juridiksionin e organeve drejtuese për t'u dhënë me qira, ndërsa 3 kontrata qiraje janë në juridiksionin e AP të shoqërisë. Qiradhënia sipas objektit të qirasë është e ndarë në 6 objekte dhe një truall. Shoqëria nuk ka marrë masa për dhënien me qira të disa ambienteve në mesin 18 që funksionojnë si Qendër Shëndetësore dhe në 5 zyra të Administratës që janë të funksion mësimsdhënie të Universitetit të Tiranës. Shoqëria nuk ka dhënë me qira truall për shërbimet tregtare që janë aktualisht në Qytetin Studenti, dhe nuk merr të ardhura nga përdorimi i tyre nga këto subjekte. Në kuadër të respektimit të bazës ligjore për qiradhënie dhe administrimin e mbledhjes së qirave nga auditimi rezultoi se:

- a. **Titulli i Gjetjes:** Në objektet e dhëna me qira janë konstatuar probleme ligjore dhe dëme financiare të shkaktuara ndaj shoqërisë.

**Situata:** Shoqëria RSU nr. 1 Tiranë SHA ka dhënë me qira 7 objekte, nga të cilat:

--- Subjekti “E...A”, person fizik i regjistruar me NIPT nr. K9...3F, ka marrë me qira një objekt me sipërfaqe sipas Gent planit, pjesa e hartës, është **202.34m<sup>2</sup>**, ndërsa po sipas të njëjtit Gent Plan topografi ka rrumbullakosur vlerën në 200 m<sup>2</sup>. Lidhja e kontratës është bërë pa një vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë. Duhet theksuar se për të mbërritur tek objekti me qira, qiramarrësi





KONTROLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

ka një verandë dhe shkallët hyrëse, që i shërbejnë ekskluzivisht vetëm këtij ambienti, **por që nuk janë të përfshira në sipërfaqen funksionale.**

--- Subjekti “A...A” i identifikuar me NIPT K8...3S, ka pasur me qira një objekt 100 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i pasqyrës së derdhjeve, vihet re se vlera që subjekti detyrohet së bashku me kamatëvonesat vlerën **143,089 Lekë detyrim i pa arkëtuar**, sipas shoqërisë. Shoqëria RSU nr. 1 Tiranë SHA, nuk ka marrë asnjë masë për të mbledhur këtë detyrim, as administrativ dhe as ligjor.

--- Subjekti “A...M”, i identifikuar me NIPT K5...5N, ka bërë një kontratë një-vjeçare me shoqërinë RSU nr. 1 Tiranë SHA për një sipërfaqe prej 30 m<sup>2</sup>, soletë e godinës së studentëve, në vlerën 50,000 Lekë në muaj. Kontrata ka mangësi në përmbajtje të nenit (18/2) i cili është jo favorizues për shoqërinë qiradhënëse, ku citohet se: “...**në rast mosfunksionimi të antenave të Albtelekom, kjo kontratë është e pavlefshme**”.

--- Subjekti “T...G”, si subjekt i paregjistruar tregtar me NIPT, por nën identifikimin e Znj. E.Z. Drejtor i Përgjithshëm i T...G, institucion i vartësisë nga Bashkia Tiranë, me kartë identiteti nr. I...J, ka bërë kërkesë për marrjen me qira të një trualli, për ndërtimin e një parkingu prej 6,000 m<sup>2</sup>, në datën 29.06.2016, sipas projektit të Këshillit Teknik (në vijim KT) nr. 6/4, datë 05.05.2016, i cili është mbështetur në Plan vendosjen e topografit të licencuar me licencë nr. T...1.

Kërkesa nuk ka një vendim të KKT, por ky vendim vjen në datën 02.02.2018 për leje ndërtimore koncesionare. Trualli nuk ka qenë i lirë, por këndet sportive të Qytetit Studenti, të pa mirëmbajtura, verifikuar nga pamjet e Google Earth. T...G nuk është parashikuar në grupin e subjekteve që përjashtohen nga konkurrimi për të marrë me qira këtë truall, dhe kushtet në kushtet specifike të sipërfaqes që kërkon. Nga ana tjetër VKM nr. 54, sipërcituar, nuk specifikon dhënien e një trualli të lirë, pa asnjë objekt në të, me qira. Nuk ka një plan/projekt për “Kalçeton” që përcakton kjo shkresë e datës 29.06.2016, si do të ndërtohet dhe ku. Gent plani që ka shqyrtuar KT, sipas topografit të licencuar mban datën 04.05.2016, dhe evidenton një sipërfaqe total prej 6,515.39 m<sup>2</sup> ku në pjesën lindore është dhe objekti “Kalçeto”.

Pamjet e “Google Earth” evidentojnë se në datën 24.07.2016, kanë përfunduar shtresat e stabilizantit në pjesën lindore të parkimit dhe ai funksionon si parkim autobusësh, sipas “Projektit” të datës 30.06.2016, dorëzuar në RSU nr. 1 Tiranë SHA referuar librit të korrespondencës së jashtme (MOD 1) të shoqërisë, dhe për këtë nuk ka një dokument që tregon fillimin e punimeve, apo qiramarrjes.

Sipas “Web Site” të T...G, ky parkim inaugurohet në datën 08.02.2017, dhe futet në funksion në datën 12.02.2017, fakt ky që provohet me foto dhe pamjet e “Google Earth” të datës 22.02.2017. Detajet në <http://tiranaparking.al/terminal-i-autobuzave-nderqytetas-zona-jug-lindje/>.

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Tiranë, në datën 06.11.2017, KM miraton lidhjen e kontratës me T...G, kompetencë që e ka Këshilli Bashkiak Tiranë ose i deleguari i tij në kundërshtim flagrant me ligjin nr. 139/2015, sipërcituar.

Kontrata lidhet në datën 07.12.2017 mes RSU nr. 1 Tiranë SHA dhe “T...G,” në kundërshtim me nenin (3/1), të saj, **pa anekset Gent Planit dhe Certifikatës së Pronësisë**. Certifikata e Pronësisë është marrë në datë **07.11.2018**, sipas dokumenteve të bashkisë Tiranë sjellë në RSU nr. 1 Tiranë SHA me Protokoll nr. 985, datë 03.12.2018 dhe Gent plani, nuk ka qenë pjesë e kontratës, por është futur më pas në libër protokoll pa një shkresë shoqëruese dhe mban numër protokollit 724/1, datë 07.12.2017 ndryshe nga kontrata që mban numër protokollit 724, datë 07.12.2017. Ky Gent plan (*General Plan ose Plan i Përgjithshëm më drejt*) me titull; “Gent plani



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

*i parkingut të dhënë me qira Z.K.8160TR-S-14 Qyteti Studenti Tiranë SHK.1:500*”, evidenton prej titullit se parkimi është dhënë tashmë me qira, sikundër shfaqen ndarëset e betonuara, trotualet, vendi i koshave të plehrave etj, tashmë në funksion, përfshirë banjat publike, është paraqitur si “provë” observuese.

**Veprimet në libër protokollin e shoqërisë, nuk krijojnë bindjen se janë autentike. Në libër protokoll evidentuar me laps, dhe është lenë enkas hapësira bosh, për procesverbalin e marrjes në dorëzim nga qiramarrësi, me protokoll hipotetik 725, por nuk ka faktikisht procesverbal dorëzimi tek qiramarrësi.** Gent plani i bërë nga topograf i licencuar me Licencë nr. T...3, mban datën 20.11.2017, i firmosur dhe nga Administratori i RSU nr. 1 Tiranë SHA, duke prezantuar parcelat kadastrale 5/611 që nuk janë pjesë e kontratës, dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, si edhe Autorizimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ky Gent plan nuk merr në llogaritje parcelën 5/251 pjesë e kontratës, dhe as parcelën 5/102. Sipërfaqja e të cilave është sipas Gent planit të datës 04.05.2016 përkatësisht 342.61 m<sup>2</sup> dhe 618.26 m<sup>2</sup>, ose në total 960.87 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e përgjithshme e Gent planit është 6960.87 m<sup>2</sup> ose 445.48 m<sup>2</sup> më shumë se Gent plani i datës 04.05.2016. Aktualisht T...G vepron në truallin e RSU nr. 1 Tiranë SHA, me një NIPT L5...1V, në shërbim të parkimit të veturave dhe autobusëve, por pa u regjistruar në QKB si subjekt. Detyrimi për një ekstrakt të QKB, është për të gjithë subjektet pavarësisht nëse janë objekt konkurrimi për të marrë një kontratë qiraje apo jo. Për aq kohë sa ku subjekt nuk ekziston i regjistruar në QKB nuk mund të ushtroj aktivitet tregtar, dhe nuk mund t'i jepet pronë me qira.

**Shoqëria T...G nuk ka paguar detyrimin e pagesës së tre muajve paradhënie, para të firmosëj kontrata. Në përfundim, rezulton se qiramarrësi përdor jo më vonë se data 24.07.2016 një sipërfaqe trualli prej 6960.87 m<sup>2</sup>, për së cilin paguan vetëm 6,000 m<sup>2</sup>, nga data 07.12.2017 e në vijim.**

**--- Të gjitha kontratat janë mbajtur në libër protokollin e brendshëm, të pavulosura në çdo fage, pa kundër firmë në çdo fage, pa anekse kontrate, Gent plane, bashkëlidhur me vulë.**

**Kriteri:** VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për caktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli (I) “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika (6), germa (b), nëntitulli (i) si edhe pika (7), Ligji nr. 139/2015, sipërcituar, neni (54) Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, germa (e), VKM nr. 54, sipërcituar, Kapitulli (II) “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”, pika (6). VKM nr. 54, sipërcituar, kapitullit (II) “procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”, pika(1), dhe pika (2). VKM nr. 54, sipërcituar, kapitullit (II) , pika(5), dhe pika (7), përfshirë gjithashtu edhe kriteret e konkurrimit të çdo subjekti që kërkon marrjen me qira sipas përcaktimeve të VKM nr. 54, sipërcituar, kapitullit (I), pika(3). Në fund të procesit të vlerësimit, dhe shpalljes së fituesit, për marrje me qira, të drejtën për ta lidhur marrëveshjen e qiradhënies e ushtron Këshilli Bashkiak Tiranë, në emër të së cilit firmos Kryetari i Këshillit Bashkiak. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neni (109) Paligjshmëria e aktit administrativ, neni (110) Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni (815) Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit. Vlera **143,089 Lekë detyrim i pa arkëtuar për shoqërinë**, si pasojë e mosveprimeve të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të shoqërisë, për subjektin “A...A”. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni (801) Qiraja. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni (820) Mbarimi i kontratës. VKM nr. 54, sipërcituar, kapitullit(I), “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrencimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika(5), germa (f). Këshilli Bashkiak Tiranë me Vendimin nr. 86, të Këshillit Bashkiak Tiranë, datë 29.12.2016, pika 3, ka një kontratë nën qiraje me shoqërinë “P...L” SHA, për ndërtim dhe dhënie me koncesion për 20 vjet të këtij terminali. VKM nr. 54, sipërcituar, Kapitulli (II) sipërcituar, pika (6). Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neni (11) Diskrecioni. Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, neni 53. Kodit Civil, neni 655 dhe neni 656, “Bëgatim pa shkak”. VKM nr. 54, sipërcituar, Kapitulli (III) “tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, pika (2), prej 100 Lekë/m<sup>2</sup>, ose një vlerë prej 696,087 Lekë në muaj, për periudhën nga data 27.07.2016 deri në datën 07.12.2017. Kjo vlerë është e detyrueshme për pagesë për (8/31) ditë për muajin Korrik 2016, plus 16 muaj të plotë, plus (7/31) ditë deri në lidhjen e kontratës. Në total;

$$\{(15/31) + 16\} \text{ muaj} * 696,087 \text{ Lekë/muaj} = 11,474,208 \text{ Lekë dëm ekonomik}$$

I shkaktuar nga shoqëria “T...G”, ndaj RSU nr. 1 Tiranë SHA në përdorimin e sipërfaqes së truallit të fushave sportive të Qytetit Studenti, për parkim autobusësh. **Kjo e ardhur edhe pse pa kontratë duhet të mbliidhej nga RSU nr. 1 Tiranë SHA**, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, sipërcituar, neni 655 dhe neni 656. VKM nr. 54, sipërcituar, garancinë e qirasë, specifikuar në Kapitullin (II), pika (14). Konkretisht, T...G, duhej të paguante vlerën prej:

$$3 \text{ muaj} * 696,087 \text{ Lekë/muaj} = 2,088,261 \text{ Lekë garanci kontrate}$$

Shoqëria ka bërë pagesën e muajit Dhjetor 2017, në vitin 2018. Deri në fund të periudhës audituese, T...G ka paguar vetëm për sipërfaqen 6,000 m<sup>2</sup>, për periudhën nga data 07.12.2017 deri në datën 31.08.2019, por jo vlerën e 960.87 m<sup>2</sup>, që ka në përdorim sipas Gent planit. Shuma prej.

$$\{(24/31) + 20\} \text{ muaj} * 96,087 \text{ Lekë/muaj} = 1,996,130 \text{ Lekë efekt ekonomik negativ për buxhetin e shoqërisë}$$

ka ardhur si pasojë e veprimeve/mosveprimeve të Administratorit (Drejtorit të Përgjithshëm) të RSU nr. 1 Tiranë SHA dhe KM të shoqërisë të cilët kanë vepruar në tejkalim kompetencash.

**Ndikimi/Efekti:** Kontratat e qirave të RSU nr. 1 Tiranë SHA janë evidentuar me mangësi ligjore, të paplota, me efekte negative financiare për shoqërinë. Ka kontrata tej lejlimeve ligjore të organeve të shoqërisë.

**Shkaku:** Administratori, Administrata dhe KM i shoqërisë në mënyrë të përsëritur kanë bërë shkelje ligjore të natyrave të ndryshme. Nëpunësi Zbatues nuk ka mbajtur gjurmën e auditimit për asetet e dhëna me qira, dhe vlerën e tyre kontabël.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandime:** Asambleja e Përgjithshme (Këshilli Bashkiak Tiranë) e SHA RSU Nr. 1 Tiranë, në cilësinë e organit përgjegjës për politikën e shoqërisë të analizojë shkaqet e shkeljeve ligjore dhe të rivendosi në përputhshmëri ligjore situatën. Administratori të marrë masa për ndjekjen ligjore të situatës sipas përcaktimeve të Kodit Civil mbi Uzufutrin, Bëgatim pa Shkak dhe Qiratë. Drejtoria juridike e RSU nr. 1 Tiranë SHA të adresojë këto mospërputhje në organet kompetente, për ngarkim me përgjegjësi të personave. Administratori të marrë masa administrative dhe ligjore, për të arkëtuar detyrimin prej **11,474,208 Lekë dëm ekonomik** nga shoqëria “T...G” dhe detyrimet rrjedhëse për dëmtimin e aseteve të shoqërisë dhe Vlerën **143,089 Lekë detyrim i pa arkëtuar për shoqërinë nga subjekti “A...A”**.

**Afati:** Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU nr. 1 Tiranë SHA me shkresën nr. 1185, datë 19.12.2019, protokolluar në KLSH me nr. 598/4, datë 19.12.2019, në lidhje me Projekt Raportin e auditimit të dërguar me nr. 598/3 datë 29.11.2019, ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore dhe nuk ka pasur elementë të shtuar nga observacionet e mëparshme.

**b. Titulli i gjetjes:** Janë identifikuar objekte që përdoren nga të tretët, pa kontratë dhe nuk paguajnë qira.

**Situata:** Janë identifikuar nga grupi i auditimit se nuk kanë kontratë qiraje, por posedojnë objekt në pronësi të RSU nr. 1 Tiranë SHA:

--- Në asetin truall të RSU nr. 1 Tiranë SHA, janë vendosur 2 kioska të Bashkisë Tiranë, si edhe janë disa subjekte që përdorin sipërfaqen truall si ambiente të jashtëm për bare dhe fast-food. Në total sipërfaqja e përlogaritur nga [www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al) shkon në 617.4 m<sup>2</sup> e cila merret e pandryshuar nga leximi zyrtar i ASIG. ASIG është fokusuar të prezantojë të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore, të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

**Kriteri:** Sipas përcaktimeve të VKM 54, sipërcituar, dhe Kodit Civil sipërcituar,

--- Në truallin e lirë të RSU nr. 1 Tiranë SHA, janë vendosur dy kioska tip, dhe sipërfaqet frigoriferike përkatëse, në dy pozicione. Kioska e parë, pranë Terminalit të Autobusëve, e cila ka sipërfaqe 12.38 m<sup>2</sup>, dhe kioska e dytë, pranë Drejtorisë së RSU nr. 1 Tiranë SHA, në pjesën veriore të rrugës “Pjetër Budi” me sipërfaqe 21.57 m<sup>2</sup>. Shoqëria duhet të kishte mbledhur detyrimin sipas përcaktimeve të Kodit Civil, neni 655 dhe neni 656.

-Pranë ndërtesës së ish-mensave, të cilat janë privatizuar, ka në tre drejtime sipërfaqe të disa bareve dhe njërive të tjera të shërbimit, që funksionojnë në territori e dhënë në administrim të “Pjetër Budi” nga VKM nr. 403, datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrative shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr.1”. Këto sipërfaqe janë në pjesën, Jugor, Lindore dhe Veriore të ish-mensave. Në pjesën Veriore të Rrugës “Pjetër Budi”, janë disa bare dhe fast-food.

Në total vlera e trojeve të lira, për të cilat nuk është bërë asnjë arkëtim është, Vlera e qirasë truall sipas VKM nr. 54, Shtojca I, “Për truallin e lirë, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 (njëqind) lekë/m<sup>2</sup>”, ndërsa për periudhën audituese prej 32 muajsh, vlera totale shkon në:

32 muaj x (100\*617.4) Lekë/muaj =

32 muaj x 61,740.00 Lekë/muaj = 1,975,680 Lekë detyrim i pa arkëtuar.

Këtë vlerë që duhej të arkëtohej nga ana e RSU nr. 1 Tiranë SHA, sipas përcaktimeve të Kodit Civil, neni (655) dhe 656), si edhe VKM nr. 54, sipërcituar të dyja më sipër, është **1,975,680 Lekë detyrim i pa arkëtuar që përbën dëm i mundshëm ekonomik ndaj shoqërisë.**

**Ndikimi/Efekti:** RSU nr. 1 Tiranë SHA nuk ka kontrata qiraje me subjekte të ndryshëm që kanë troje në përdorim pa pagesa ndaj shoqërisë, dhe nga ky përdorim shoqërisë i është shkaktuar dëm ekonomik.

**Shkaku:** Administratori, dhe Administrata e shoqërisë në mënyrë të përsëritur kanë bërë shkelje ligjore të natyrave të ndryshme duke mos mbajtur në kontroll asetet e shoqërisë, që janë përdorur nga të tretët, pa pagesë.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandime:** Të përcaktojë saktë sipërfaqen e truallit të çdo subjekti dhe lidhjen e kontratës së qiradhënies me përdoruesit. Të marrë masa administrative dhe ligjore për mbledhjen e



**KONTROLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

detyrimit nga të gjithë subjektet e evidentuar në auditim në vlerën 1,975,680 Lekë para lidhjes së kontratës me çdo subjekt, si edhe çdo detyrim vijues deri në lirimin e sipërfaqeve të zëna.

**Afati:** Menjëherë

Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është dërguar observacioni Projekt-Raportit, i administruar në RSU nr. 1 me nr. 1185 prot., datë 19.12.2019 dhe në KLSH me protokoll nr. 598/4, datë 19.12.2019, nga ana e të cilëve pretendohet se:

1. Subjekti “Qendra Shëndetësore” vijon prej vitit 1980 të mos paguaj.
2. Subjekti “Universiteti i Tiranës” nuk ka salla në përdorim, por ka një bashkëbisedim me Bashkinë Tiranë të marr pa pagesë salla në RSU nr. 1.
3. Dy kioskat paguajnë në Bashkinë Tiranë tarifë për përdorim të hapësirës publike.
4. Subjektet e tjera fast food dhe bare paguajnë në bashkinë Tiranë tarifë për përdorimin e hapësirës publike, pjesën tjetër nuk janë të qartë për cilat subjekte bëhet fjalë tek mensat në jug të rrugës “Pjetër Budi”.

**Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH – së:**

1. Observacioni u mor në konsideratë.
2. Observacioni u mor në konsideratë.
3. dhe 4. Dy kioskat paguajnë në Bashkinë Tiranë tarifë, në një pronë të RSU nr. 1. Lidhur me observacionin për këtë pikë ju bëjmë me dije që observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi materialet nuk janë argumentuara nga ana dokumentare dhe ligjore.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur për zbatimin e secilit rekomandim, nga ku rezultoi se sipas shkresës me nr. 759 prot., datë 01.11.2017 është dërguar Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe Rekomandimet drejtuar Znj. A.SH. Administrator i Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA. Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar:

- a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime.
- b. Janë rekomanduar 13 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2 masa, nuk janë zbatuar 3 masa dhe janë në proces realizimi 8 masa.
- c. Janë rekomanduar 2 masa për shpërbllim dëmi në shumën 511,927 lekë, të cilat janë në proces zbatimi.
- d. Janë rekomanduar 3 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, të cilat nuk janë zbatuar.
- e. Janë rekomanduar 3 masa disiplinore, të cilat nuk janë zbatuar.

Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ka sjellë mos zbatim të masave për zbatimin e ligjshmërisë dhe përmirësimin e punës të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit” neni 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 9-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, për nxjerrjen e përgjegjësive të mos zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm si dhe të marrë masa për realizimin e tyre.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka një statut të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme i cili nuk përcakton saktë të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë ndaj Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë si organe që përfaqësojnë AP. Statuti i ngarkon Shoqërisë detyra dhe përgjegjësi përtej kompetencave të saj ligjore.
- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka zgjedhur sipas përcaktimeve ligjore 4 Administratorët e Shoqërisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135/2/c.
- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka bërë regjistrimin e tre administratorëve (Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm) në QKB, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 36/h.
- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka mangësi në mbajtjen, administrimin dhe publikimin në internet të protokolleve të mbledhjeve të AP dhe vendimeve të saj në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 143/1 dhe neni 143/5 si edhe neni 135/4.

Gjithashtu, Rregullorja e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk është në përputhje me strukturën e shoqërisë dhe Statutin pasi disa prej pozicioneve të strukturës nuk janë të përfshira në këtë Rregullore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** AP të marrë masa për caktimin e numrit të Administratorëve dhe emërimin e tyre në përputhje aktet ligjore në fuqi, depozitimin në QKB të çdo akti të organeve drejtuese në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga dispozitat rregullatorë në fuqi, administrimin dhe publikimin në faqen zyrtare në internet protokollat e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme si dhe çdo vendim që rrit transparencën ndaj publikut, pa dëmtuar sekretin tregtar të shoqërisë si dhe rishikimin e Statutit të Shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për të hartuar dhe aprovuar në AP rregulloren e funksionimit të shoqërisë, përfshirë formimin arsimor të çdo hallke të shoqërisë nga Këshilli Mbikëqyrës deri tek punonjësi më i thjeshtë.

*Brenda datës 31.03.2020*

**3. Gjetje nga auditimi:** - Këshilli Mbikëqyrës i Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka marrë Vendimin nr. 1, datë 13.01.2017 lidhur me kompetenca të asistencës sociale, për të pastrehë, kompetencë kjo e parashikuar nga organet e qeverisjes vendore, konkretisht Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, pika n, neni 64, germa j dhe jo nga ky Këshill. Gjithashtu, me po këtë vendim është miratuar dhënia me qira e ish – lavanderisë subjektit “E...A”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi mospërputhje mes sipërfaqes së cituar nga ekspertit i fushës (i cilit është shprehur për një sip. prej 200 m<sup>2</sup>) dhe sipërfaqes që rezultojn nga dimensionet e skicës së hartuar po nga eksperti i fushës (sipas të cilit rezultojn 202.34 m<sup>2</sup>).

- Këshilli Mbikëqyrës i Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA me vendimin nr. 1, datë 13.01.2017 ka dhënë me qira dy objekte, në kundërshtim kjo me VKM nr. 54 datë 05.02.2014, “Për caktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftiteozë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, Kapitulli I, pika 6/b/i, pasi kjo kompetencë është e Këshillit Bashkiak. Gjithashtu, me po këtë vendim është miratuar dhënia me qira e truallit subjektit “T...G”. Në fakt, vendimmarrja në lidhje me këtë truall nuk është kompetencë e këtij këshilli por e Asamblesë së Përgjithshme, kjo referuar VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për caktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Kapitulli 1, pika 5, germa f.

- Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendimin nr. 1, pika 3, datë 02.02.2018 për kthim të kontributeve ndaj aksionarit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 163/4/a dhe neni 163/4/d, duke ushtruar kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

- Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar pasqyrat financiare të viteve 2016, 2017, 2018 tej afateve ligjore me vendimet: Nr. 5/1 datë 03.07.2017; Nr. 4/1 datë 03.07.2018; Nr. 5/1 datë 23.07.2019, në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” i ndryshuar, neni (46). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Shoqëria të marrë masa për vlerësimin e saktë të sipërfaqes së objektit të dhënë me qira subjektit “E...A”.

*Menjëherë*

**3.2 Rekomandimi:** Shoqëria të marrë masa për të analizuar vendimmarrjen e Këshillit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve në lidhje me dhënien me qira ndaj “T...G”.

*Menjëherë*

**3.3 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme (Këshilli Bashkiak) të marrë masa për analizimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë dhe kthimin e parcelave kadastrale nr. 6/471, 6/678, 6/679 dhe 6/473 nën administrimin e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA.

*Menjëherë*

**3.3 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme të marrë masa për analizimin e vonesave në miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë nga Këshilli Mbikëqyrës.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** - Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë depozituar në shoqëri deklaratat e konfliktit të interesit, të dhënat e kualifikimit profesional, të pjesëmarrjes në ndonjë këshill tjetër, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 13/2 dhe VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 5, pika 6/ç.

- Vendimet e marra nga Drejtoria e Shoqërisë, nuk janë kryer në mënyrë kolegjiale kjo në kundërshtim me nenin 12, “Kompetencat e Drejtorisë”, pikat 1 dhe 4 të Statutit të Shoqërisë, miratuar me Vendim nr. 27004 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë; - Vendimet e mësipërme nuk janë përpunuar saktë si materiale arkivor, nuk janë nisur nga persona të autorizuar nga ligji, kontratat nuk janë vulosur në çdo faqe dhe janë mbajtur në tre libra protokolli, veprime këto në kundërshtim me Vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Normat tekniko-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme, në lidhje me Drejtimin e Shoqërisë, të kryejë rishikimin e Statutit ku të përcaktojë saktë numrin, funksionin dhe përgjegjësitë konkrete të Administratorit/Administratoreve të cilët aktualisht janë si Drejtorë/Zv. Drejtorë të Përgjithshëm dhe jo si Administratorë.

**4.2 Rekomandimi:** Shoqëria të marrë masa për trajnimin e punonjësve të përfshirë në sektorin arkivues apo punësimin e stafit me eksperiencë.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me strukturën organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve rezultoi se me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 17.04.2019 është miratuar struktura e Shoqërisë dhe numri total i punonjësve prej 404. Në fakt, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se niveli i pagave nuk ka marrë miratimin e Ministrisë përkatëse, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” neni 6, pika 1, germa (a). Gjithashtu, struktura organike e shoqërisë dhe raporti numri i punonjësve/numër studentësh nuk janë parashikuar në raportin (1/15). Konkretisht, u konstatuan diferenca më shumë për vitin 2017, 116 punonjës, për vitin 2018, 107 punonjës dhe për vitin 2019, 124 punonjës, në kundërshtim kjo me Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mensave të Studentëve”. Sa më sipër është konstatuar edhe nga auditimi i mëparshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Administratori i Rezidencë Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, të marrë masa për të iniciuar procedurat për propozimin deri në ndryshim, për rregullimin e dispozitave ligjore në lidhje me numrin minimal të punonjësve si dhe të aprovojë nivelet e pagave të punonjësve nga Ministria përkatëse sipas legjisllacionit në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me listë prezencat rezultoi se 75 punonjës sanitarë, 27 punonjës higjiene, dhe 24 punonjës gjelbërimi gjatë periudhës objekt auditimi, kanë punuar në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare pa përfituar kompensim page ose pushimin respektiv, në kundërshtim kjo me Kodin e Punës, nenin 87. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të shoqërisë të marrë masa për kompensimin e punës së kryer nga punonjësit në ditët jashtë orarit zyrtar dhe gjatë festave.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, është konstatuar se në 2 procedura janë përdorur specifikime teknike shumë specifike të cilat nuk janë argumentuar nga njësia e prokurimit mbi nevojën dhe arsyen e vendosjes së tyre. Këto





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

specifikime kanë ndikuar në uljen e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Nga njësia e prokurimit të merren masa që në të ardhmen të argumentohet saktë nevoja dhe vendosja e disa specifikime teknike të veçanta, me arsye mos pengimin e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Shërbimi kontabël në Shoqëri realizon regjistrimet e veprimeve kontabël në Excel, dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimin të veprimeve kontabël. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Neni 11. Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njëjësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 22-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për pajisjen e Departamentit të Planifikimit Financiar dhe Buxhetit, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me zërin e trojeve u konstatua se procesin e marrjes së certifikatave të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa Shoqëria e ka nisur në vitin 2009 pas daljes së VKM nr. 403 datë 22.04.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr. 1 Tiranë”. Në vitin 2015 ka përfunduar procesi i marrjes së certifikatave të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa për Shoqërinë. Pas përfundimit të këtij procesi rezultoi se rreth 16 pjesë të pronës së Shoqërisë kanë rezultuar me pronarë të tjerë në ZRPP, Tiranë, me një sipërfaqe totale prej 59,431 m<sup>2</sup> dhe për këto sipërfaqe nuk janë marrë certifikata pronësie. Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë marrë masat për korrigjimin e zërit të bilancit troje për sipërfaqet që nuk rezultojnë në pronësi të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA. Lista e inventarit të shoqërisë është miratuar me VKM nr. 403 datë 22.04.2009 dhe ka një sipërfaqe totale të truallit prej 248,436 m<sup>2</sup>. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare parimet dhe përbërësit e pasqyrave financiare”, Neni 9, Respektimi i standardeve kontabël, pika,1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njëjësive ekonomike. Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël., Standardi Kombëtar i Kontabilitetit, nr. 1, “Kuadri i Përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, i



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

*Përmirësuar” paragrafi , nr. 70 në lidhje me rëndësinë dhe materialitetin, SKK nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”- i përmirësuar, pika 8, njohja e AAM. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 22-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Nga drejtimi i shoqërisë dhe departamenti i financës dhe departamentet përkatëse duhet të kryhet analiza e situatës së aseteve të shoqërisë, të vlerësohet shuma që do të korrigjohet dhe pas miratimit nga ortaku të reflektohet në pasqyrat financiare të periudhës përkatëse në zërin e shpenzimeve.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pika 30. Njëkohësisht rezultoi se komisionet e ngarkuara me inventarizimet e aktiveve të shoqërisë për periudhat 2017 e 2018, kanë mbajtur vetëm proces verbale lidhur me gjendjen materialeve në dorëzim dhe nuk kanë përpiluar një raport për inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjet fizike si dhe vërejtjet lidhur me to, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenet 83 e 85. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se në përgatitjen e pasqyrave financiare, normat e amortizimit për aktivet afatgjata materiale janë marrë pa u miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, veprim ky në kundërshtim me Ligji Nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 5, 9, “Mbajtja e kontabilitetit”; Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 1 – Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare - i përmirësuar, pika 103. Zbatimi i vlerësimeve kontabël citon: “Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë: (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit; (c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.”; Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, pika 39 citon se “Çdo njësi ekonomike cakton metodat e amortizimit dhe normat e amortizimit në politikat dhe procedurat e saj kontabël, të cilat duhet të përdoren për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale.”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 22-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre, të marrë masa që komisionet e inventarizimit të kryejnë procedurat përkatëse duke paraqitur vlerësimet e tyre në raportet përfundimtare si dhe aprovimin e normave menaxheriale, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

*Në vazhdimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike u shqyrtua dokumentacioni i administruar në lidhje me prokurimet për periudhën objekt



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

auditimi 01.01.2017 – 31.08.2019, nga ku rezultoi se për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nga ana e Titullarit të AK znj. A.SH. nuk janë marrë masa për emërimin e personi/personave përgjegjës për prokurimin për vitet 2016, 2017 dhe 2018, në kundërshtim kjo me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 57. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për emërimin e personit/personave përgjegjës për procedurat e prokurimit me qëllim administrimin e rregullt të tyre në përputhje me kuadrin rregullator përkatës.

*Në vazhdimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga 13 procedura të audituara, nga 13 të tilla në total:

A. Në 2 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017 dhe “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2017 janë vendosur ndër të tjera kriteri: “Dy ditë pas hapjes së ofertave ofertuesit do të sjellin mostrat e mëposhtme të mallit (ende pa përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave)”. Ky kriter është në kundërshtim me ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 48, pika 4, paragrafi dytë, neni 51, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 58, paragrafi i fundit

B. Në 6 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017; “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2017; “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2018; “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2018; “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2019; “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”, viti 2019; në DST nga NJP nuk është parashikuar grafiku i lëvrimit të mallit por vetëm afati ditor i dorëzimit të tij. Gjithashtu, në 2 raste (1 rast në 2018 dhe 1 rast në 2019) në DST nga NJP është parashikuar afati 45 ditë për ekzekutimin e kontratës, në një kohë kur specifikimet teknike kanë parashikuar një citim si më poshtë: “materialet inerte, çimento, dërrasa, gëlqerja do të furnizohen në mënyrë periodike sipas kërkesave të AK për efekt magazinimi, duke mos tejkaluar muajin Korrik 2019” pra duke krijuar mos përputhje mes afatit të zbatimit të kontratës dhe afatit të dorëzimit të mallit, në kundërshtim kjo me: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Kreu I, neni 11, pika 3, germa b si dhe Kreu II, Seksioni 2, neni 27.

C. Në 2 raste konkretisht në procedurat me objekt:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017 dhe “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2018; në DST, në brendësi të preventivit rezulton se janë kërkuar materiale elektrike të cilat përmendin marka, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik, evidentimin e saktë të nevojave për mallra duke u bazuar në eksperiencën e viteve të mëparshme me qëllim hartimin sa më të saktë të grafikut të lëvrimit të mallit. Gjithashtu, afati i lëvrimit të mallit të vendoset i njëjtë me atë të zbatimit të kontratës si dhe të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

merren masa që në hartimin e DST të shmangë përdorimin e markave pa vendosur fjalën ekuivalent.

*Në vazhdimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga 13 procedura të audituara, nga 13 të tilla në total:

**A.** Në 2 procedura në vitin 2017:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” dhe “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”;  
në 3 procedura në vitin 2018:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie” dhe  
“Lyerje e Godinave me Gëlqere”;

në 2 procedura në vitin 2019:

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” dhe “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozerie”;  
në DST është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të zotërojë certifikatën ISO 9001:2008” apo  
“Operatori ekonomik duhet të zotërojë certifikatën ISO 18001:2007”. Në fakt, vendosja e  
kritereve të tilla, të shprehura në të njëjtën mënyrë siç është paraqitur në DST rezulton se nuk  
lidhen ngushtë me nevojat konkrete të kontratës së blerjes pasi nuk është specifikuar fusha në të  
cilët duhet të jenë të certifikuar OE pjesëmarrës por është kërkuar thjesht që OE të jenë të pajisur  
me këto dy certifikata;

**B.** Në 1 procedurë në 2019, konkretisht atë me objekt “Riparim i pjesshëm i dhomave të  
studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”, me vlerë të fondit limit 20,040,052 lekë pa  
TVSh, rezulton se:

- janë kërkuar 5 pika licencash zbatimit nga të cilat 3 prej tyre nuk lidhen me nevojat e objektit e  
prokurimit;

- nuk është i argumentuar teknikisht mënyra e përcaktimit për 10 muratorë, 6 bojaxhinj dhe 2  
elektracistë në një kohë kur në total janë kërkuar 65 punëtorë.

- është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e  
shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi  
kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Në fakt,  
vendosja e këtij kriteri nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe nuk lidhet aspak me  
nevojat e investimit pasi, referuar VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe  
Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit  
Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1, ky institucion, sikundër edhe është emërtuar, ka  
kompetenca Inspektim dhe jo për të lëshuar dëshmi kualifikimi e si rrjedhojë nuk duhej vendosur  
dhe miratuar si kriter për gjithë stafin e punës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender.

**C.** Në 1 procedurë në 2019, konkretisht atë me objekt “Rikonstruksion i godinave 11 – 12”,  
me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh, në lidhje me DST rezulton se:

Nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e vendosura në lidhje me:

- Numrin total të punonjësve. Ky numër nuk është argumentuar në përputhje me grafikun e  
realizimit dhe zërat e preventivit të punimeve me qëllim lehtësimin edhe të vlerësimit të  
punëtorisë në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë;

- Numrin e mjeteve të kërkuara ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës i cili nuk është hartuar  
në përputhje me grafikun e realizimit të punimeve. Sipas grafikut rezulton se afati i parashikuar  
për realizimin e punimeve është 5 muaj dhe punimet janë të shpërndara ndaj dhe nuk  
argumentohet domosdoshmëria e 11 kamionëve/kamionçinave;



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

- Kriterin “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori dhe certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit/distributorit të autorizuar, ose një vetë deklaram nga ofertuesi pjesëmarrës që prodhuesi është i certifikuar me ISO 9001:2015 i cili do të jetë objekt verifikimi nga AK, për pajisjet e pasqyruara në preventiv, për:

- Autorizim prodhuesi/distributori për sistemet e akses kontrollit;
- Autorizim prodhuesi/distributori për kaldaja.

Në rast se autorizimi do të merret nga prodhuesi, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me anë të një autorizimi/kontrate midis tyre dhe prodhuesit; Në rastin e marrjes së autorizimit nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me distributorin e autorizuar me anë të një autorizimi/kontratë midis tyre.”

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, nuk lidhet ngushtë me nevojat e investimit në fjalë dhe as nuk shpreh qartësisht se për çfarë duhet ky autorizim (për furnizim, për tregtim me shumicë/pakicë, transportim etj., pra e thënë ndryshe se për çfarë kërkohet të autorizohen OE pjesëmarrës). Ky kriter nuk përcakton nevojat konkrete se nga lind domosdoshmëria për një autorizim të tillë dhe nuk ka përcaktuar qartë objektin e autorizimit.

- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë kategorinë e licencës **NS 19 A Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë**. Në fakt, referuar përshkrimit të kësaj pike licence rezulton se në tek kjo kategori përfshin punimet si më poshtë: “Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopjo, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zë izoluese të paretëve të terrenit ose të tuneleve”. Referuar preventivit të punimeve kjo pikë licence është e panevojshme;

- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Në fakt, vendosja e këtij kriteri nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërish dhe nuk lidhet aspak me nevojat e investimit pasi, referuar VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1 ky institucion, sikundër edhe është emërtuar, ka kompetenca Inspektim dhe jo për të lëshuar dëshmi kualifikimi e si rrjedhojë nuk duhej vendosur dhe miratuar si kriter për gjithë stafin e punës së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender.

**D.** Në 1 procedurë në vitin 2018:

“Blerje detergjente dhe materiale pastrimi”;

Specifikimet teknike të produkteve të kërkuara nga njësia e prokurimit janë të pabazuara në standardet kombëtare, të paqarta, të paverifikueshme dhe diskriminuese;

**E.** Në 1 procedurë në vitin 2017:

“Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”;

Dhe në 1 procedurë në vitin 2018:

“Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”;

Në specifikimet teknike të DST nga NJP është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin licencë për tregtimin e karburanteve pa specifikuar objektin e saj. Në fakt, në rastin konkret do duhet të ishte kërkuar licencë për shitje me pakicë të lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, siç edhe është rasti i objektit të prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 20 dhe 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, pika 3, pika 5, neni 27, pika 3, neni 61, pika 2 si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, i ndryshuar “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pikat I dhe II. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Komisionet e ngritura për hartimin e Kriteve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të vendosur si kushte për kualifikim vetëm krite të domosdoshme dhe të lidhura drejtpërdrejtë me Investimin/mallin/shërbimin. Gjithashtu, nga ana e Shoqërisë të merren masa për trajnimin e stafit, në lidhje me planifikimin dhe hartimin e dokumentacionit për procedurat e prokurimit publik.

*Në vazhdimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitet 2017, 2018 dhe deri më 31.08.2019, në 1 rast, përkatësisht në procedurë me objekt “Blerje detergjente dhe materiale pastrimi” marrja në dorëzim nga komisioni përkatës është bërë pa kryer verifikimet përkatëse lidhur me specifikimet teknike të produkteve, vlera e të cilave është 322,500 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 45. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për të ushtruar verifikimet përkatëse që komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, i kryejnë detyrat e ngarkuara me përgjegjshmëri dhe në përputhje të specifikimeve teknike të kërkuara në DST e procedurës së prokuruar.

*Në vazhdimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për vitet 2017, 2018 dhe deri më 31.08.2019, në 6 procedura prokurimi me vlerë totale të prokuruar 277,383,869 lekë pa TVSH, përkatësisht në procedurat:

- “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017 me vlerë të fondit limit 3,622,000 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 3,482,010 lekë pa TVSh;
  - “Lyerje e godinave me gëlqere”, viti 2018 me vlerë të fondit limit 4,084,140 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 1,989,432 lekë pa TVSh;
  - “Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 20,040,252 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 17,744,410 lekë pa TVSh;
  - “Rikonstruksion i godinave 11 – 12”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës së vetme të kualifikuar 232,793,719 lekë pa TVSh;
  - “Blerje karburanti për nevojat e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1”, viti 2017 me vlerë të fondit limit 1,083,333 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës 1,083,333 lekë pa TVSh;
  - “Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, viti 2018 me vlerë të fondit limit 1,083,333 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës 1,083,333 lekë pa TVSh;
- nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit dhe/apo kanë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

këto, në 4 raste, konkretisht në procedurat “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*”, viti 2017, “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, viti 2019 dhe “*Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1*”, viti 2017 dhe 2018, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re dhe në rastet e tjera duhet të ishte shpallur fitues OE pasardhës pasi OE të shpallur fitues janë rezultojnë me mangësi në dokumentacion. Konkretisht nga auditimi rezultoi se:

- a) Në vitin 2017 në procedurën me objekt “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*” OE “*M...D*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriterin në lidhje me Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore për Tatimpaguesin. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar;
- b) Në vitin 2017-2018 në procedurat me objekt “*Blerje karburant për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1*” OE “*A...T*” SHA i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriteret e veçanta lidhur me pagesat e taksave, pagesat e detyrimeve të energjisë elektrike, për aftësitë teknike e profesionale për certifikatën e cilësisë së karburantit si dhe për kriterin e pikës së furnizimit jo më larg se 5 km nga godina e institucionit. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar;
- c) Në vitin 2018 në procedurën me objekt “*Lyerje e godinave me gëlqere*” OE “*F...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriterin në lidhje me Stafin teknik të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;
- d) Në vitin 2019 në procedurën me objekt “*Riparim i pjesshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29*” OE “*I...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:

4. Në lidhje me Stafin jo vetëm që janë paraqitur kontrata pune për 17 punëtorë nga 18 të kërkuar por njëkohësisht janë paraqitur 17 dëshmi kualifikimi të lëshuara nga subjekti “*H...T*” ShPK. Referuar dokumentacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në faqen Web të kësaj Drejtorie <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> rezulton se ky subjekt është i akredituar si organizëm certifikimi personeli që certifikon personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/ IEC 17024:2012 “*Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli*” dhe jo për punime ndërtimi. Njëkohësisht referuar dokumentacionit të QKB rezulton se subjekti “*H...T*” ShPK me NIPT K9...4D ka si objekt të aktivitetit të tij “*...Certifikim personeli sipas standardit EN ISO/IEC 17024, për sigurimin teknik në fushën elektrike*”;

Për 7 punonjës janë paraqitur dokumente për profesione të cilat nuk përputhen me listë pagesat përkatëse. Pra këta punonjës nuk plotësojnë kushtin që lidhet me pasqyrimin e tyre në listë pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit;

5. Nga ana e OE “*I...A*” ShPK nuk është deklaruar e saktë Shtojca 11 “*Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces*” pasi sipas buletinit nr. 25 të datës 24.06.2019 ky OE është shpallur fitues i një kontrate me objekt “*Rikonstruksioni i Bibliotekës së Qytetit NjA 11*” me vlerë 1,748,456 lekë pa TVSh ose 2,056,978 lekë me TVSh me afat 7 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Pas shpalljes fitues për këtë objekt, sipas buletinit nr. 26 të datës 01.07.2019, është lidhur kontrata mes AK Bashkia Tiranë dhe OE “*I...A*” ShPK;



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

6. Në pikën 10 janë kërkuar dy mjete me tonazh deri në 5 ton. Në fakt SPE rezulton se si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e OE të shpallur fitues është paraqitur mjete me targa AA...UL ka një kapacitet prej 3.5 ton dhe mjete me targa AA...AV ka një kapacitet prej 7.5 ton duke mos përmbushur kështu këtë kriter të DST;

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e OE "I...A" ShPK janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s'kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;

e) Në vitin 2019 në procedurën me objekt "Rikonstruksion i godinave 11 – 12" BOE "E...N & A...N & A...O" ShPK është i vetmi ofertues i kualifikuar edhe pse nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:

**E...N**

- Sipas dokumenteve të tenderit preventivi i punimeve ka parashikuar një fond rezervë prej 3 % kurse oferta ekonomike e BOE të kualifikuar rezulton se ka parashikuar një fond rezervë prej 5 % duke mos ju përmbajtur kështu strukturës së parashikuar nga projektuesi /preventivuesi;
- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE nuk e plotëson këtë kriter pasi referuar dokumentit të paraqitur nga OE si dëshmi për përmbushjen e kriterit është paraqitur një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.05.2019. Nisur nga fakti që është kërkuar që ky specialist të figurojë të paktën 3 muajt e fundit si dhe faktit se zhvillimi i procedurës është zhvilluar me datë 11.07.2019, rezulton se në momentin e zhvillimit të procedurës ky punonjës nuk ka përmbushur kriterin e të qenit 3 muaj i punësuar si i ekspert zjarrfikës i certifikuar. Gjithashtu, referuar listë pagesave rezulton se ky punonjës, përgjatë muajve, janar – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, është paguar si Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë dhe asnjë muaj si ekspert zjarrfikës;

- Për dy specialistë termoteknikë është kërkuar si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontratat e punës dhe diplomat/dëftesat përkatëse, libreza e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE ka paraqitur dy certifikata, konkretisht për D. Ll dhe A. H. Pra në asnjë rast nuk janë paraqitur diplomat/dëftesat për termoteknikë. Gjithashtu, kontrata e lidhur me D. Ll rezulton se është e lidhur mes palëve (punëdhënësit "E...N" ShPK dhe punëmarrësit D. Ll) me përshkrim pune Inxhinier Civil dhe jo termoteknik. Për sa i përket listë pagesave rezulton se D. Ll është paguar si "Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë" kurse A. H. është paguar si "Specialist për tavane me gips", një profesion ky i cili bën pjesë në kategorinë Suvatues dhe kurrsesi pa asnjë lidhje me termoteknikën.

- Për sa i përket deklaratës në lidhje me Shtojcën nr. 8 Deklaratë mbi Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme, rezulton se G.K. i cili është deklaruar si inxhinier mekanik dhe Drejtues teknik i objektit në fjalë, referuar listë pagesave për të paktën periudhën janar 2018 – maj 2019 është paguar si teknik mekanik dhe jo si inxhinier mekanik;

Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

rezulton se janë pasqyruar dëshmi në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 10 punëtorë nga të paktën 48 të tillë që i takojnë OE "E...N" ShPK në raport me pjesën takuese





KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

(44 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

**A...A**

- Eksperti Zjarrfikës në muajt shkurt, mars, prill dhe maj 2019 ka punuar si Inxhinier ndërtesash dhe jo si ekspert zjarrfikës. Për rrjedhojë ky OE nuk e përmbush këtë kriter pasi nuk rezulton në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit;
- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*
- Rezulton se: nuk janë pasqyruar dëshmi të plota në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 17 punëtorë nga të paktën 56 të tillë që i takojnë OE "A...N" ShPK në raport me pjesën takuese (51 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

**A...N**

- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas materialeve të ngarkuara në sistem nga ky OE është paraqitur si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.04.2015 për L. D. Në fakt, referuar listë pagesave kjo punonjëse, përgjatë muajve shkurt – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, figuron si *Inxhinierë mjedisi për trajtim ujërash* (pavarësisht se nuk ka kryer asnjë ditë punë) dhe në asnjë muaj nuk figuron si ekspert zjarrfikës, ndryshe nga sa është kërkuar.

- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

Rezulton se edhe ky OE nuk plotëson numrin e nevojshëm të punëtorëve në proporcion me numrin e kërkuar.

**Nga sa më sipër rezulton se nga ana e BOE janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi pasi kontratat e lidhura mes palëve janë fiktive dhe nuk përputhen me dokumentacionin e ngarkuar në SPE.** Në total ky BOE nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe në këto kushte duhet të ishte s'kualifikuar. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar pasi nga auditimi rezultoi se BOE i mësipërm është i vetmi ofertues i kualifikuar. Sipas verifikimit në faqe e APP, referuar buletinit nr. 36 datë 09.10.2019 rezulton se është bërë shpallja e fituesit i cili rezulton të jetë BOE i vetëm i kualifikuar. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 2, germa a dhe c, neni 24, pika 1, germa ç, neni 53, pika 3, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, neni 66, VKM nr. 410 datë 13.05.2015 "*Për Krijimin, Organizimin dhe Funkionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*", Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA dhe komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave/ankesave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.

*Në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në procedurën me objekt “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*” nga ana e KVO, KSHA dhe Titullarit të AK janë mbajtur qëndrime të ndryshme për mangësi të njëjta në të paktën tre raste diferencat e ofertave mes të cilave janë në shumën prej të paktën 38,625,889 lekë pa TVSh. (*Kjo procedurë rezultoi ende në proces dhe akoma pa u lidhur kontrata me OE e vetëm të kualifikuar dhe në respektim të programit të auditimit, konkretisht periudhës objekt auditimi nga data 01.01.2017 deri më 31.08.2019, nga kjo procedurë u auditua në lidhje me dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion deri në datën 31.08.2019, datë në të cilën akoma nuk rezultoi të jetë shpallur OE fitues. Për sa më sipër si dhe referuar faktit se vlera e kontratës në raport dhe me investimet në total që ka kryer në vite Rezidenca Studentore Universitare nr. Tiranë SHA është me vlerë të konsiderueshme, kjo procedurë të dhe zbatimi i kontratës do të jenë objekt auditimi në auditimin e radhës të këtij Institucioni ose në një auditimi tematik i cili mund të jetë kur të bëhet auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve*). Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 2, germa a dhe c, neni 24, pika 1, germa ç, neni 46, pika 1, neni 53, pika 1, pika 3 dhe pika 4, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “*Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA dhe komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave/ankesave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj Shoqërisë.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se punimet në godinat me nr. 11 – 12 kanë nisur pa prezencën e një mbikëqyrësi punimesh dhe pa kontratë të lidhur me AK Rezidenca Studentore Universitare nr. 1. Gjithashtu, nga verifikimi u konstatua se punimet në proces rezultuan se ishin zëra punimesh të cilat ishin prokuruar sipas procedurës me objekt “*Rikonstruksion i godinës 11-12*”. Në momentin e kryerjes së verifikimit rezultuan në proces prokurimi dhe ende pa u lidhur kontrata përkatëse e zbatimit të punimeve dhe ajo e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 8402, date 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, neni 7; Ligjin nr. 107 datë 31.07.2014 “*Për planifikimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 39 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar Kreu I, pika 1 dhe pika 4 si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**17.1 Rekomandime:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përlllogaritjen dhe zbritjen e volumeve të punimeve të cilat janë kryer me punëtorët dhe specialistët e sektorëve nga kontrata e punimeve për zbatimin e kontratës (konkretisht punimet e heqjes së dyer-dritareve, punimet e transportimit të tyre, punimet e prishjes së shtresave në dysheme etj.).

**17.2 Rekomandime:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për personat e përfshirë për nisjen dhe vazhdimin e proceseve të punës në një kohë që këto procese dhe volume punimesh ishin objekt i një procedure prokurimi, vlerësimi i të cilës rezultoi të ishte kryer në momentin e nisjes së punimeve të zbatimit.

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për problematikën e bërë publike dhe në media në lidhje me cilësinë e punimeve në kontratën me objekt *“Riparim i pjesshëm i dhomave të akomodimit të studentëve të godinave 5, 20 – 21, 26 – 27, 28 – 29”* u krye një verifikim nga grupi i audituesve të KLSH, zbatimi i të cilës do të jetë përsëri objekt auditimi në auditimet e ardhshme pasi kontrata rezultoi në proces pasi sipas shkresës me nr. 701/2 prot., datë 31.10.2019 është bërë një amendament kontrate në lidhje me afatin e përfundimit të kontratës deri më 17.11.2019 pa shtesë në vlerën e kontratës. Nga verifikimi rezultoi se në godinat e përmendura më sipër dhe konkretisht në dhomat e konstatuara me probleme në lidhje me rënien e suvatimeve punimet e shtrimit të tavaneve të gipsit rezulton se janë realizuar pa fino pra të pa stukuara po të lyera direkt me bojë. Gjithashtu, rezulton se nuk janë analizuar drejtë shkaqet e rënies së suvatimeve pasi sipas të dhënave rezulton se tërmeti ka rënë në datën 21.09.2019, datë në të cilën nuk ka një procesverbal të konstatimit të problemeve në lidhje me rënien e suvatimeve në dhomat e përmendura. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, date 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandime:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA të marrë masa për vlerësimin, përlllogaritjen dhe zbritjen e volumeve të punimeve të cilat janë kryer pa cilësinë dhe proceset e nevojshme të punës në lidhje me tavanet e gipsit, suvatimet dhe çdo zë tjetër të përfshirë në preventiv.

*Menjëherë*

**19. Gjetje nga auditimi:** - Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka një Nëpunës Autorizues të caktuar nga Titullari dhe as një Nëpunës Zbatues, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, neni 4, pika 23.

- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, nuk ka objektiva të planifikuara të matshme dhe të arritshme për daljen nga deficitin financiar, nuk ka një rregullore të përditësuar. Organigrama e funksionimit, e miratuar nga një organ në kundërshtim me ligjin, nuk krijon një mjedis të kuptueshëm kontrolli. Njësia e Auditit



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

të Brendshëm është hallkë varësie nga Administratori. Shoqëria nuk ka një praktikë të shkruar për delegimin e kompetencave, rregullore apo vendim të Administratorit mbi delegimin e kompetencave.

- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, “Deklaratën e cilësisë” dhe Raporti përkatës “Për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë”, për vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk ka dorëzuar “Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2017, 2018 dhe 2019” në Ministrinë e linjës, nuk ka një regjistër risku dhe strategji risku. Nuk ka në funksion koordinatorin e riskut. Nuk ka krijuar njësinë antikorrupsion.

- Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka një gjurmë auditimi për proceset bazë të shoqërisë, nuk ka një hartë procesesh për ndjekjen e dokumentacionit dhe afatet e përgjigjeve, ndaj dokumenteve të deleguara për zbatim, nuk ka masa të shkruara për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit me natyrë delikate, si prokurimet, ndjekja e kontratave, ruajtja e aktiveve afatgjata së bashku me inventarizimin e tyre. Aktivitetet e shoqërisë janë të pa mbrojtura, ku evidentohen kontrata që nisin para afatit të nënshkrimit, subjekte që operojnë pa kontrata qiramarrje, nuk ka një procedurë të shkruar mbi rrjedhën dokumentare në shoqëri. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të marrë masa për caktimin e Nëpunësit Autorizues. Nëpunësi Autorizues të bëjë caktimin e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik si drejtuesit kryesorë të njësisë, hartimin dhe dorëzimin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të “Deklaratës së cilësisë”, “Për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë”, “Pyetësorin e Vetëvlerësimit të shoqërisë për vitin 2020”, caktimin e njësisë antikorrupsion në përputhje me aktet normative në fuqi, pakësimin e nivelit të riskut mbi aktivitetet, ruajtjen dhe mirë administrimin e tyre si edhe kronologjinë e mbajtjes së përgjegjësisë dokumentare në lidhje me aktivitetet e shoqërisë si dhe të marrë masa për planifikimin e objektivave të matshme dhe të arritshme në fushën e menaxhimit financiar për të pasur një bilanc pozitiv financiar

*Menjëherë*

**19.2 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të përditësuar, dhe të organigramës së Shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria ka miratuar planet strategjik dhe vjetor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të saj përmes Administratorit. Njësia e Auditit të Brendshëm ka paraqitur raportin e auditimit vjetor administratorit për miratim, i cili është subjekt auditimi. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka vetëm një auditues të miratuar dhe është e paplotësuar me numrin minimal të anëtarëve të përcaktuar e cila ndikon në cilësinë e auditimit dhe krijon mospërputhje me standardet audituese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi:** Nga Asambleja e Përgjithshme të merren masa për organizimin e funksionimit të AB me një nga format e përcaktuara në ligj për sa kohë struktura e brendshme nuk është funksionale.

*Menjëherë*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**21. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA në kontratën me subjektin “A...M” ka një nen sipas të cilit “...vlefshmëria e kontratës kushtëzohet nga funksionimi teknik i pajisjeve të qiramarrësit”, nen ky i cili është në kundërshtim me Kodin Civil, kapitulli i Qiradhënies pasi funksionimi ose jo i pajisjeve nuk është përgjegjësi e qiradhënësit (në këtë rast Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa për të amenduar kontratën në terma juridik, në përputhje me kornizën e lejimeve të legjislacionit në fuqi. Në të ardhmen çdo kontratë qiradhënie duhet të ketë marrë vlerësimin e Drejtorisë Juridike para firmosjes nga Administratori.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** - Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka negociuar një marrëveshje për dhënien e një sipërfaqe truall të lirë me qira prej 6,000 m<sup>2</sup>, **me një subjekt jo tregtar**, i identifikuar me NIPT L5...1V, me emrin “T...G”. Ky subjekt nuk rezulton i regjistruar në regjistrin elektronik të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sepse një tjetër subjekt po me këtë emër “T...G SHPK”, është aktualisht i regjistruar prej datës 12.05.2016, ndërkohë që Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, i ndryshuar, neni 23/1 ndalon përdorimin e emrave të ngjashëm, dhe se i pari emrin e regjistron subjekti i paraqitur më herët, sipas nenit 23/2. Po ky ligj përcakton në nenin 18/2 se të dhënat janë vetëm elektronike.

- Administratori i shoqërisë pa plotësuar kërkesat e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për caktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, Kapitulli II “Procedurat e dhënies me qira”, me shkresën protokoll nr. 4, datë 06.01.2017, në kushtet kur “T...G” ishte duke përfunduar punimet për funksionimin e parkimit, ka kaluar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës dhënien me qira të truallit për parkim. Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 1, datë 13.01.2017, aprovon dhënien me qira duke vendosur afat 1 vjeçar, por pa një kërkesë të dytë merr përsëri vendimin nr. 6, datë 20.07.2017, për dakordsinë e dhënies me qira pas miratimit në Këshillin Bashkiak Tiranë. Duhet theksuar se prej datës 12.02.2017 ky parkim është në funksion për qytetarët pa pagesë dhe pa kontratë, nga një subjekt jo tregtar. Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 SHA nuk ka marrë masa për moslejimin e nisjes së punimeve për ndërtimin e parkimit, nga ana e T...G, pa u nënshkruar më parë kontrata.

- Këshilli Bashkiak Tiranë me vendimin nr. 86, datë 26.07.2017 ka miratuar dhënien me qira të 6,000 m<sup>2</sup> në bazë të dokumentacionit të paraqitur, nga Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, në tre parcela kadastrale, por pa autorizuar askënd për të lidhur këtë kontratë. Në pikën 5, Këshilli Bashkiak autorizon Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomi, në Bashkinë Tiranë për të komunikuar me ministrinë e linjës në emër të Bashkisë Tiranë, por jo për lidhje kontrate.

- Sipërfaqet e topografëve të licencuar në datën 04.05.2016, dhe evidenton një sipërfaqe total prej 6,515.39 m<sup>2</sup> ku në pjesën lindore është dhe objekti “Kalçeto”. Ndërsa Gent Plani i bërë nga topograf i licencuar me Licencë nr. T...3, mban datën 20.11.2017 evidenton një sipërfaqe prej 6,000 m<sup>2</sup>, pa përfshirë në llogaritje dy parcela kadastrale të evidentuara pronë e shoqërisë nga shkresa e ZVRPP Tiranë me Protokoll nr. 4342/1, datë 11.04.2017 drejtuar Bashkisë Tiranë ku konfirmon statusin e këtyre pasurive. Ortofotot e [www.ASIG.gov.al](http://www.ASIG.gov.al) të parkimit në funksion



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

aktual vërtetojnë se sipërfaqja është mbi 6,000 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e saktë e tij përfshirë parcelat e pa llogaritura si të dhëna me qira për “T...G”, është 6960.87 m<sup>2</sup>.

- Kontrata e lidhur mes Administratorit të Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 dhe “T...G”, nuk është noteriale. Lidhja e kontratës nga ana e Administratorit të Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 me subjektin qira kërkues, është në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54/e. Prona e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 administrohet në cilësinë e aksionarit nga Bashkia Tiranë, Këshilli Bashkiak. Kjo e drejtë është e pa delegueshme sipas ligjit nr. 139/2015, neni 9/1/2/c i cili përcakton se “**nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër**”. Kontrata nuk shoqërohet me dokumentacion plotësues të specifikuar në VKM nr. 54, sipërcituar, si vërtetim hipotekor të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 SHA mbi pronën, apo Ekstrakt Historik të T...G të lëshuar nga QKB.

-Subjekti “T...G” ka një detyrim të pa paguar vlerën **2,088,261 lekë** si detyrim për garanci të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 54, “Për caktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, Kapitulli II, pika 14. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, në cilësinë e organit përgjegjës për politikat e shoqërisë të analizojë shkaqet e shkeljeve ligjore dhe të rivendosi në përputhshmëri ligjore situatën.

*Menjëherë*

**22.2 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa për ndjekjen ligjore të situatës sipas përcaktimeve të Kodit Civil mbi Uzufutrin dhe Qiratë.

*Menjëherë*

**22.3 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrë masa për analizimin dhe shpërndarjen e përgjegjësiive për lejimin e punimeve dhe mos mbledhjen e detyrimeve financiare që vijnë nga përdorimi i truallit, sipas Kodit Civil, Begatim pa shkak.

*Menjëherë*

**22.4 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 të marrë masa për të kërkuar pagesën e Garancisë së Kontratës.

*Menjëherë*

**23. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA nuk ka një kontratë qiradhënie për dy kioska të licencuara nga Bashkia Tiranë, që operojnë në truallin e Qytetit Studenti, disa troje që përdoren nga baret dhe fast-food-et pranë Rrugës “Pjetër Budi” në të dy anët e saj. Sipërfaqja që subjektet përdorin nga trualli i Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA është përlllogaritur në total 617.4 m<sup>2</sup>. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa për përcaktimin e saktë të sipërfaqes së truallit të çdo subjekti dhe lidhjen e kontratës së qiradhënies me përdoruesit.

*Menjëherë*



## B. I MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi një dëm ekonomik në shumën **11,696,965 lekë** të argumentuara këto si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitet 2017, 2018 dhe deri më 31.08.2019, në 2 raste, përkatësisht në procedurat me objekt “Blerje karburante për nevojat e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1”, në procesin e zbatimit të kontratës rezultoi se OE ka përfshirë në skemën e llogaritjes së kostos së produktit dhe taksën e markimit veprime në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 26, datë 04.09.2008, Për taksat kombëtare, i ndryshuar, pika 1.1 si dhe VKM Nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, i ndryshuar, pika 1.3 si pasoje e te cilave i janë likuiduar tepër OE shuma 9,468 lekë me TVSh për 12000 litra gazoil, si dhe shuma 70,200 lekë me TVSh, për tejkalimin e afateve të kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **79,668 lekë**, (nga të cilat shuma 9,468 lekë për përfshirjen e taksës së markimit dhe shuma 70,200 lekë për vonesat në zbatimin e kontratës) nga OE A...T SHA për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shoqërisë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, nga kontrata e i qiradhënies së objektit me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>, lidhur me datë 12.02.2018 me subjektin “A...A”, ka një detyrim të pa arkëtuar në vlerën **143,089 lekë** e cila rezulton nga këstet e papaguara të qirasë nga subjekti si dhe nga kamatëvonesat përkatëse. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nga Drejtimi i Shoqërisë nuk janë ndjekur hapat e nevojshëm për arkëtimin e kësaj shume. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa administrative dhe ligjore, për të arkëtuar detyrimin prej **143,089 lekë** nga shoqëria “A...A”.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA me subjektin “T...G” ka një detyrim të pa likuiduar në vlerën **11,474,208 lekë** si detyrim për përdorimin e truallit të Qytetit Studenti si parkim autobusësh, pa kontratë/marrëveshje, në kundërshtim me Kodin Civil, neni 819 dhe në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për caktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, Kapitulli III, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa administrative dhe ligjore, për të arkëtuar detyrimin prej **11,474,208 lekë** nga shoqëria “T...G” dhe detyrimet rrjedhëse për dëmtimin e aseteve të shoqërisë.

**Menjëherë**

## B. II MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE



## **DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, efincencë dhe ekonomikitet fondet në shumën **9,764,548 lekë** të argumentuara këto si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Këshilli Mbikëqyrës i Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka marrë vendim përtej kompetencave të tij, duke shkaktuar me Vendimin nr. 2, datë 07.05.2018, pika (1) për vendosje të pastudiuar dhe të pa argumentuar të uljes së tarifave për dhënie me qira të objekteve të shoqërisë, duke krijuar **një efekt ekonomik prej 586,240 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 10-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Shoqëria në të ardhmen të marrë masa për studimin të tarifave të qirave, dhe të miratoj në Këshillin Mbikëqyrës, pasi të ketë administruar relacion të plotë shpjegues për reduktimin e tarifave.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me shpenzimet rezultoi se vendimi nr. 3, datë 14.11.2013, i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës, i përbërë nga z. A.H., z. P.N., dhe z. A.LL., për ndryshimet në strukturën dhe organigramën, është pasuar me largimet e punonjësve. Proceset gjyqësore të punonjësve të larguar kanë rezultuar në favor të këtyre të fundit, për arsye të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pa shkak dhe për mos njoftime dhe mos respektimin e afateve të ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit sipas Kodit të Punës, veprime këto të cilat kanë sjellë një efekt negativ për buxhetin e shoqërisë në shumën **7,406,528 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 18-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në marrëdhëniet me punonjësit të zbatohen të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet që përcaktohen në Kodin e Punës me qëllim shmangien e efekteve negative financiare të shoqërisë si ato të përmendura më sipër në shumën 7,406,528 lekë si dhe për të zbatuar vendimet e Gjykatës për rikthimin në punë të punonjësve të larguar padrejtësisht.

*Në vazhdimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka paguar gjatë vitit 2018 dy gjoba me vlerë 10,000 lekë për shkak të deklarimit me vonesë në tatime mbi fitimin vjetor të shoqërisë dhe 15,000 lekë për deklarimin me vonesë të pasqyrave financiare dhe vendimit të ortakut në QKR, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit” i ndryshuar. Vlera **25,000 lekë** përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Shoqëria të evidentojë përgjegjësitë në lidhje me deklarimin me vonesë të pasqyrave financiare si dhe të marrë masat përkatëse për shmangien në të ardhmen të efekteve negative për Buxhetin e Shoqërisë.

*Menjëherë*





KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për prokurime me vlera të vogla u konstatua se në 7 (shtatë) raste për mallrat e prokuruar janë bërë hyrje në magazinë pa u kontrolluar nga ana e grupit të marrjes në dorëzim të mallit për të vërtetuar origjinalitetin e mallit të prokuruar me atë të ardhur në magazinë. Vlera totale e pagesës për këto mallra të prokuruar është **1,670,268 lekë**, vlerë e cila është efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,670,268 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet e kryera për prokurime me vlera të vogla, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse që në të ardhmen, për mallrat që do të prokurohen të kontrollohen nga një grup i marrjes në dorëzim para se ato të bëhen hyrje në magazinën e shoqërisë, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në datë 15.02.2017 është lëshuar urdhri i prokurimit me nr. 1 për “Blerje IP Kamera” me fond limit 80,400 lekë, procedurë ku është shpallur fitues “F...C”, me ofertën 76,512 lekë. Ky prokurim është kryer pas kërkesës së përgjegjësit të marketingut dhe IT z. E.R. dhe Drejtorit të Shërbimeve Studentore Znj. O.D. ku sipas tyre 6 kamerat në rezidencat nr. 6, nr. 16, nr. 2 6-27, nr. 2 8-29, nr. 20-21 dhe nr. 17 kanë dalë jashtë funksioni. Në dokumentacionin e kësaj procedure nuk ekziston asnjë akt-konstatim i mbajtur nga punonjësit e departamentit të IT në momentin e konstatimit të dëmtimit të kamerave si edhe nga auditimi në magazinë rezultoi se kamera e zëvendësuar as nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe as janë depozituar në magazinën e shoqërisë, por ato mbaheshin në zyrën e z. E.R. veprim ky në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit të Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga grupi i auditimit nuk është bërë i mundur vërtetimi mbi gjendjen funksionale të kamerave si edhe nuk justifikohet plotësisht shpenzimi i kryer për blerjen e kamerave të reja, ndaj vlera prej **76,512 lekë**, përbën **efekt negativ financiar** për shoqërinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **76,512 lekë** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet e kryera për këtë prokurim, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse që në të ardhmen, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt financiar negativ** për Shoqërinë.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **B. III SHPEZIME TË KRYERA NË SHKELJE TË KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se për vitet 2017, 2018 dhe deri më 31.08.2019, në 6 raste, përkatësisht në procedurat:

- “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2017 me vlerë të fondit limit 3,622,000 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 3,482,010 lekë pa TVSh;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

- “*Lyerje e godinave me gëlqere*”, viti 2018 me vlerë të fondit limit 4,084,140 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 1,989,432 lekë pa TVSh;
- “*Riparim i pjesëshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29*”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 20,040,252 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontratës 17,744,410 lekë pa TVSh;
- “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, viti 2019 me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës së vetme të kualifikuar 232,793,719 lekë pa TVSh;
- “*Blerje karburanti për nevojat e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1*”, viti 2017 me vlerë të fondit limit 1,083,333 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës 1,083,333 lekë pa TVSh;
- “*Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1*”, viti 2018 me vlerë të fondit limit 1,083,333 lekë pa TVSh dhe vlerë të ofertës 1,083,333 lekë pa TVSh;

nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave janë kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit dhe/apo kanë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Nga këto, në 4 raste, konkretisht në procedurat “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*”, viti 2017, “*Rikonstruksion i godinave 11 – 12*”, viti 2019 dhe “*Blerje karburanti për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1*”, viti 2017 dhe 2018, procedurat e prokurimit duhet të ishin anuluar dhe të rinisnin një të re dhe në rastet e tjera duhet të ishte shpallur fitues OE pasardhës pasi OE të shpallur fitues janë rezultojnë me mangësi në dokumentacion. Konkretisht nga auditimi rezultoi se:

- f) Në vitin 2017 në procedurën me objekt “*Blerje materiale elektrike dhe hidraulike*” OE “*M...D*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriterin në lidhje me Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore për Tatimpaguesin. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar;
- g) Në vitin 2017-2018 në procedurat me objekt “*Blerje karburant për nevojat e Rezidenca Studentore Universitare nr. 1*” OE “*A...T*” SHA i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriteret e veçanta lidhur me pagesat e taksave, pagesat e detyrimeve të energjisë elektrike, për aftësitë teknike e profesionale për certifikatën e cilësisë së karburantit si dhe për kriterin e pikës së furnizimit jo më larg se 5 km nga godina e institucionit. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar;
- h) Në vitin 2018 në procedurën me objekt “*Lyerje e godinave me gëlqere*” OE “*F...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriterin në lidhje me Stafin teknik të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;
- i) Në vitin 2019 në procedurën me objekt “*Riparim i pjesëshëm i dhomave të studentëve të godinave 5, 20-21, 26-27, 28-29*” OE “*I...A*” ShPK i shpallur fitues nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:

7. Në lidhje me Stafin jo vetëm që janë paraqitur kontrata pune për 17 punëtorë nga 18 të kërkuar por njëkohësisht janë paraqitur 17 dëshmi kualifikimi të lëshuara nga subjekti “*H...T*” ShPK. Referuar dokumentacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në faqen Web të kësaj Drejtorie <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> rezulton se ky subjekt është i akredituar si organizëm certifikimi personeli që certifikon personel elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me standardin S SH EN ISO/ IEC 17024:2012 “*Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithshme për trupat që kryejnë certifikim personeli*” dhe jo për punime ndërtimi. Njëkohësisht referuar dokumentacionit të QKB



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

rezulton se subjekti “H...T” ShPK me NIPT K9...4D ka si objekt të aktivitetit të tij “...Certifikim personeli sipas standardit EN ISO/IEC 17024, për sigurimin teknik në fushën elektrike”;

Për 7 punonjës janë paraqitur dokumente për profesione të cilat nuk përputhen me listë pagesat përkatëse. Pra këta punonjës nuk plotësojnë kushtin që lidhet me pasqyrimin e tyre në listë pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit;

8. Nga ana e OE “I...A” ShPK nuk është deklaruar e saktë Shtojca 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces” pasi sipas buletinit nr. 25 të datës 24.06.2019 ky OE është shpallur fitues i një kontrate me objekt “Rikonstruksioni i Bibliotekës së Qytetit NjA 11” me vlerë 1,748,456 lekë pa TVSh ose 2,056,978 lekë me TVSh me afat 7 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Pas shpalljes fitues për këtë objekt, sipas buletinit nr. 26 të datës 01.07.2019, është lidhur kontrata mes AK Bashkia Tiranë dhe OE “I...A” ShPK;

9. Në pikën 10 janë kërkuar dy mjete me tonazh deri në 5 ton. Në fakt SPE rezulton se si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e OE të shpallur fitues është paraqitur mjeti me targa AA...UL ka një kapacitet prej 3.5 ton dhe mjeti me targa AA...AV ka një kapacitet prej 7.5 ton duke mos përmbushur kështu këtë kriter të DST;

Nga sa më sipër rezulton se nga ana e OE “I...A” ShPK janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe fitues i kësaj procedure duhet të ishte shpallur OE pasardhës në listën e OE të kualifikuar;

j) Në vitin 2019 në procedurën me objekt “Rikonstruksion i godinave 11 – 12” BOE “E...N & A...N & A...O” ShPK është i vetmi ofertues i kualifikuar edhe pse nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit dhe konkretisht:

#### E...N

- Sipas dokumenteve të tenderit preventivi i punimeve ka parashikuar një fond rezervë prej 3 % kurse oferta ekonomike e BOE të kualifikuar rezulton se ka parashikuar një fond rezervë prej 5 % duke mos ju përmbajtur kështu strukturës së parashikuar nga projektuesi /preventivuesi;
- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE nuk e plotëson këtë kriter pasi referuar dokumentit të paraqitur nga OE si dëshmi për përmbushjen e kriterit është paraqitur një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.05.2019. Nisur nga fakti që është kërkuar që ky specialist të figurojë të paktën 3 muajt e fundit si dhe faktit se zhvillimi i procedurës është zhvilluar me datë 11.07.2019, rezulton se në momentin e zhvillimit të procedurës ky punonjës nuk ka përmbushur kriterin e të qenit 3 muaj i punësuar si i ekspert zjarrfikës i certifikuar. Gjithashtu, referuar listë pagesave rezulton se ky punonjës, përgjatë muajve, janar – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, është paguar si Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë dhe asnjë muaj si ekspert zjarrfikës;

- Për dy specialistë termoteknikë është kërkuar si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontratat e punës dhe diplomat/dëftesat përkatëse, libreza e punës.

Sipas SPE rezulton se ky OE ka paraqitur dy certifikata, konkretisht për D. Ll dhe A. H. Pra në asnjë rast nuk janë paraqitur diplomat/dëftesat për termoteknikë. Gjithashtu, kontrata e lidhur me D. Ll rezulton se është e lidhur mes palëve (punëdhënësit “E...N” ShPK dhe punëmarrësit D. Ll) me përshkrim pune Inxhinier Civil dhe jo termoteknik. Për sa i përket listë pagesave rezulton se



KONTROLI I LARTË I SHITETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

D. Ll është paguar si “Inxhinier elektrik në transportin dhe shpërndarjen e energjisë” kurse A. H. është paguar si “Specialist për tavane me gips”, një profesion ky i cili bën pjesë në kategorinë Suvatues dhe kurrsesi pa asnjë lidhje me termoteknikën.

- Për sa i përket deklaratës në lidhje me Shtojcën nr. 8 Deklaratë mbi Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme, rezulton se G.K. i cili është deklaruar si inxhinier mekanik dhe Drejtues teknik i objektit në fjalë, referuar listë pagesave për të paktën periudhën janar 2018 – maj 2019 është paguar si teknik mekanik dhe jo si inxhinier mekanik;

Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

rezulton se janë pasqyruar dëshmi në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 10 punëtorë nga të paktën 48 të tillë që i takojnë OE “E...N” ShPK në raport me pjesën takuese (44 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

#### A...A

- Eksperti Zjarrfikës në muajt shkurt, mars, prill dhe maj 2019 ka punuar si Inxhinier ndërtesash dhe jo si ekspert zjarrfikës. Për rrjedhojë ky OE nuk e përmbush këtë kriter pasi nuk rezulton në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit;
- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*
- Rezulton se: nuk janë pasqyruar dëshmi të plota në përputhje me Kriteret Veçanta të Kualifikimit për 17 punëtorë nga të paktën 56 të tillë që i takojnë OE “A...N” ShPK në raport me pjesën takuese (51 % e 110 punëtorëve) të marrë përsipër në marrëveshjen e BOE të lidhur sipas aktit noterial me nr. 3609 rep. 1525/1 kol. datë 06.07.2019.

#### A...N

- Për sa i përket ekspertit zjarrfikës është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një të tillë si pjesë të stafit të punësuar për të paktën 3 muajt e fundit dhe për të vërtetuar këtë janë kërkuar certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe kontrata e vlefshme e punës.

Sipas materialeve të ngarkuara në sistem nga ky OE është paraqitur si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri një certifikatë e lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e MZSH e lëshuar me datë 22.04.2015 për L. D. Në fakt, referuar listë pagesave kjo punonjëse, përgjatë muajve shkurt – maj 2019, periudhë në të cilën përfshihet edhe afati i kërkuar në kërkesat e AK, figuron si *Inxhinieri mjedisi për trajtim ujërash* (pavarësisht se nuk ka kryer asnjë ditë punë) dhe në asnjë muaj nuk figuron si ekspert zjarrfikës, ndryshe nga sa është kërkuar.

- Për sa i përket kriterit: *Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 36 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të...*

Rezulton se edhe ky OE nuk plotëson numrin e nevojshëm të punëtorëve në proporcion me numrin e kërkuar.

**Nga sa më sipër rezulton se nga ana e BOE janë paraqitur të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi pasi kontratat e lidhura mes palëve janë fiktive dhe nuk përputhen me dokumentacionin e ngarkuar në SPE.** Në total ky BOE nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe në këto kushte duhet të ishte s’kualifikuar. Në kushte të tilla kjo procedurë duhet të ishte anuluar pasi nga auditimi rezultoi se BOE i mësipërm është i vetmi ofertues i kualifikuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

Sipas verifikimit në faqe e APP, referuar buletinit nr. 36 datë 09.10.2019 rezulton se është bërë shpallja e fituesit i cili rezulton të jetë BOE i vetëm i kualifikuar. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (c), (ç), (d) dhe (dh), neni 2, germa a dhe c, neni 24, pika 1, germa ç, neni 53, pika 3, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 66, VKM nr. 410 datë 13.05.2015 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, Kreu I Krijimi I Inspektoratit Shtetëror Teknik Dhe Industrial, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 26-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, Këshilli Mbikëqyrës i Drejtorisë të marrin masa për evidentimin e përgjegjësiive individuale të punonjësve të përfshirë në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionet e Shqyrtimit të Ankesave në këto procedura pas konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit në lidhje me kualifikimin me mangësi të OE.

*Në vijimësi*

## C. DËM EKONOMIK I MUNDSHËM

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës të lidhur me “T...G” më datë 07.12.2017, u konstatua se sipërfaqja e dhënë me qira, sanksionuar në kontratë dhe në gen-planin bashkëlidhur është 6,000 m<sup>2</sup>. Nga përlllogaritjet e përafërta që Grupi i auditimit ka kryer mbi gen-planin bashkëlidhur kontratës konstatohet se sipërfaqja është 6,960 m<sup>2</sup>, pra me një diferencë 960 m<sup>2</sup>, ose me vlerë **1,996,130 lekë**, për të cilën grupi i auditimit shprehet me rezervë, për arsye se ky gen-plan është hartuar dhe mban vulën e një eksperti të jashtëm të fushës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 të marrë masa për të ngritur një komision me përbërje të të cilit të ketë ekspertë për matjen e sipërfaqeve në terren për verifikimin e saktë të sipërfaqes në përdorim nga “T...G”. Në rast se rezulton se sipërfaqja e përdorur është mbi atë të kontraktuar, të llogaritet vlera e saktë e detyrimit dhe të ndiqen të gjithë hapat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës së përcaktuar.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA ka lejuar përdorimin e truallit të lirë, sheshe e trotuare për përdorim nga subjekte tregtare, sipërfaqja e përlllogaritur në total nga ortofotot është të paktën 617 m<sup>2</sup> ose vlerë **1,975,680 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Administratori të marrë masa për matjen dhe përcaktimin e saktë të çdo trualli në përdorim nga subjekte tregtare me të cilët nuk rezultojnë kontrata qiraje si dhe të marrë masa administrative dhe ligjore për mbledhjen e detyrimit nga të gjithë subjektet e evidentuar në auditim në vlerën **1,975,680 lekë** para lidhjes së kontratës me çdo subjekt, si edhe çdo detyrim vijues deri në lirimin e sipërfaqeve të zëna.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës të lidhur me “E...A” më datë 13.01.2017, e përsëritur çdo vit, u konstatua se sipërfaqja e dhënë me qira, sanksionuar në kontratë dhe në gen-



planin bashkëlidhur është 200 m<sup>2</sup>. Nga përlllogaritjet e përafërta që Grupi i auditimi ka kryer mbi gen planin bashkëlidhur kontratës konstatojmë se sipërfaqja është 202.34 m<sup>2</sup>, me një diferencë 2.34 m<sup>2</sup>, ose vlerë **41,600 lekë**, për të cilën grupi i auditimit shprehet me rezervë, për arsye se gen- plani është hartuar dhe mban vulën e një eksperti të kontraktuar të fushës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet nr. 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 të marrë masa për të ngritur një komision me përbërje të të cilit të ketë ekspertë për matjen e sipërfaqeve në terren, për verifikimin e saktë të sipërfaqes në përdorim nga “E...A”. Në rast se rezulton se sipërfaqja e përdorur është mbi atë të kontraktuar, të llogaritet vlera e saktë e detyrimit, dhe të ndiqen të gjithë hapat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës së përcaktuar.

*Menjëherë*

## D. MBI PRAKTIKËN E ZVOGËLIMIT TË VLERËS SË AKTIVEVE AFATGJATA (AAGJ/TRUALL) NDËR VITE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me mbajtjen e evidencës kontabël, në lidhje me pajisjen me certifikata të pronësisë për terrenet troje dhe ndërtesa, shoqëria ka filluar procesin që në vitin 2009 pas daljes së VKM nr. 403 datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve nr.1 Tiranë”, dhe ka përfunduar regjistrimin e gjithë ndërtesave dhe truallit pranë ZVRPP-së më datë 6.01.2015. Kjo sipërfaqe është e ndarë në dy zona Kadastrale, përkatësisht 8160 dhe 8190. Trualli që i përket zonës Kadastrale 8160 është regjistruar më datë 23.06.2014, ndërsa trualli që i përket zonës Kadastrale 8190 ka përfunduar regjistrimin më 6.01.2015. Nga territori i përgjithshëm i zonës Kadastrale nr. 8160 në pronësi të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA është regjistruar pranë ZVRPP-se territori me sipërfaqe prej 105,669 m<sup>2</sup>, ndërsa në zonën Kadastrale me nr. 8190 është regjistruar territori me sipërfaqe prej 40,634 m<sup>2</sup> dhe 27,604 m<sup>2</sup> truall poshtë ndërtesave të godinave. Në total territori i regjistruar është 173,907 m<sup>3</sup> nga të cilat 146,303 m<sup>2</sup> janë truall dhe 27,604 m<sup>2</sup> trualli i ndërtimeve të godinave, duke lënë jashtë territorit 74,509 m<sup>2</sup> nga të cilat rreth 67,081 m<sup>2</sup> janë deklaruar në VKM nr. 403 datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve nr. 1 Tiranë”, si të bllokuara nga ndërtime informale dhe 7,448 m<sup>2</sup> të shtuara nga periudha 2009-2013. Në VKM nr. 403, datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrative shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr.1”, është vendosur 1. Miratimi i listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve nr. 1. Lista me 6 (gjashtë), fletë që i bashkëngjitet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 43. 2- Ngarkohen ministri i Brendshëm, drejtori i shoqërisë anonime “Trajtimi i studentëve, nr. 1 dhe krye regjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi. Në nenin 16, Inventari -llogaritë vjetore, të statutit të shoqërisë të miratuar nga ministri i Ekonomisë, citohet “Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbyllje të ushtrimit drejtorja harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

-Pas mbarimit të proceseve të legalizimit dhe përpjekjeve të RSU nr. 1, për t'i rimarrë, sipërfaqja 67,081 m<sup>2</sup>, e zënë me ndërtime informale, të ndodhura në një periudhë kohore të paqartë e evidentuar që në vitin 2009, përbën asete të cilat i janë zvogëluar totalit të aktiveve të shoqërisë, me vlerë 2,264,319,155 lekë. (Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" për zonat kadastrale, Tiranë, 8160 dhe 8190, ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën më të vogël prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>).

-Ish titullari i shoqërisë, në kundërshtim me urdhrin direkt ndaj tij, lënë në VKM nr. 403, datë 22.04.2009, cituar sa më sipër, si dhe në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, me mos kryerjen e veprimeve ligjore në kohë për marrjen e certifikatave të pronësisë të pronës truall, u ka shkaktuar aktiveve të shoqërisë Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, një zvogëlim prej 7,448 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 247,377,872 lekë.

(Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" për zonat Kadastrale, Tiranë, 8160 dhe 8190, ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën më të vogël prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>).

Në vitin 2017, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, ka bllokuar pasurinë truall të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA me numër pasurie 5/611, zona Kadastrale nr. 8160, me sipërfaqe 105,669 m<sup>2</sup>, e lëshuar me datë 16.06.2014, duke pretenduar mbivendosjen me dy zona të tjera 5/627 dhe 5/628, zona Kadastrale nr. 8160, të lëshuara më datë 07.07.2017. Regjistrimi i këtyre pasurive ka ardhur si pasoje e vendimit nr. 365, datë 19.12.2008 të ZRKKP Qarku Tiranë, Vendimit nr. 5743, datë 12.05.2014, të Gjykatës të Rrethit Tiranë, për kthimin e dy sipërfaqeve me shumë totale 9650 m<sup>2</sup>, si dhe lënies në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me vendimin e marrë datë 05.05.2015. Nga këto vendime në kundërshtim me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004, i ndryshuar, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", neni 7, "Pronat që nuk kthehen (ndryshuar me ligjin nr. 9583, datë 17.07.2006), Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik.", ka sjellë një zvogëlim ndaj aktiveve të shoqërisë me sipërfaqe 9650 m<sup>2</sup>, me vlerë 643,616,400 lekë. (Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" për zonën Kadastrale, Tiranë, 8160 ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën prej 66,969 lekë për m<sup>2</sup>).

Gjithashtu dhe nga vendime të ZRKKP dhe gjykatave janë kthyer të 673 m<sup>2</sup> që i përkasin zonës kadastrale nr. 8190, ka ardhur ka sjellë një zvogëlim ndaj aktiveve të shoqërisë me sipërfaqe 673 m<sup>2</sup>, me vlerë 22,717,115 lekë. (Llogaritja është kryer referuar Vendimit Nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" për zonën Kadastrale, Tiranë, 8190 ku bëjnë pjesë sipërfaqet e sipërcituara, duke marrë vlerën prej 33,755 lekë për m<sup>2</sup>). (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 22-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë duhet të marrin masa për vlerësimin e situatës, apelimet në institucionet përkatëse për mbrojtjen e pronësisë së aktiveve të shoqërisë dhe saktësimet në pasqyrat financiare.

*Në vijimësi*

## E. PROCEDURA PROKURIMI/ZBATIMI NË PROCES



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

**1.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se procedura me objekt *“Rikonstruksion i godinave 11 – 12”*, prokuruar me urdhër nr. 4, me nr. 123 prot., datë 29.05.2019 me vlerë të fondit limit 247,470,811 lekë pa TVSh, deri në periudhën e punës audituese në terren (nga data 9.09.2019 deri me datë 08.11.2019) rezultoi të ishte deri në fazën në të cilin është kryer shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve i ankesave nga KSHA të OE për vlerësimin e kryer nga KVO.

Nga auditimi deri në këtë fazë të prokurimit u konstatuan:

**a.** Nga verifikimi në terren rezultoi se në godinat me nr. 11 – 12 kanë nisur pa prezencën e një mbikëqyrësi punimesh punime pa kontratë të lidhur me AK Rezidenca Studentore Universitare nr. 1. Gjithashtu, nga verifikimi u konstatua se punimet në proces rezultuan se ishin zëra punimesh të cilat ishin prokuruar sipas procedurës me objekt *“Rikonstruksion i godinës 11-12”*. Në momentin e kryerjes së verifikimit rezultuan në proces prokurimi dhe ende pa u lidhur kontrata përkatëse e zbatimit të punimeve dhe ajo e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve.

**b.** Krite diskriminuese, të paargumentuara teknikisht dhe ligjërishit dhe që nuk lidhen ngushtë me nevojat e investimit në fjalë;

**c.** Nga ana e KVO, KSHA dhe Titullarit të AK janë mbajtur qëndrime të ndryshme për mangësi të njëjta në të paktën tre raste diferencat e ofertave mes të cilave janë në shumën prej të paktën 38,625,889 lekë pa TVSh;

Kjo procedure prokurimi, e cila nuk mund të auditohej deri në fazën finale për arsye se fazat e tjera të procesit të prokurimit shtriheshin përtej afatit të objektit të auditimit sipas programit të miratuar, do të jetë objekt i një auditimi i cili do të kryet në 6-mujorin e parë të vitit 2020 (tremujori i dytë).

Konstatimet e evidentuara nga grupi i auditimit deri në fazën e vlerësimit të ankesave të OE për vlerësimin e kryer nga KVO nga KSHA, paraqiten në kapitullin *B MASA ORGANIZATIVE* pika 13, germa *c*, pika 15 dhe pika 16 si dhe tek si dhe pika 1, germa *e* tek kapitulli *C. II MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE*, pika 6 si dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**2.** Nga auditimi i kontratave të zbatimit të punimeve për periudhën objekt auditimi, u konstatua se procedura me objekt *“Riparim i pjesshëm i dhomave të akomodimit të studentëve të godinave 5, 20 – 21, 26 – 27, 28 – 29”*, prokuruar me urdhër nr. 3, me nr. 110 prot., datë 22.05.2019 me vlerë të fondit limit 20,040,052 lekë pa TVSh, për të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 253 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 17,744,410 lekë pa TVSH ose 21,293,292 lekë me TVSH është amenduar sipas aktit me nr. 701/2 prot., datë 31.10.2019 në lidhje me afatin e përfundimit të kontratës deri më 17.11.2019 pa shtesë në vlerën e kontratës. Nisur nga fakti se kontrata ishte ende në proces dhe periudha objekt auditimi sipas programit të miratuar ishte deri në 31.08.2019 dhe dokumentacioni i plotë teknik nuk ishte i mundur të vihej në dispozicion të grupit të auditimi, zbatimi i kontratës do të jetë objekt i një auditimi i cili do të kryet në 6-mujorin e parë të vitit 2020 (tremujori i dytë).

## **V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN**  
**STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA**

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1, Tiranë SHA në tërësi për periudhën nga data 01.01.2017 deri 31.08.2019, si dhe të pasqyrave financiare të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

**A. OPINIONI I AUDITIMIT**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi dhe Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 dhe 4100. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se mbi implementimin e rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentua në përgjithësi zbatim i tyre, por edhe disa raste të devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat kryesisht konsistojnë në drejtim të respektimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik, menaxhimit të pronave të dhëna me qira, mos verifikimi i saktë i sipërfaqeve të tyre. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e menaxhimit të Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 janë:**

Hartimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi i buxheteve të shoqërisë në përputhje me rregullat e statutit dhe rregullores; menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm publik në përputhje me rregullat për menaxhimin financiar dhe kontrollin, realizimi i prokurimeve publike në përputhje me rregullat e prokurimeve publike, hartimi dhe përmirësimi i rregullave dhe projekt-akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Rezidencës Studentore Universitare nr. 1 për përdorimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse paraqiten anomalitë materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË REZIDENCËN  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 TIRANË SHA

konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të shoqërisë. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

**Opinionit auditimit:**

**Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 400<sup>1</sup> dhe 4100<sup>2</sup>):**

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 4000 dhe 4100, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA, u konstatuan devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale, por jo tërësisht të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **opinionit të kualifikuar me rezervë** (*më hollësisht trajtuar në pikën D Mbi praktikën e zvogëlimit të vlerës së Aktiveve Afatgjata (AAGJ/Truall) ndër vite*).

**GRUPI I AUDITIMIT**

1. J.H.
2. B.SH.
3. I.H.
4. A.A.

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**Y.P.**

<sup>1</sup> ISSAI 400 – (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

<sup>2</sup> ISSAI 4100 – Objektivi i auditimit të përputhshmërisë është të jap siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me çështje të veçanta.



## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>RSU nr. 1</b>	Rezidenca Studentore Universitare nr. 1
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ISSAI</b>	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ALUIZNI</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>SHA</b>	Shoqëri Aksionare
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>KM</b>	Këshilli Mbikëqyrës
<b>KKRR</b>	Këshilli Kombëtar Rregullator
<b>AP</b>	Asambleja e Përgjithshëm